Elhami Isufi Hazer Dana Ferim Gashi

# Libër për mësuesin/en

## Gjeografia 8




Libër për mësuesin/en
Gjeografia 8

# LIBËR PËR MËSUESIN

## GJEOGRAFIA 8

# PËRMBAJTJE:

QËLLIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (FUSHA SHOQËRIA DHE MJEDISI) ............ 5
PARIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ............ 6
REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLË – KOMPETENCË (RNSH) DHE SHKALLA E ARRITSHMËRIA E TYRE ............ 7
PROGRAMI LËNDOR ............ 11
ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT - INSTRUMENTET E PLANIFIKIMIT ............ 27
PLANI MËSIMOR ............ 28
MODEL I PLANIT VJETOR ............ 29
MODEL I PLANIT DYMUJOR SHTATOR – TETOR ............ 30
MODEL I PLANIT DYMUJOR NËNTOR – DHJETOR ............ 33
MODEL I PLANIT TREMUJOR JANAR – SHKURT – MARS ............ 36
MODEL I PLANIT TREMUJOR PRILL – MAJ – QERSHOR ............ 40
SI TË HARTOHEN PLANET JAVORE? ............ 44
PLANI I ORËS MËSIMORE ............ 45
METODOLOGJIA DHE INSTRUMENTET E VLERËSIMIT ............ 197
VLERËSIMI I VAZHDUESHËM ............ 201
PËRZGJEDHJA E METODËS SË VLERËSIMIT ............ 202
INSTRUMENTET E VLERËSIMIT. ............ 203
REFERENCA ............ 214

# QËLLIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI)

Përmes fushës **Shoqëria dhe mjedisi,** nxënësit zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe prirjet që janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike. Kjo ndihmon që të zhvillojnë të kuptuarit e tyre mbi botën, njerëzit, vlerat e tyre, proceset shoqërore në kohë, vende dhe rrethana të ndryshme. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj fushe, ata zhvillojnë edhe të kuptuarit e tyre për mjedisin përreth dhe më gjerë. Kjo do t`u mundësojë atyre që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive e kritike, në komunitetin lokal, kombëtar e global, në të cilin jetojnë e angazhohen, për çështjet shoqërore dhe mjedisore.

Orientimet e ndryshme dhe qasjet tematike të kësaj fushe do të përqendrohen nga perspektiva e arritjes së qëllimeve arsimore, siç janë kultivimi i identitetit personal, shoqëror, kombëtar, identiteti shtetëror e kulturor. Gjithashtu, kjo fushë kontribuon në ndërtimin dhe ruajtjen e mirëqenies mendore, emocionale e shoqërore, në të mësuarit për të jetuar së bashku si dhe në edukimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Në kuadër të fushës Shoqëria dhe mjedisi, në Shk. 3 dhe Shk. 4, trajtohen çështjet shoqërore dhe mjedisore, nëpërmjet mësimit lëndor ose të integruar të lëndëve: Histori, Gjeografi dhe Edukatë Qytetare.

# PARIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Kurrikula Bërthamë siguron koherencë dhe qëndrueshmëri mes të niveleve formale të arsimit parauniversitar duke u mbështetur në këto parime:

**Gjithëpërfshirje,** që nënkupton ofrimin e mundësisë për përfshirje dhe qasje të barabartë të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve në arsim cilësor.

**Zhvillim i kompetencave** që reflektohet nëpërmjet rezultateve të nxënit, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit.

**Mësimdhënie dhe nxënie të integruar dhe koherente,** që promovon të nxënit e plotë, duke reflektuar ndërlidhjet dhe ndërvarësinë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me njohuritë e informacionin që nxënësi ka për to.

**Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle,** në zbatimin e Kurrikulës Bërthamë dhe pjesës me zgjedhje, që reflektohen në planifikim, organizim dhe realizim të procesit mësimor dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

**Përgjegjësi dhe llogaridhënie,** që reflektohen në krijimin e kulturës për vlerësim të vazhdueshëm të progresit në zbatimin e kërkesave të Kurrikulës përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt një paraqitjeje më të mirë në përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit.

Më gjerësisht për qëllimet dhe parimet e arsimit parauniversitar, shih Kornizën kurrikulare.

# REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLË – KOMPETENCË (RNSH) DHE ARRITSHMËRIA E TYRE

Koncepti ***Kompetencë***

Aftësi të gjera për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet, vlerat dhe emocionet në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme e të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura.

| **Kompetencat kryesore të të nxënit:** | **Rezultati përfundimtar** |
|---|---|
| 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit; | **Komunikues efektiv** |
| 2. Kompetenca e të menduarit; | **Mendimtar kreativ** |
| 3. Kompetenca e të mësuarit; | **Nxënës i suksesshëm** |
| 4. Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis; | **Kontribuues Produktiv** |
| 5. Kompetenca personale | **Individ i shëndoshë** |
| 6. Kompetenca qytetare | **Qytetar i përgjegjshëm** |

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore**
**Shkalla 4 - Përforcim dhe orientim, (klasat VIII dhe IX)**
Kjo shkallë synon t'i orientojë nxënësit që të marrin parasysh mundësitë e ndryshme të shkollimit dhe të karrierës. Deri në fund të shkallës 4 të kurrikulës (klasat VIII dhe IX), pritet që nxënësit të kenë zotëruar kompetencat si në vijim:

| **Nr.** | **Rezultatet e të nxënit për shkallën 4 dhe kompetencat kryesore** |
|---|---|
| **I** | **Kompetenca komunikim dhe të shprehurit – Komunikues efektiv** |
| 1. | Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. |
| 2. | Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj. |
| 3. | Diskuton për një temë të caktuar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze ose në gjuhën e dytë të huaj në lëndë të ndryshme, duke respektuar rregullat e pjesëmarrjes efektive për këmbimin e informatave dhe të ideve. |
| 4. | Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë, duke e vazhduar një rrëfim me gojë apo tekst të lexuar paraprakisht duke u bazuar në imagjinatën e vet. |

| | |
|---|---|
| 5. | Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik. |
| 6. | Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë, si dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. |
| 7. | Identifikon burime të ndryshme të informacionit për arsimim, orientimin profesional dhe harton një plan individual për zhvillimin e karrierës në fushën e komunikimit (gazetar etj.). |
| 8. | Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën, duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore. |

| **II** | **Kompetenca të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik** |
|---|---|
| 1. | Paraqet (në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole) argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. |
| 2. | Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdorur për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre. |
| 3. | Analizon një punim artistik ose joartistik (p.sh., artikull gazetaresk, pikturë... etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm. |
| 4. | Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar, duke propozuar aktivitetet kryesore, përcakton qëllimin kryesor, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e atyre aktiviteteve, si dhe parasheh pengesat e mundshme gjatë realizimit të tyre. |
| 5. | Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar në përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu. |
| 6. | Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, linguistik... etj.) bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezultatit. |
| 7. | Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar; duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. |
| 8. | Identifikon me anë të krahasimit, dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive. |

| **III** | **Kompetenca të mësuarit për të nxënë – Nxënës i suksesshëm** |
|---|---|
| 1. | Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë. |
| 2. | Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj. |
| 3. | Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre. |
| 4. | I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton;organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare. |

| | |
|---|---|
| 5. | Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas para të tjerëve. |
| 6. | Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| 7. | Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura; si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta. |
| 8. | Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm, si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin apo ngecjen në fusha të ndryshme mësimore. |

| IV | Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribuues produktiv |
|---|---|
| 1. | Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe punës në grup për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme. |
| 2. | Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, advokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin. |
| 3. | Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit. |
| 4. | Përdorur programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/dhe publikimeve të ndryshme të shkollës. |
| 5. | Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës, arsyeton pastaj rëndësinë e krijimit të shprehisë për të planifikuar. |
| 6. | Përdorur materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësime dhe për orientim në karrierë. |
| 7. | Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik etj., si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile. |
| 8. | Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit (me anë të fotografive, videoprojektimit të të dhënave nga terreni) dhe në bazë të tyre organizon aksione vullnetare dhe humanitare për plotësimin ose përmirësimin e atyre nevojave. |

| V | Kompetenca personale – Individ i shëndoshë |
|---|---|
| 1. | Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve, të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj. |
| 2. | Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjuara nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje. |
| 3. | Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve të mira higjienike për përgatitjen e konsumimin e ushqimeve dhe pijeve, si dhe shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga ushqimet dhe papastërtia. |

| | |
|---|---|
| 4. | Zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter rekreativ apo garues, duke bërë përpjekje për arritjen e standardeve të caktuara, me angazhim dhe sjellje të pëlqyera, por edhe duke menaxhuar emocionet e veta gjatë paraqitjes së rezultateve. |
| 5. | Analizon shkaqet e një reagimi konfliktual apo emocional nxënës-nxënës dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja, duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit. |
| 6. | Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale e propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre. |
| 7. | U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetentë, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor. |
| 8. | Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.). |
| 9. | Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë, si dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj. |

| VI | **Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm** |
|---|---|
| 1. | Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.). |
| 2. | Reagon, nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit, ndaj personave të cilët në ndonjë mënyrë shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve, duke ilustruar me shembujt e figurave të shquara historike, personazheve nga letërsia a filmat si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin. |
| 3. | Shpreh solidaritet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime/aksione konkrete për ofrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë. |
| 4. | Merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një votimi të zhvilluar në klasë ose në shkollë për një aktivitet të caktuar duke zbatuar rregullat përkatëse dhe, më pas, raporton me shkrim për rrjedhën e gjithë procesit. |
| 5. | Reagon me maturi ndaj sjelljeve apo veprimeve jo të mira që ndodhin në klasë/shkollë apo jashtë saj, promovon sjelljet dhe veprimet e mira duke vënë në pah shkaqet dhe pasojat e manifestimit të tyre për individin dhe për të tjerët. |
| 6. | Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre. |
| 7. | Përgatit një aktivitet me bashkëpjesëmarrje me të tjerët, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet. |
| 8. | Përshkruan, në forma të ndryshme të të shprehurit, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve duke argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme. |
| 9. | Prezanton të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit të vet, për të krahasuar të tashmen me të kaluarën dhe për të nxjerr përfundime për të ardhmen. |

# PROGRAMI LËNDOR

Programet lëndore janë bazë e organizimit të procesit mësimor-edukativ në kuadër të lëndës mësimore, për çdo nivel arsimor dhe shkallë përkatëse të kurrikulës.

Programi lëndor përmban lidhjen në mes të planit dhe programit mësimor të përgatitur për mësimdhënës për mbarëvajtjen e mësimit në shkolla.

Programi lëndor duhet të realizohet gjatë një viti mësimor. Gjatë kësaj periudhe nxënësit duhet t'i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës për tema mësimore dhe të kalojnë nëpër çështje ndërkurrikulare që ndërlidhen më temat mësimore.

Temat mësimore dhe RNL-të janë të përcaktuara nga niveli qendror, ndërsa mësimdhënësit kanë lirinë që kohën mësimore (sa orë) për realizimin e temave ta vendosin vetë. Mësimdhënësit mund të koordinohen me kolegët/mësimdhënësit e lëndëve të tjera brenda fushës dhe me lëndët e fushave të tjera për të harmonizuar realizimin e temave që kanë ndërlidhje në mes vete. Në këtë mënyrë sigurohet ndërlidhja lëndore dhe mësimdhënia e integruar.

Njësitë mësimore duhet të synojnë zhvillimin e kompetencave të parapara në KB për shkallën kurrikulare. Mësimdhënësit janë të lirë që në bazë të RNL-ve të përcaktojnë njësitë mësimore, për temat e përcaktuara në programet lëndore.

Programi lëndor udhëzon që të bëhet ndërlidhja në mes:

- Koncepteve
- Rezultateve të të nxënit në fushë (RNF)
- Temave mësimore
- Rezultatet e të nxënit në lëndë (RNL)
- Njësive mësimore

**Hierarkia e ndërlidhjes** së rezultateve



**Shembull:**

| Koncepti | RNF | Tema mësimore | RNL | Njësia Mësimore |
|---|---|---|---|---|
| **Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore** | **1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to.**<br>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.<br>1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre. | **-Pozita, kufijtë dhe madhësia e Azisë** | -Përcakton kufijtë e Azisë ndaj kontinenteve të tjera e të tregojë përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike.<br>-Arsyeton pozitën e gjeografike të Azisë.<br>-Krahason sipërfaqen e kontinentit të Azisë me atë të Europës. | **1.** Veçoritë e përgjithshme gjeografike të Azisë - kontinent i kontrasteve të shumta |

**Kurrikula** lëndore/programi mësimor
Gjeografi - Klasa 8

| **Koncepti** | **RNF, Temat dhe RNL** | |
|---|---|---|
| **Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore** | **RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to.**<br>1.1 Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.<br>1.3 Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre. | |
| | **Tema** | **Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)** |
| | **Pozita, kufijtë dhe madhësia e Azisë** | • Përcakton kufijtë e Azisë ndaj kontinenteve të tjera dhe të tregojë në përparësitë, si dhe mangësitë e pozitës gjeografike.<br>• Arsyeton pozitën gjeografike të Azisë.<br>• Krahason sipërfaqen e kontinentit të Azisë me atë të Europës. |
| | **Pozita, kufijtë dhe madhësia e Afrikës** | • Përcakton kufijtë e Afrikës dhe tregon përparësitë e pozitës së saj ndaj Europës, Azisë, Amerikës dhe Australisë.<br>• Identifikon ngushticat detare, gjiret detare, ishujt dhe gadishujt dhe gjen në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, ultësirat, fushat, luginat lumore më të njohura, shkretëtirat, gjysmëshkretëtirat, stepet, savanet dhe pyjet ekuatoriale. |

| | | |
|---|---|---|
| | **Regjionet amerikane - Pozita gjeografike** | • Analizon pozitën gjeografike, shtrirjen, madhësinë dhe identifikon gadishujt, ishujt, gjiret, ngushticat dhe kanalet kryesore të Amerikës, si dhe vlerëson rëndësinë e tyre.<br>• Vlerëson pozitën gjeografike, përthyerjen e vijës bregdetare dhe daljen në Oqeane të regjionit të Amerikës Veriore.<br>• Përcakton shtrirjen hapësinore të Amerikës së Mesme dhe dallon përparësitë e pozitës së saj, regjion në mes Amerikës Veriore dhe Amerikës Jugore.<br>• Analizon pozitën gjeografike, madhësinë e territorit dhe shtetet që e përbëjnë Amerikës Jugore si një regjion i veçantë. |
| | **Oqeania, Australia dhe rajonet polare -Pozita gjeografike** | • Analizon pozitën gjeografike skajore në hemisferën jugore të Australisë, veçoritë natyrore, relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore.<br>• Përkufizon viset polare në globin gjeografik. |
| **Proceset shoqërore dhe natyrore** | **RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.**<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet e pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti | |
| | **Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Azisë** | • Identifikon në hartë malet kryesore, rrafshlartat, ultësirat, luginat e mëdha të lumenjve, gadishujt dhe ishujt.<br>• Shpjegon rolin e hapësirës së madhe, ndikimin e deteve dhe të oqeaneve në klimë, ndikimin e erërave monsunike, pasurinë në ujëra dhe rrjetin hidrografik.<br>• Analizon elementet kryesore natyrore të Azisë, duke filluar nga relievi, klima, ujërat, botën bimore dhe shtazore<br>• Analizon ndryshimet e botës bimore, tajgen, stepen, makjet, savanet, xhunglat dhe t'i emërtojë kafshët e egra që jetojnë në regjionet e Azisë. |
| | **Azia Jugperëndimore, veçoritë natyrore** | • Shpjegon rolin e pozitës gjeografike të Azisë Jugperëndimore; vlerëson rëndësinë e saj në Azi dhe në botë.<br>• Dallon veçoritë kryesore të relievit (malet, ultësirat, rrafshnaltat dhe shkretëtirat), klimës, hidrografisë dhe botës bimore e shtazore, duke analizuar rëndësinë e tyre për jetën e veprimtaritë e njerëzve. |
| | **Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore** | • Identifikon veçoritë e përgjithshme fiziko-gjeografike të Azisë Jugore, vargmalet, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.<br>• Arsyeton tipat e klimës mes pjesëve veriore dhe jugperëndimore e jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Azisë Jugore.<br>• Analizon veçoritë hidrografike të Azisë Jugore, Juglindore dhe Lindore |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Identifikon elementet kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të Azisë Jugore.<br>• Analizon ndikimin dhe rëndësin e deteve në këtë regjion.<br>• Gjen në hartë sistemet malore, ultësirat e mëdha pjellore, lumenjtë dhe luginat lumore më të njohura dhe arsyeton pse nëpër ishujt e Indokinës ndodhin tërmete e vullkane.<br>• Analizon veçoritë klimatike të Azisë Juglindore.<br>• Shpjegon rolin e pozitës gjeografike dhe të evidenton veçoritë kryesore të pozitës gjeografike.<br>• Krahason viset perëndimore dhe lindore, kontinentale dhe ishullore nga relievi, klima dhe hidrografia. |
| | **Afrika-Veçoritë natyrore** | • Dallon tipat e klimës dhe përshkruan dallimet themelore të tyre.<br>• Analizon veçoritë hidrografike të Afrikës (Lumenjtë më të njohur, burimet e tyre dhe ujëmbledhësit, liqenet dhe prejardhjen e tyre).<br>• Përkufizon regjionin e Afrikës Veriore dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion.<br>• Përshkruan relievin malor (vargmalet), rrafshlartat malore, shkretëtirat dhe masivet malore midis shkretëtirës, veçoritë klimatike, hidrografike dhe të botës bimore e shtazore të Mesdheut Afrikan.<br>• Analizon shpërndarjen hapësinore të pasurive natyrore (naftës dhe pasurive të tjera) të Afrikës Veriore.<br>• Përkufizon regjionin dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion, si dhe analizon veçoritë kryesore natyrore (relievin, klimën, ujërat).<br>• Identifikon ishujt, gjiret dhe shtetet që e përbëjnë Afrikën Perëndimore, si dhe analizon rolin e pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Afrikës Perëndimore.<br>• Analizon veçoritë natyrore (relievin, ultësirat të pllajave dhe kodrinoro-malore) dhe shoqëroro-ekonomike të Afrikës Perëndimore (Afrika e Guinesë).<br>• Ndërlidh klimën me rritjen e pyjeve ekuatoriale me llojet e ndryshme të kafshëve të egra dhe të zogjve, si dhe vlerëson veçoritë hidroenergjetike të lumenjve të këtij regjioni.<br>• Përkufizon regjionin e Afrikës Qendrore-Ekuatoriale dhe identifikon shtetet e tij.<br>• Analizon veçoritë natyrore (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore) të Afrikës Qendrore.<br>• Përshkruan pozitën gjeografike të Afrikës Lindore, si dhe analizon përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike.<br>• Dallon dhe arsyeton tiparet e veçanta të klimës ekuatoriale që ndryshon në mënyrë vertikale dhe horizontale.<br>• Analizon ndërlidhjen mes tipave klimatikë dhe zonave vegjetative. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Identifikon shtrirjen e pyjeve ekuatoriale, savanave dhe gjysmëshkretëtirave dhe përhapjen e kafshëve të egra në këtë regjion.<br>• Përshkruan rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjeve dhe veçoritë specifike të lumenjve.<br>• Identifikon dhe emërton liqenet më të njohura të Afrikës Lindore.<br>• Analizon pozitën gjeografike dhe lidhjet komunikative të Afrikës Jugore me pjesët e tjera të Afrikës dhe me kontinentet tjera të Botës.<br>• Identifikon se cilat brigje të Afrikës Jugore lagen me ujërat e cilit oqean dhe shtetet që përbëjnë këtë regjion.<br>• Analizon veçoritë natyrore malet, rrafshlartat, fushëgropat, shkretëtirat dhe fushat përgjatë brigjeve të oqeanit.<br>• Arsyeton rrjetin hidrografik të varfër, mungesën e liqeneve dhe dallon tipat e klimës mes pjesëve perëndimore, qendrore dhe lindore të regjionit. |
| | **Veçoritë natyrore të regjioneve amerikane** | • Dallon elementet kryesore natyrore (malet, vargmalet, fushat, pllajat dhe luginat lumore më të njohura, etj.).<br>• Analizon veçoritë e klimës dhe vlerëson ndikimin e klimës në ndërlidhjeje me tipat vegjetativë.<br>• Identifikon nëpërmes hartës gjeografike lumenjtë dhe liqenet e njohura, detet dhe oqeanet, që lagin brigjet e Amerikës.<br>• Identifikon sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, rrafshlarta e madhe, pllaja e prerive, fushat dhe luginat lumore më të njohura.<br>• Analizon e komenton klimogramet dhe zonat bimore e shtazore për vendet e Amerikës Veriore, si dhe arsyeton ndryshimet e theksuara midis rajoneve, rolin e rrymave oqeanike në brigjet juglindore dhe jugperëndimore të regjionit.<br>• Identifikon lumenjtë kryesorë, praninë e madhe të liqeneve natyrore, ujëvarave, kamionëve dhe arsyeton rolin e tyre në zhvillimin ekonomik të Amerikës Veriore.<br>• Paraqet me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të naftës, gazit, nikelit, arit, uraniumit, plumbit, hekurit, qymyrit si dhe qendrat kryesore të industrisë.<br>• Analizon rëndësinë e rajoneve bujqësore dhe varësinë e tyre nga zonat klimatike dhe relievore.<br>• Identifikon në hartë gadishujt, ishujt dhe detet që i lagin brigjet e Amerikës së Mesme.<br>• Dallon dhe të arsyeton shtrirjen e zonave klimatiko-vegjetative mes pjesëve veriore dhe jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Amerikës së Mesme.<br>• Dallon tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Amazonit, të Orinokos, rrafshnaltën e Guajanës, pllajën e Brazilit. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Analizon veçoritë klimatike dhe hidrografike të Amerikës Jugore.<br>• Analizon shtrirjen gjeografike të mineraleve më të njohura në këtë regjion, si: hekuri, mangani, boksiti, ari, nafta, diamanti etj. |
| | **Veçoritë natyrore të Oqeanisë, Australisë, dhe rajoneve polare** | • Analizon vështirësitë e shumta natyrore pse Antarktiku është kontinenti i fundit i shkelur nga njeriu.<br>• Vlerëson kushtet klimatike të Arktikut me bimësinë e varfër dhe shtazët e egra të pakta.<br>• Vlerëson mungesën e lumenjve në këtë kontinent.<br>• Shpreh varësinë e klimës, florës dhe faunës në Antarktidë<br>• Dallon tri grupe të mëdha ishujsh: Melanezinë, Mikronezinë dhe Polinezinë.<br>• Analizon mënyrën e formimit të ishujve, si dhe ndërlidh tipat klimatikë me zonat vegjetative. |
| **Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë**<br><br>**Vendimmarrja dhe institucionet** | **RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat, si dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet, ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende e periudha të ndryshme.<br><br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br><br>**RNF: 4. Jep ide dhe propozime, si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.**<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon e shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | |
| | **Specifikat demografike, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë** | • Identifikon pasuritë kryesore minerale dhe burimet energjetike të Azisë.<br>• Dallon rajonet kryesore të përqendrimit të popullsisë në Azi dhe tregon shkaqet e tyre.<br>• Analizon elementet e përgjithshme demografike të Azisë.<br>• Dallon grupimet kryesore politike dhe ekonomike në Azi, veprimtaritë kryesore ekonomike dhe rajonet tipike gjeografike të Azisë.<br>• Analizon elementet kryesore demografike të Azisë Jugperëndimore.<br>• Identifikon qytetet më të njohura kulturore dhe religjioze të Azisë Jugperëndimore dhe identifikon zonat turistike.<br>• Identifikon burimet kryesore energjetike e pasuritë minerare, si dhe degët kryesore të ekonomisë.<br>• Dallon ngjashmëritë dhe specifikat natyrore, të popullatës, kulturore, ekonomike dhe politike të Turqisë, Iranit e Arabisë Saudite. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Analizon tiparet e demografike, ekonomike dhe kulturore të Azisë Jugore.<br>• Analizon specifikisht tiparet natyrore, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike të shtetit të Indisë dhe Pakistanit, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.<br>• Identifikon veçoritë etnike, fetare dhe ekonomike-turistike së Azisë Juglindore.<br>• Analizon specifikat natyrore, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore, (Indonezisë, Malajzisë dhe Singapurit). Analizon specifikat e popullatës, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të Azisë Lindore dhe shteteve kryesore (Kina, Japonia dhe të dy Koretë). |
| | Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës | • Analizon veçoritë demografike dhe ekonomike të Afrikës.<br>• Identifikon shtrirjen e besimeve fetare dhe analizon mënyrën e përhapjes së besimeve në territorin e Afrikës.<br>• Analizon mënyrën e organizimit politik të shteteve të Afrikës.<br>• Dallon grupimet politike dhe ekonomike dhe problemet me të cilat ballafaqohet popullsia e Afrikës.<br>• Identifikon popujt që banojnë këtë kontinent dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.<br>• Dallon shtrirjen hapësinore të religjioneve me zonat më gravituese.<br>• Analizon lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.<br>• Dallon rajonet e turistike të Afrikës dhe llojin e motive dominuese turistike.<br>• Identifikon veçoritë e popullatës, kulturore e ekonomike të Afrikës Veriore.<br>• Analizon veçoritë shoqëroro-ekonomike (popullsinë, pasuritë natyrore) të Afrikës Sudaneze.<br>• Identifikon popujt që e banojnë në Afrikën Ekuatoriale (qendrore) dhe veçoritë demografike, kulturore dhe ekonomike.<br>• Arsyeton ndërlidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.<br>• Dallon popujt në Afrikën Lindore, sipas përkatësisë etnike e fetare dhe gjendjen sociale.<br>• Nxjerr konkludime të thjeshta duke krahasuar shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, të popullatës, nivelit të arsimit, urbanizmit dhe strukturës ekonomike të tyre.<br>• Përshkruan veçoritë shoqëroro-ekonomike të Afrikës Jugore, si dhe identifikon vendburimet më të njohura të arit, diamantit, uraniumit, kromit, hekurit, naftës, qymyrit etj.<br>• Analizon gjendjen (strukturën) e popullsie në të kaluarën dhe lidhjet me të tashmen në Afrikën Jugore.<br>• Bën ndërlidhjen mes kushteve klimatike, veçorive të ujit të detit dhe të tregon rolin e tyre në ekonomi e turizëm.<br>• Dallon tiparet kryesore natyrore, të popullatës, kulturore e ekonomike të Tanzanisë. |

| | | |
|---|---|---|
| | **Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike** | • Komenton grafikonin e rritjes së popullsisë dhe hartën e dendësisë së popullsisë.<br>• Dallon popujt dhe grupet e shumta që ndryshojnë nga raca, gjuha, kultura dhe prejardhja e tyre në Amerikë.<br>• Analizon shkaqet që nxitën zbulimin e Amerikës dhe popullimin e saj.<br>• Dallon popujt më të njohur që e përbëjnë popullsinë e SHBA-së dhe të Kanadasë sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.<br>• Krahason shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, të popullatës, nivelit të arsimit, urbanizimit, strukturës ekonomike dhe bën dallimin e organizimit politiko-administrativ mes SHBA-së dhe Kanadasë.<br>• Analizon përthyeshmërinë e madhe bregdetare, si dhe vlerëson rëndësinë e Kanalit të Panamasë dhe përshkruan rëndësinë e tij ekonomike.<br>• Analizon veçoritë klimatike dhe hidrografike të Amerikës së Mesme.<br>• Dallon popujt më të njohur në Amerikën e Mesme sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.<br>• Arsyeton strukturën e popullsisë së Amerikës Jugore sipas përkatësisë kombëtare, racore dhe fetare.<br>• Dallon pasuritë natyrore më të njohura (metaleve, naftës, qymyrit, gazit e pasurive të tjera) dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik. |
| | **Oqeania, Australia, Arktiku dhe Antarktiku dhe rajonet polare, veçoritë shoqëroro-ekonomike** | • Analizon veçoritë demografike të Australisë.<br>• Identifikon grupet kryesore që e popullojnë Oqeaninë, si: papuanët, maorët, melanezianët, mikronezianët, polinezianët, por edhe ardhacakët nga kontinentet e tjera, si: aziatikët, amerikanët, europianët etj.<br>• Identifikon popujt që i banojnë ishujt e Arktikut dhe veçoritë e tyre demografike dhe ekonomike<br>• Nxjerr konkludime për mungesën e vendbanimeve të përhershme në Antarktidë.<br>• Identifikon vendburimet e mineraleve, si: qymyrgurit, hekurit, naftës, zinkut, plumbit, bakrit, arit etj. |
| **Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm** | **RNF**: **5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm**<br>5.1. Prezanton shembuj se si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit. | |
| | **Tema** | **Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)** |
| | **Procese dhe tipare globale shoqëroro-ekonomike dhe mjedisore** | • Dallon tiparet dhe prirjet e sotme të popullsisë në botë një pjesë e të cilave shfaqet nëpërmjet migrimeve lokale, rajonale dhe globale.<br>• Përshkruan tiparet e zhvillimit ekonomik në rrethanat e reja globalizuese.<br>• Identifikon përpjekjet bashkëkohore për ruajtjen e baraspeshës në kushtet e rritjes së konsumit dhe popullsisë në botë, duke respektuar normat mjedisore. |

| NJËSITË MËSIMORE TË HARTUARA PËR TEKSTIN GJEOGRAFIA 8 | | |
|---|---|---|
| **Tema** | **RNL (Rezultatet e të nxënit të lëndës)** | **Njësitë mësimore** |
| Pozita, kufijtë dhe madhësia e Azisë | -Përcakton kufijtë e Azisë ndaj kontinenteve të tjera dhe të tregojë në përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike.<br>-Arsyeton pozitën gjeografike të Azisë<br>-Krahason sipërfaqen e kontinentit të Azisë me atë të Europës. | **1. Veçoritë e përgjithshme gjeografike të Azisë- kontinent i kontrasteve të shumta** |
| Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Azisë | -Identifikon në hartë malet kryesore, rrafshlartat, ultësirat, luginat e mëdha të lumenjve, gadishujt dhe ishujt.<br>-Shpjegon rolin e hapësirës së madhe, ndikimin e deteve dhe të oqeaneve në klimë, ndikimin e erërave monsunike, pasurinë në ujëra dhe rrjetin hidrografik.<br>-Analizon elementet kryesore natyrore të Azisë, duke filluar nga relievi, klima, ujërat, bota bimore dhe shtazore.<br>-Analizon ndryshimet e botës bimore, tajgen, stepen, makjet, savanet, xhunglat dhe t'i emërtojë kafshët e egra që jetojnë në regjionet e Azisë. | **2. Relievi i kontinentit të Azisë**<br><br>**3. Veçoritë klimatike, hidrogafike dhe biogjeografike** |
| Specifikat e popullatës, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë | -Dallon rajonet kryesore të përqendrimit të popullsisë në Azi dhe tregon shkaqet e tyre.<br>-Analizon elementet e përgjithshme demografike të Azisë.<br>-Dallon grupimet kryesore politike dhe ekonomike në Azi; veprimtaritë kryesore ekonomike dhe rajonet tipike gjeografike të Azisë.<br>-Identifikon pasuritë kryesore minerale dhe burimet energjetike të Azisë.<br>-Identifikon burimet kryesore energjetike, pasuritë minerare dhe degët kryesore të ekonomisë. | **4. Popullsia e Azisë dhe veçoritë shoqërore**<br><br>**5. Karakteristikat e zhvillimit ekonomik dhe ndarja (diferencimi) regjionale e Azisë** |

| | | |
|---|---|---|
| Azia Jugperëndimore, veçoritë natyrore<br><br>Specifikat e popullatës, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë | -Shpjegon rolin e pozitës gjeografike të Azisë Jugperëndimore; vlerëson rëndësinë e saj në Azi dhe në botë.<br>-Dallon veçoritë kryesore të relievit (malet, ultësirat, rrafshnaltat dhe shkretëtirat), klimës, hidrografisë dhe botës bimore e shtazore, duke analizuar rëndësinë e tyre për jetën dhe veprimtaritë e njerëzve.<br>-Analizon elementet kryesore demografike të Azisë Jugperëndimore.<br>-Identifikon qytetet më të njohura kulturore dhe religjioze të Azisë Jugperëndimore, si dhe identifikon zonat turistike.<br>-Identifikon burimet kryesore energjetike dhe pasuritë minerare, si dhe degët kryesore të ekonomisë.<br>-Dallon ngjashmëritë dhe specifikat natyrore, popullatës, kulturore, ekonomike dhe politike të Turqisë, Iranit dhe Arabisë Saudite. | **6. Azia Jugperëndimore -veçoritë natyrore**<br><br>**7. Azia Jugperëndimore – veçoritë shoqërore-ekonomike**<br><br>**8. Turqia, Arabia Saudite dhe Irani** |
| **Azia Jugore**, **Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore**<br><br>Specifikat e popullatës, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë<br><br>**Azia Jugore**, **Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore**<br><br>Specifikat e popullatës, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë<br><br>**Azia Jugore**, **Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore**<br><br>Specifikat e popullatës, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë | -Identifikon veçoritë e përgjithshme fiziko-gjeografike të Azisë Jugore; vargmalet, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.<br>-Identifikon elementet kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të Azisë Jugore.<br>-Arsyeton tipat e klimës mes pjesëve veriore dhe jugperëndimore e jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Azisë Jugore.<br>-Analizon veçoritë hidrografike të Azisë Jugore, Juglindore dhe Lindore.<br><br>-Analizon tiparet e demografike, ekonomike dhe kulturore të Azisë Jugore.<br>-Analizon specifikisht tiparet natyrore, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike të shtetit të Indisë dhe Pakistanit, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.<br>-Shpjegon rolin e pozitës gjeografike dhe të evidenton veçoritë kryesore të pozitës gjeografike.<br>-Gjen në hartë sistemet malore, ultësirat e mëdha pjellore, lumenjtë dhe luginat lumore më të njohura, si dhe arsyeton pse nëpër ishujt e Indokinës ndodhin tërmete e vullkane.<br>-Analizon veçoritë klimatike të Azisë Juglindore.<br>-Analizon veçoritë hidrografike të Azisë Jugore, Juglindore dhe Lindore.<br>-Identifikon veçoritë etnike, fetare dhe ekonomike-turistike së Azisë Juglindore. | **9. Azia Jugore - veçoritë natyrore**<br><br>**10. Azia Jugore – veçoritë shoqërore-ekonomike**<br><br>**11. India dhe Pakistani**<br><br>**12. Azia Juglindore – veçoritë natyrore**<br><br>**13.Azia Juglindore – veçoritë shoqërore – ekonomike**<br><br>**14. Indonezia, Malezia dhe Singapori**<br><br>**15. Azia Lindore (Lindja e Largët) – veçoritë e përgjithshme gjeografike dhe natyrore**<br><br>**16. Veçoritë demografike dhe ekonomike të Azisë Lindore**<br><br>**17. Kina – veçoritë gjeografike-natyrore si dhe shoqërore-ekonomike** |

| | | |
|---|---|---|
| | -Analizon specifikat natyrore, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore- Indonezisë, Malajzisë dhe Singapurit.<br><br>-Shpjegon rolin e pozitës gjeografike dhe evidenton veçoritë kryesore të pozitës gjeografike.<br>-Krahason viset perëndimore dhe lindore, kontinentale dhe ishullore nga relievi, klima dhe hidrografia.<br>-Analizon veçoritë hidrografike të Azisë Jugore, Juglindore dhe Lindore.<br><br>-Analizon specifikat popullatës, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të Azisë Lindore, si dhe të shteteve kryesore (Kina, Japonia dhe dy Koretë). | **18. Japonia, Koreja Jugore dhe Veriore** |
| Pozita, kufijtë dhe madhësia e Afrikës | -Përcakton kufijtë e Afrikës dhe tregon përparësitë e pozitës së saj ndaj Europës, Azisë, Amerikës dhe Australisë.<br>-Identifikon ngushticat detare, gjiret detare, ishujt dhe gadishujt dhe gjen në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, ultësirat, fushat, luginat lumore më të njohura, shkretëtirat, gjysmëshkretëtirat, stepet, savanet dhe pyjet ekuatoriale. | **19. Afrika – emri, pozita, kufijtë dhe madhësia**<br><br>**20.Përthyeshmëria bregdetare dhe relievi i Afrikës** |
| Afrika-Veçoritë natyrore | -Dallon tipat e klimës dhe përshkruan dallimet themelore të tyre.<br>-Analizon veçoritë hidrografike të Afrikës (Lumenjtë më të njohur, burimet e ujëmbledhësit, liqenet dhe prejardhjen e tyre). | **21. Faktorët klimatikë, hidrografia dhe bota bimore e shtazore** |
| Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës | -Analizon veçoritë demografike dhe ekonomike të Afrikës.<br>-Identifikon shtrirjen e besimeve fetare dhe analizon mënyrën e përhapjes së besimeve në territorin e Afrikës.<br>-Analizon mënyrën e organizimit politik të shteteve të Afrikës.<br>-Dallon grupimet politike dhe ekonomike, si dhe problemet me të cilat ballafaqohet popullsia e Afrikës.<br>-Identifikon popujt që banojnë këtë kontinent dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.<br>-Dallon shtrirjen hapësinore të religjioneve me zonat më gravituese.<br>-Analizon lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.<br>-Dallon rajonet e turistike të Afrikës dhe llojin e motive dominuese turistike. | **22. Karakteristikat demografike, zhvillimi ekonomik dhe ndarja politike** |

| | | |
|---|---|---|
| Afrika-Veçoritë natyrore<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës<br><br>Afrika-Veçoritë natyrore<br><br>Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës<br><br><br>Afrika-Veçoritë natyrore<br><br><br>Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës<br><br><br>Afrika-Veçoritë natyrore | -Përkufizon regjionin e Afrikës Veriore dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion.<br>-Përshkruan relievin malor (vargmalet), rrafshlartat malore, shkretëtirat dhe masivet malore midis shkretëtirës, veçoritë klimatike, hidrografike dhe të botës bimore e shtazore të Mesdheut Afrikan.<br>-Analizon shpërndarjen hapësinore të pasurive natyrore (naftës dhe pasurive të tjera) të Afrikës Veriore.<br>-Përkufizon regjionin dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion, si dhe analizon veçoritë kryesore natyrore (relievin, klimën, ujërat).<br><br>-Identifikon veçoritë e popullatës, kulturore e ekonomike të Afrikës Veriore.<br>-Analizon veçoritë shoqëroro-ekonomike (popullsinë, pasuritë natyrore) të Afrikës Sudaneze.<br>-Identifikon ishujt, gjiret dhe shtetet që e përbëjnë Afrikën Perëndimore, si dhe analizon rolin e pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Afrikës Perëndimore.<br>-Analizon veçoritë natyrore (relievin, ultësirat të pllajave dhe kodrinoro-malore) dhe shoqëroro-ekonomike të Afrikës Perëndimore (Afrika e Guinesë).<br><br>-Përkufizon regjionin e Afrikës Qendrore-Ekuatoriale dhe identifikon shtetet e tij.<br>-Ndërlidh klimën me rritjen e pyjeve ekuatoriale dhe llojet e ndryshme të kafshëve të egra e të zogjve, si dhe vlerëson veçoritë hidroenergjetike të lumenjve të këtij regjioni.<br>-Analizon veçoritë natyrore (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore) të Afrikës Qendrore.<br>-Identifikon popujt që e banojnë në Afrikën Ekuatoriale (qendrore) dhe veçoritë demografike, kulturore dhe ekonomike.<br>-Arsyeton ndërlidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.<br>-Përshkruan pozitën gjeografike të Afrikës Lindore, si dhe analizon përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike. | **23. Afrika Veriore – specifikat natyrore dhe shoqërore-ekonomike**<br><br><br>**24. Republika Arabe e Egjiptit dhe Maroku**<br><br><br>**25. Afrika Perëndimore – veçoritë natyrore dhe shoqërore-ekonomike**<br><br><br>**26. Afrika Qendrore Ekuatoriale - veçoritë natyrore dhe shoqërore-ekonomike**<br><br><br>**27. Afrika Lindore - veçoritë natyrore dhe shoqërore-ekonomike** |

| | | |
|---|---|---|
| Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës<br><br><br><br><br><br><br><br>Afrika-Veçoritë natyrore<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës | -Dallon dhe arsyeton tiparet e veçanta të klimës ekuatoriale që ndryshon në mënyrë vertikale dhe horizontale.<br>-Analizon ndërlidhjen mes tipave klimatikë dhe zonave vegjetative.<br>-Identifikon shtrirjen e pyjeve ekuatoriale, savanave dhe gjysmëshkretëtirave, si dhe përhapjen e kafshëve të egra në këtë regjion.<br>-Përshkruan rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjeve dhe veçoritë specifike të lumenjve.<br>-Identifikon dhe emërton liqenet më të njohura të Afrikës Lindore.<br>-Dallon popujt në Afrikën Lindore, sipas përkatësisë etnike e fetare e gjendjen sociale.<br>-Nxjerr konkludime të thjeshta duke krahasuar shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, të popullatës, nivelit të arsimit, urbanizmit dhe strukturës ekonomike të tyre.<br>- Dallon tiparet kryesore natyrore, të popullatës, kulturore e ekonomike të Tanzanisë.<br><br>-Analizon pozitën gjeografike dhe lidhjet komunikative të Afrikës Jugore me pjesët tjera të Afrikës dhe me kontinentet tjera të Botës.<br>-Identifikon se cilat brigje të Afrikës Jugore lagen me ujërat e cilit oqean dhe shtetet që përbëjnë këtë regjion.<br>-Analizon veçoritë natyrore malet, rrafshlartat, fushëgropat, shkretëtirat dhe fushat përgjatë brigjeve të oqeanit.<br>-Arsyeton rrjetin hidrografik të varfër, mungesën e liqeneve dhe dallon tipat e klimës mes pjesëve perëndimore, qendrore dhe lindore të regjionit.<br><br>-Përshkruan veçoritë shoqëroro-ekonomike të Afrikës Jugore si dhe identifikon vendburimet më të njohura të arit, diamantit, uraniumit, kromit, hekurit, naftës, qymyrit etj.<br>-Analizon gjendjen (strukturën) e popullsisë në të kaluarën dhe lidhjet me të tashmen në Afrikën Jugore.<br>-Bën ndërlidhjen mes kushteve klimatike, veçorive të ujit të detit dhe tregon rolin e tyre në ekonomi e turizëm. | <br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>**28. Tanzania**<br><br><br>**29. Afrika Jugore - veçoritë natyrore**<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>**30. Zhvillimi shoqërore – ekonomike i Afrikës Jugore**<br><br>**31. Republika Jugafrikane** |
| Regjionet amerikane - Pozita gjeografike | -Analizon pozitën gjeografike, shtrirjen, madhësinë dhe identifikon gadishujt, ishujt, gjiret, ngushticat dhe kanalet kryesore të Amerikës, si dhe vlerëson rëndësinë e tyre. | **32. Kontinenti i Amerikës – veçoritë e përgjithshme gjeografike** |

| | | |
|---|---|---|
| Veçoritë natyrore të regjioneve amerikane<br><br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike<br><br>Regjionet amerikane - Pozita gjeografike | -Dallon elementet kryesore natyrore (malet, vargmalet, fushat, pllajat dhe luginat lumore më të njohura, etj.).<br>-Analizon veçoritë e klimës dhe vlerëson ndikimin e klimës në ndërlidhje me tipat vegjetativë.<br>-Identifikon, përmes hartës gjeografike, lumenjtë dhe liqenet e njohura, detet dhe oqeanet, që lagin brigjet e Amerikës.<br>-Identifikon sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, rrafshlarta e madhe, pllaja e prerive, fushat dhe luginat lumore më të njohura.<br>-Analizon shkaqet që nxitën zbulimin e Amerikës dhe popullimin e saj.<br>-Dallon popujt dhe grupet e shumta që ndryshojnë nga raca, gjuha, kultura dhe prejardhja e tyre në Amerikë.<br>-Komenton grafikonin e rritjes së popullsisë dhe hartën e dendësisë së popullsisë. | **33. Veçoritë natyrore të kontinentit të Amerikës**<br><br>**34. Kolonizimi i Amerikës, popullsia dhe zhvillimi ekonomik** |
Meqenëse plani dymujor nuk është i ndarë në javë, plani javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore, të cilat do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare) në klasën e caktuar. Njësitë mësimore merren nga plani dymujor.

Plani javor ka për qëllim lidhmërinë e njësive mësimore të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemeve, dukurive dhe ngjarjeve si çështje të ndërlidhura e jo të ndara.

Kjo do të thotë që të gjithë mësimdhënësit/et e një klase (p.sh. kl. 8), të të gjitha fushave kurrikulare, të të gjitha lëndëve, në një tabelë të përbashkët të vendosin njësitë mësimore që i kanë planifikuar t'i realizojnë gjatë javës për një klasë (edhe pse ato mund të jenë të ndryshme nga arsimtarët e së njëjtës lëndë, por që japin mësim në paralele të tjera brenda klasës së njëjtë). Kjo qasje i obligon mësuesi/ja që të takohen gjatë javës dhe që të bëhet lidhshmëria e njësive mësimore në mes lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të nxënit e nxënësve të jetë më i integruar.

Nëse ky takim për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta nuk mund të jetë i realizuar në të gjitha shkollat, sepse "kolektivi i mësimdhënësve është shumë i madh". Atëherë kryetari i aktiveve profesionale mund të qarkojë fletën, në të cilën mësimdhënësit shkruajnë njësitë mësimore që do t'i zhvillojnë javën që vjen, ose pedagogu i shkollës, në shkollat ku ka pedagog. Më pas, kjo fletë e përfunduar shumëzohet ose shpërndahet në mënyrë elektronike të të gjithë mësimdhënësit/set e klasës së njëjtë para javës që realizohen njësitë mësimore. Është e preferueshme që planifikimi javor të publikohet edhe në sallën e mësimdhënësve, në mënyrë që të gjithë mësimdhënësit të jenë në dijeni se cilat tema/njësi mësimore realizohen gjatë javës dhe të ndihmojnë integrimin përmbajtjesor të fushave dhe lëndëve të kurrikulës.

Vlerësohet se hartimi i duhur i planeve javore mund të ndikojë në lehtësimin e të nxënit të nxënësve, në zvogëlimin e ngarkesës së nxënësve në provime dhe testime, sidomos nëse bëhet kujdes që të vendosen tema/njësi mësimore ndihmohen reciprokisht në mes të fushave të kurrikulës dhe lëndëve mësimore, nëse bëhet një përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe aktiviteteve që do të zhvillohen brenda një klase të caktuar.

# MODELI I PLANIT JAVOR PËR KLASË

MUAJ:______________, Java me ditët e punës nga: ____________________

| | FUSHA | Lëndët | Temat / NJËSITË MËSIMORE NË JAVË | Përshkrim i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës mësimore[1] |
|---|---|---|---|---|
| KLASA e VIII- të | Gjuhët dhe komunikimi | *Gj. shqipe* | | |
| | | *Gj. angleze* | | |
| | | *Gj. Gjermane* | | |
| | Artet | *Art figurative* | | |
| | | *Art muzikor* | | |
| | Matematika | *Matematikë* | | |
| | Shkencat natyrore | *Fizikë* | | |
| | | *Kimi* | | |
| | | *Biologji* | | |
| | Shoqëria dhe mjedisi | *Histori* | | |
| | | *Gjeografi* | | |
| | | *Edukatë qytet-are* | | |
| | Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti | *Edukatë Fizike, sportet dhe shëndeti* | | |
| | Jeta dhe puna | TIK | | |
| | Pjesa zgjedhore | | | |
| | | | | |
| | | | | |

1 A) Tema të përbashkëta që orientojnë fokusin e përbashkët të gjitha lëndëve mësimore për gjatë javës, ose brenda një dite. B) Çështje ndërkurrikulare që është në fokus të javës dhe përfshihet në kuadër të shumicës së lëndeve mësimore; C) Etj.

# Plani i orës mësimore

Plani i orës mësimore shërben që të gjitha planifikimet e procesit mësimor të bëhen të zbatueshme në punën e drejtpërdrejtë me nxënës në klasë dhe jashtë saj, brenda një ore mësimore.

Në këtë planifikim mësimdhënësi/ja përcakton:

- Njësinë mësimore të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimin dymujor, përkatësisht planifikimi javor);
- Rezultatet e synuara të kompetencave (të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore);
- Rezultatet e synuara të fushës kurrikulare (mund të vendosen vetëm rezultatet e lëndës mësimore që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare Shoqëria dhe Mjedisi, edhe këto merren nga planifikimi dymujor);
- Rezultatet e njësisë mësimore (që duhen arritur gjatë asaj ore mësimore, që kontribuojnë në arritjen e rezultateve të shkallës apo lëndës).
- Kriteret e suksesit (të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës).

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE (UDHËZIME PËR PLOTËSIM TË TABELËS)

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:</td><td>Lënda:</td><td>Shkalla e kurrikulës:</td><td>Klasa:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>Barten nga plani dymujor, vetëm rezultati/et që lidhen me fokusin e orës mësimore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):<br>Barten nga plani dymujor, vetëm rezultati/et që lidhen me fokusin e orës mësimore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: mësimore (merret nga plani dymujor, përkatësisht nga plani javor). Në raste të veçanta, nëse mësimdhënësi/ja ka vendosur që për çështje praktike, temën ta ruajë si formulim në kuadër të njësisë mësimore, atëherë në vend të njësisë mund të shënohet tema mësimore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: (vendosen vetëm fjalët që identifikohen me njësinë mësimore që trajtohet brenda orës mësimore):</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore<br>Rezultatet e të nxënit për orë mësimore, duhet të jenë të përkufizuar qartë, të matshme, me strukturë të plotë të rezultateve të nxënit (veprim+qëllim/objekt+kusht+kriter) dhe në funksion të zotërimit të rezultateve të të nxënit të temës së lëndës dhe rezultateve të nxënit të shkallës për kompetencat kryesore, rezultatet e të nxënit të fushës sipas pritshmërive të përcaktuara për shkallën përkatëse.<br>Kriteret e suksesit:<br>Kriteret e suksesit duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës, paraprakisht mësimdhënësi/ja mund/duhet ta bëj një orientim në bazë të kontekstit të klasës dhe veprimtarive të planifikuara për punë me nxënës. Kriteret e suksesit të zbërthyera për rezultatin e të nxënit të orës mësimore apo rezultatin e të nxënit të temës së lëndës duhet të jenë të formuluara mirë, nuk duhet të përsërisin rezultatin e të nxënit të orës mësimore; por rezultatin e të nxënit e zbërthejnë sipas niveleve të arritjes (nivel i ulët, nivel mesatar dhe nivel i lartë) dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit të rezultatit të të nxënit të orës mësimore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Këtu vendosen të detajuara burimet, mjetet e konkretizimit e materialet mësimore që mësimdhënësi/ja dhe nxënësit i shfrytëzojnë gjatë orës mësimore (shih orientimet e përgjithshme të plani dymujor për burimet).</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Përshkruhet shkurtimisht me cilën/cilat lëndë mësimore dhe/apo me çështje ndërkurrikulare, situata jetësore ndërlidhet ora mësimore, në mënyrë specifike me cilat tema të lëndës/lëndëve dhe me cilat aspekte të çështjes së caktuar ndërkurrikulare ndërlidhet ora mësimore dhe veprimtaritë me nxënës. |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** |
| Përshkrimi duhet të përfshijë organizimin e orës së mësimit, i cili mund/duhet të përmbajë:<br>• lidhjen e temës/njësisë mësimore me njohuritë e mëparshme të nxënësve;<br>• ndërtimin e njohurive të reja;<br>• prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura etj. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE:** |
| Përshkruhet qasja që do të përdoret në vlerësimin formativ në raport me rezultatet e të nxënit për orë mësimore. Pjesë e përshkrimit *të vlerësimit mund/duhet të jetë edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi, duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura nga evidencat dhe progresi i nxënësve e progresit të tij.* |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Këtu përshkruhen detyrat dhe puna e pavarur që planifikohen për t'u realizuar me nxënës kur vlerësohet se disa aktivitete paraprake të orës së mësimit mund të realizohen më shpejtë, apo mund të zgjatet ora e mësimit, si dhe për kohën pas orës mësimore, në mënyrë që të mos rritet ngarkesa e nxënësit në orë të mësimit. Për këtë vendos mësimdhënësi. Detyrat dhe puna e pavarur jashtë orës së mësimit, duhet të jenë të integruara brenda lëndëve të fushës apo ndërmjet fushave. |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Pozita, kufijtë dhe madhësia e Azisë | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Përcakton kufijtë e Azisë ndaj kontinenteve të tjera dhe të tregojë në përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike.<br>• Arsyeton pozitën gjeografike të Azisë.<br>• Krahason sipërfaqen e kontinentit të Azisë me atë të Europës. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-1, 2, 5; II-1, 7, 8; III-2, 6, 7; IV-4, 6; V-5 VI-3. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.<br>1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Veçoritë e përgjithshme gjeografike të Azisë- kontinent i kontrasteve të shumta | | | |
| **Fjalët kyçe:** Kufijtë, madhësia, pozitë gjeografike, përthyeshmëria, Bota e vjetër, Euro-Azia | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Përkufizon shtrirjen e kontinentit të Azisë në raport me kontinentet tjera.<br>2. Analizon pozitën gjeografike të kontinentit të Azi-së.<br>3. Identifikon në hartë format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të Azisë.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>1. Përcakton saktë përkufizimin e kontinentit të Azisë në hartën e botës.<br>2. Tregon pozitën gjeografike të Azisë në raport me kontinentet tjera.<br>3. Gjen format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të kontinentit. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**<br>Teksti 8, harta e botës dhe Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga interneti. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Aspekti Historik, Gjuhët dhe Komunikim, Artet; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media. | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse - Hapi i parë:**

Fillimisht, pas informimit të nxënësve lidhur me plan-programin dhe temat që do të shtjellohen në ketë vit shkollor, u paraqesim nxënësve hartën e botës, kërkohet nga nxënësit që ta shikojnë pozitën gjeografike që ka kontinenti i Azisë dhe lidhja (afërsitë dhe largësitë) me kontinentet tjera.

Nxënësve u shtrohen pyetje lidhur me kontinentin e Azisë:

- Çfarë dini ju për kontinentin e Azisë?
- Identifikoni në hartë kontinentin e Azisë?
- Duke vështruar hartën e botës, cili kontinent mendoni që është më i madhi?
- Me cilin kontinent ka lidhje tokësore? (Disa përgjigje shënohen në tabelë.)

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:**

Diskutojmë: Përcaktoni në hartën fiziko-gjeografike të paraqitur në klasë pozitën gjeografike dhe përkufizimin e kontinentit të Azisë. Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që t'i kenë para vete atlaset personal dhe së bashku fillimisht ta bëjnë përkufizimin e kontinentit të Azisë duke i evidentuar në hartë e atlas kufijtë natyror që e ndajnë këtë kontinent nga kontinentet tjera.

Mësimdhënësi/ja parashtron pyetje duke zgjuar kureshtjen e nxënësve se me cilat kontinente lidhet Azia me rrugë tokësore dhe me cilat me rrugë ujore? Pret përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarime shtesë rreth pozitës qendrore të kontinentit të Azisë.

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që në dyshe në atlaset e tyre t'i evidentojnë format e përthyeshmërisë bregdetare. Ai fillimisht kërkon nga nxënësit:

- Gjeni gadishujt kryesorë të kontinentit të Azisë. (Për 2 deri 3 min kërkohet nga nxënësit që gadishujt e gjetur në atlas, t'i evidentojnë edhe në hartën e murit).
- Gjeni ishujt kryesorë të Azisë në atlas e më pas t'i evidento
- ni në hartën e murit.



Kjo mënyrë vazhdohet derisa të gjenden të gjitha format e përthyeshmërisë bregdetare si: gjiret, ngushticat, kanalet etj.
Mësimdhënësi/ja parashtron pyetje: se cilat ngushtica dhe kanale luajnë rol më të rëndësishëm për lidhje komunikative të kontinentit të Azisë.
Hap diskutimi rreth kësaj teme dhe pret mendimet e nxënësve.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Mësimdhënësi/ja orienton nxënësit që në fletore pune, në hartat memece të Azisë, të bëhet përkufizimi i Azisë dhe të shënohen format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen te nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit/es.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Në hartën e Azisë përshkrimin rrugës së një anije nga Stambolli deri në Osaka (shënoni ngushticat, kanalet, detet dhe oqeanet).<br>• Gjen kohën zonale të Tokios duke krahasuar me Bombain.<br>Plotësim i aktiviteteve në fletore pune. |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Azisë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Identifikon në hartë malet kryesore, rrafshlartat, ultësirat, luginat e mëdha të lumenjve, gadishujt dhe ishujt.<br>• Analizon elementet kryesore natyrore të Azisë, duke filluar nga relievi, klima, ujërat, botën bimore dhe shtazore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 2, 3, 5; II-7, 8; III-2, 6, 7, 8; IV-3, 4, 6, 8; V-6; VI- 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Relievi i kontinentit të Azisë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Malet, rrafshnaltat, shkretëtirat, ultësirat, luginat, mali Everest, Tibeti, Gobi etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Krahason kontrastet e shumta në relievin e Azisë.<br>2. Dallon format kryesore të relievit në kontinentin e Azisë<br>Kriteret e suksesit:<br>1. Përcakton diferencat në mes pjesëve të ndryshme të relievit të Azisë.<br>2. Gjen në hartën e Azisë së paku nga tri forma kryesore të secilës veçori të relievit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore<br>Teksti 8, harta e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, laptopi dhe projektori, material shtesë nga interneti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë dhe Komunikim, TIK, Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.</td></tr>
<tr><td colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
</table>

**Pjesa hyrëse - Hapi i parë:**

Mësimdhënësi/ja para nxënësve paraqet hartën fiziko gjeografike të kontinentit të Azisë dhe kërkohet që për 1-2 minuta të analizojnë hartën. Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit informacionet e nxjerra rreth asaj që e kanë kuptuar nga harta fizike e Azisë: Parashtrohet pyetja: Çfarë mendoni, se cila formë e relievit dominon në kontinentin e Azisë

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:**

Mësimdhënësi/ja jep sqarimet e nevojshme për format relievore të kontinentit të Azisë, duke filluar nga shtrirja e maleve, rrafshnaltat kryesore, shkretëtirat dhe ultësirat. Nxënësve u kërkohet punë e pavarur me qëllim të gjetjes së formave kryesore të relievit. Ata ndahen në grupe të vogla ku secilit grup i jepet nga një detyrë e veçantë. Duke u bazuar në tekst dhe në sqarimet e mësimdhënësit/es, ata kanë për detyrë që të identifikojnë malet kryesore, rrafshnaltat kryesore, shkretëtirat dhe ultësirat e kontinentit të Azisë. Kërkohet nga ta që të shënojnë në flet A4 (flipchart) dhe më pas të bëjnë prezantimin e punës së tyre.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Në pjesën përfundimtare paraqitet Kllasteri, ku nga nxënësit kërkohet që të shënohen së paku tri forma të secilës kategori të relievit:

Malet (Himalaje, Kun Lun, Pontiket, Altaj, Tien Shan... etj)

Rrafshnaltat (Tibeti, Dekanit, Anatolisë... etj)

Ultësirat (Menaxherisë, Kinës Lindore, Mesopotamisë, Ind... etj)

Shkretëtirat (Gobit, Takla Makan, Nefud, Rub el'Hali... etj)




## VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Duke u bazuar në numrat e dhënë në hartë e Azisë shënon format e relievit.
- Plotësim i aktiviteteve në fletore pune.

## REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Azisë | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Shpjegon rolin e hapësirës së madhe, ndikimin e deteve dhe të oqeaneve në klimë, ndikimin e erërave monsunike, pasurinë në ujëra dhe rrjetin hidrografik.<br>• Analizon ndryshimet e botës bimore, tajgën, stepen, makjet, savanet, xhunglat dhe t'i emërtojë kafshët e egra që jetojnë në regjionet e Azisë. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës** ***(të synuara)*****:**<br>I-1, 2, 3, 5; II-7, 8; III-2, 6, 7, 8; IV-3, 4, 6, 8; V-6; VI- 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës** ***(të synuara)*****: RNF:**<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet e pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinentit. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Veçoritë klimatike, hidrogafike dhe biogjeografike | | | |
| **Fjalët kyçe:** Faktorët klimatikë, tipat klimatikë, lumenjtë, liqenet, detet, oqeanet, xhunglat, savanet, stepet etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Vlerëson rolin e relievit në klimë, ujëra dhe shtrirjen e botës bimore dhe shtazore.<br>2. Shpjegon faktorët klimatikë që ndikojnë në llojllojshmërinë e klimës në Azi.<br>3. Dallon tipat klimatik në hapësirën e kontinentit.<br>4. Tregon ujëmbledhësit kryesorë dhe lumenjtë që i takojnë këtyre ujëmbledhësve.<br>5. Analizon shtrirjen gjeografike të zonave vegjetative.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Analizon faktorët klimatik dhe ndikimin e tyre në llojet e klimës, hidrografisë dhe botës së gjallë.<br>2. Numëron disa nga karakteristikat e tipave klimatik në Azi.<br>3. Tregon në hartë lumenjtë kryesorë dhe derdhjen e tyre në secilin ujëmbledhës.<br>4. Shpjegon shtrirjen e zonave vegjetative në kontinentin e Azisë. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**
Teksti 8, harta e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: harta klimatike, hidrografike dhe vegjetative e Azisë, foto, skica.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Fizikë, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse - Hapi i parë:** ***(Stuhi mendimesh)***

Fillimisht, mësimdhënësi/ja bën një përsëritje nga ora e kaluar duke iu rikujtuar nxënësve disa nga veçoritë natyrore që ndikojnë në zhvillimin e jetës.

Shënohen disa fjalë kyçe në tabelë: faktorët klimatikë, llojet e klimës, lumenjtë, liqenet, detet, oqeanet, xhunglat, savanet, stepet etj. Përmes fjalëve kyçe, nxënësit arrijnë deri të titulli i njësisë që do të zhvillohet.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:**

Mësimdhënësi/ja i ndanë nxënësit në 4 grupe.

Grupit të parë i cakton karakteristikat e veçorive klimatike.

Grupit të dytë i cakton veçoritë hidrografike.

Grupit të tretë i cakton përhapjen e botës bimore.

Grupi të katërt i cakton llojllojshmërinë e botës shtazore.

Nxënësit lexojnë dhe analizojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi, dhe bëhen ekspert të grupeve të tyre për kategoritë e caktuara natyrore. Mësimdhënësi/ja i cakton secilit grup numrat e nxënësve prej 1 deri 4. Pastaj, numrat 1 i bashkon në një grup, numrat 2 i bashkon në grupin tjetër, numrat 3 së bashku në grupin tjetër dhe numrat 4 në grupin e katërt. Nxënësit prezantojnë para grupeve pjesën për të cilën janë ekspert. Më pas, nxënësit kthehen në grupet e tyre amë (primare) dhe e ndajnë me shokët e tyre të grupit njohurit e marra nga grupet paraprake. Në këtë mënyrë bëhet shtjellimi i tërë njësisë mësimore.




**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që pas diskutimit në mes grupeve ta plotësojnë edhe pjesën e kërkuar në teknikën e klasterit.

Përveç plotësimit të veçorive të secilës kategori natyrore nga nxënësit kërkohet që të bëhet ndërlidhja dhe ndikimi në mes tyre

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Në hartën memece të Azisë shënon emrat e lumenjve dhe liqeneve kryesorë të saj.<br>• Bëni ndërlidhjen e klimës me vegjetacionin përmes fotove.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko - administrative të Azisë | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Dallon rajonet kryesore të përqendrimit të popullsisë në Azi dhe tregon shkaqet e tyre<br>• Analizon elementet e përgjithshme demografike të Azisë. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-1, 2, 3, 5; II-7, 8; III-2, 6, 7, 8; IV-3, 4, 6, 8; V-6; VI- 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale, religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Popullsia e Azisë dhe veçoritë shoqërore | | | |
| **Fjalët kyçe:** Numri i popullsisë, shtimi natyrorë, dendësia, raca, feja, gjuha, tradita, kultura etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Krahason numrin e madh të popullsisë së Azisë me kontinentet tjera.<br>2. Analizon karakteristikat kryesore të popullsisë si: dendësinë, shtimin natyror, strukturat dhe migrimet.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Diskuton për numrin e popullsisë së Azisë në raport me kontinentet tjera.<br>2. Dallon karakteristikat e shtimit natyror, dendësisë dhe shtrirjes së popullsisë së Azisë.<br>3. Analizon strukturat tjera të popullsisë si racat, fetë, gjuhët dhe kulturat në Azi. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**<br>Teksti 8, harta e politike Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: piramida e popullsisë, diagrame, foto, skica. | | | |

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK, Artet; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse - Hapi i parë:**

Mësimdhënësi/ja prezanton një video të shkurtër para nxënësve rreth karakteristikave të popullsisë së Azisë. Duke u bazuar në videon e paraqitur, nga nxënësit kërkohet të përshkruajnë në pikat kryesore strukturën e popullsisë së Azisë.

- Sa është numri i popullsisë së kontinentit të Azisë?
- Cilat raca të popullsisë gjinden në këtë kontinent?
- A dini ndonjë qytet të shenjte fetar në Azi?
- ....Etj.
- Shkrim i lirë: Nxënësit pas videoprezantimit për 2 minuta shënojnë disa nga më të veçantat që për ta ishin prezantuar në video prezantim.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:**

Mësimdhënësi/ja fillimisht sqaron para nxënësve karakteristikat e përgjithshme të popullsisë, më pas kërkon nga një nxënësit që të lexojë me zë paragrafin e parë, diskutohet me nxënësit e tjerë ajo pjesë, vazhdohet kështu me paragrafin e dytë......e kështu më radhë deri në fund të njësisë.

Në këtë mënyrë analizohet e tërë njësia mësimore, hapen diskutime rreth të gjitha strukturave të popullsisë së kontinentit të Azisë. Ata krahasojnë numrin e popullsisë me kontinentin e Europës, identifikojnë regjionet e Azisë që kanë dendësi dhe shtim të lartë të popullsisë, racat kryesore, fetë dhe qendrat e shenjta të tyre etj. Në vazhdim, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të plotësojnë tabelën me veçoritë kryesore demografike të popullsisë: racën, dendësinë, shpërndarjen, gjuhën, besimet etj.

| Racat | Besimet | Gjuhët | Dendësia | Shtimi natyror | Migrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |




**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë**

Në pjesën e fundit, nxënësit bëjnë një përmbledhje, duke i zgjeruar njohuritë me njëri-tjetrin. Reflektimi bëhet përmes aktiviteteve të paraqitura në tekst në fund të njësisë.

- Mësimdhënësi/ja sqaron pyetjet e pa qarta të nxënësve**.**

| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Analizon hartën e dendësisë dhe piramidën e popullsisë.<br>• Përmes fotove tregon llojet e religjioneve.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko - administrative të Azisë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Dallon grupimet kryesore politike dhe ekonomike në Azi, veprimtaritë kryesore ekonomike dhe rajonet tipike gjeografike të Azisë<br>• Identifikon pasuritë kryesore minerale dhe burimet energjetike të Azisë.<br>• Identifikon burimet kryesore energjetike dhe pasuritë minerare dhe degët kryesore të ekonomisë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 5; II-6, 8 III-2, 6, 7; IV-4, 6; V-3, 9; VI-1, 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale, religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Karakteristikat e zhvillimit ekonomik dhe ndarja (diferencimi) regjionale e Azisë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Pasuritë natyrore, minerale, grupime politike, degët ekonomike, bujqësia, industria, tregtia etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Identifikon pasuritë natyrore të kontinentit të Azisë.<br>2. Argumenton zhvillimin ekonomik të regjioneve të Azisë në raport me pasuritë natyrore.<br>3. Dallon grupimet kryesore politike, ekonomike dhe ndarjen regjionale.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Numëron pasuritë kryesore sipërfaqësore dhe nëntokësore të kontinentit të Azisë.<br>2. Identifikon degët kryesore ekonomike sipas regjioneve në Azi.<br>3. Tregon grupimet politike dhe ekonomike të krijuara në Azi.<br>4. Përcakton gjashtë regjionet e kontinentit të Azisë sipas veçorive natyrore dhe shoqërore të saj.</td></tr>
</table>

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**

Teksti 8, harta e politike Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: diagrame, foto, skica.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK, Artet; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa e hyrëse – Hapi i parë (Stuhi mendimesh)**

Mësimdhënësi/ja fillimisht parashtron pyetje e cila u mundëson nxënësve të japin përgjigjeje të ndryshme dhe këto pyetje shtrohen që nxënësit mos të kufizohen në përgjigje p.sh.:
Çfarë mendoni se dini rreth zhvillimit ekonomik të vendeve të Azisë?
A keni njohuri për ndonjë shtet të zhvilluar të kontinentit të Azisë?
A dini ndonjë pasuri natyrore të Azisë, të cilën e përdorim edhe në Kosovë?
Nxënësve u jepet kohë të mendojnë rreth pyetjeve dhe të përgjigjen. Në fund merren përgjigje të ndryshme nga shumë nxënës rreth pyetjeve të parashtruara.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë (I N S E R T)**

Mësimdhënësi fillimisht udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin dhe gjatë leximit ata vendosin shenjat:
,, √ " vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur.
,, - " vendoset në fund të informacionit i cili është ndryshe me atë që ju e dini.
,, + " informacioni që për ju është i ri (keni mësuar diçka të re).
,,? " informacion që është i paqartë (ose doni të dini më shumë).

| ,, √ " | ,, - " | ,, + " | ,,? " |
|---|---|---|---|
| -<br>-<br>- | | | |

1. Pas leximit, nxënësit në çifte diskutojnë çfarë lexuan, bisedojnë për informacionet e reja, krahasojnë shenjat etj. Mësimdhënësi/ja angazhon anëtar të grupit për të dhënë shpjegime dhe përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit.
2. Në mënyrë individuale radhiten informacionet në bazë të shenjave, kështu bëhet "tabela e insertit".

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë**

Në këtë pjesë, nxënësit reflektojnë rreth regjioneve të Azisë.

1. Cilat janë pasuritë natyrore më dominuese në Azi?
2. Ari i zi ka shtrirje më të madhe në cilin nga regjionet e Azisë?
3. Analizohen pasuritë natyrore dhe zhvillimi ekonomik i Azisë.
4. Bëhet ndarja e regjioneve të Azisë në bazë të veçorive shoqërore dhe ekonomike.

Mbi hartën memece të paraqitur të shënohen emërtimet e regjioneve:



| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente |
| kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Përmes ngjyrave në hartën e Azisë dallon gjashtë regjionet e kontinentit të Azisë.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:**

| **Fusha kurrikulare:** Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:** Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:** 4 | **Klasa:** VIII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema:**<br>Azia Jugperëndimore, veçoritë natyrore | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Shpjegon rolin e pozitës gjeografike të Azisë Jugperëndimore dhe vlerëson rëndësinë e saj në Azi dhe në botë.<br>• Dallon veçoritë kryesore të relievit (malet, ultësirat, rrafshnaltat dhe shkretëtirat), klimës, hidrografisë dhe botës bimore e shtazore, duke analizuar rëndësinë e tyre për jetën dhe veprimtaritë e njerëzve. |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**

I-1, 3, 5; II-6, 8 III-2, 6, 7; IV-4, 6; V-3, 9; VI-1, 2.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet, pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinentit.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:**

**Njësia mësimore:** Azia Jugperëndimore – veçoritë natyrore

**Fjalët kyçe:** Pozitë strategjike, lindja e afërt, lindja e mesme, kanali i Suezit, Anadolia, Gadishulli Arabik, Gjiri Persik, Mesopotamia, Deti i Vdekur, oaza etj.

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

1. Tregon rolin dhe rëndësinë e pozitës gjeografike të A.JP si regjion në mes kontinenteve të "botës së vjetër".
2. Identifikon format kryesore të përthyeshmërisë dhe relievit në Azinë jugperëndimore.
3. Analizon karakteristikat klimatike, hidrografisë dhe botës së gjallë në këtë regjion.

**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***

1. Arsyeton pozitën gjeografike të Azisë Jugperëndimore.
2. Gjen në hartë disa nga format kryesore të relievit (malet, rrafshnaltat, ultësirat, shkretëtirat) e AJP-së.
3. Tregon rolin e ngushticave, kanaleve, gjireve në pozitën gjeografike dhe ndërtimin e porteve detare të AJP-së.
4. Dallon llojet e klimës dhe rolin e saj në hidrografinë dhe vegjetacionin e AJP-së.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**

Teksti 8, harta fizike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK, Artet; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë (Asociacion)**

Fillimisht, mësimdhënësi/ja realizon një asociacion të shkurtër me disa fjalë kyçe për të arritur deri të njësia e re mësimore.

| Arabët | Naftë | Deti i Vdekur | Besimi islam |
|---|---|---|---|
| -<br>-<br>- | | | |

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë (ditari trepjesësh)**

Nxënësit orientohen për të lexuar njësinë mësimore dhe gjatë leximit do të merren shënime. Gjatë shënimeve udhëzohen nxënësit që fletën ta ndajnë në tri pjesë me vijë vertikale. Në pjesën e parë shkruajnë ndonjë citat nga teksti (pjesë që u bën përshtypje), në mes shkruhen komentet: Pse jemi përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri të mendoni? (komenti pse ju bëri përshtypje?) etj. Te shtylla e tretë bëhet arsyetimi apo argumentimi i mendimit apo komentit.
Njësia lexohet duke u ndalur, për të shënuar së paku katër herë deri në fund. Koha e leximit 20 minuta. Pas leximit kërkohen vullnetarë (2,3 veta) që të japin komentet e tyre. Më pas, nxënësit vullnetarë pyetën: Pse u tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çfarë ju bëri të mendoni?
Pyetet nëse ka ndonjë tjetër që e ka zgjedh të njëjtën pjesë?
Në fund, mësimdhënësi/ja jep komentet e veta të nxjerra për pjesët të cilat nuk janë trajtuar nga nxënësit.

| Citati | Komenti | Argumenti/arsyetimi |
|---|---|---|
| Në këtë rajon gjenden rrugë detare me rëndësi strategjike, si ngushtica e Bosforit, kanali i Suezit dhe ngushtica e Ormuzit.<br>……<br>…… | Pozitë e volitshme gjeografike dhe strategjike e Azisë Jugperëndimore.<br>……<br>…… | Kanale dhe ngushtica të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhjet komunikatave detare të shumë rajoneve të ndryshme të botës.<br>…… |

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë**

Mësimdhënësi/ja kërkon që në mënyrë individuale të plotësojë fletoren e punës duke u orientuar në hartën fiziko-gjeografike (hartën memece).



| **VLERËSIMI I NXËNËSVE:** |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Duke u bazuar në hartat e gadishujve cakton gadishullin e Azisë Jugperëndimore.<br>• Në hartën memece gjen qytetin e Stambollit dhe ngushticën e Bosforit.<br>• Në hartën memece shënon emrat e lumenjve Tigër, Eufrat dhe Jordan.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Analizon elementet kryesore demografike të Azisë Jugperëndimore.<br>• Identifikon qytetet më të njohura kulturore dhe religjioze të Azisë Jugperëndimore dhe identifikon zonat turistike.<br>• Identifikon burimet kryesore energjetike dhe pasuritë minerare dhe degët kryesore të ekonomisë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 5, 8; II-6, 7, 8; III-6, 8; IV-4, 6; V-5, 9; VI-1, 6.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme. 3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesitnë jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Azia Jugperëndimore – veçoritë shoqërore-ekonomike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Arabët, izraelitet, persianët, Meka, Medina, Jerusalemi, Stambolli, nafta, gazi natyror, gjiri Persik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Përshkruan karakteristikat kryesore demografike të Azisë Jugperëndimore.<br>2. Debaton për qytetet më të njohura kulturore dhe religjioze të Azisë Jugperëndimore dhe identifikon zonat turistike.<br>3. Arsyeton raportin e pasurive natyrore dhe zhvillimit ekonomik në këtë regjion.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Diskuton për grupet etnike, racat, fetë kulturat dhe traditat e popujve të Azisë Jugperëndimore.<br>2. Identifikon në hartë qytetet e njohura religjioze dhe turistike të Azisë Jugperëndimore.<br>3. Tregon pasuritë natyrore dhe degët kryesore ekonomike të këtij regjioni.</td></tr>
</table>

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**

Teksti 8, harta e politike Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:**

Fillimisht mësimdhënësi/ja prezanton një punim të përgatitur nga vet ai, përmes laptopit dhe projektorit, me anë të programit “Power Point”, ku prezantohen edhe foto, skica, video të ndryshme për veçoritë e popullsisë dhe ato ekonomike të Azisë Jugperëndimore, me anë të cilave nxiten nxënësit për një diskutim.



**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë *(shkrim i lirë)***

Nxënësit orientohen për një reflektim rreth asaj që u prezantua nga mësimdhënësi/ja dhe ata janë të lirë të shkruajnë rreth karakteristikave të popullsisë së Azisë Jugperëndimore dhe specifikave ekonomike.

- Nxënësit përshkruajnë grupet racore, fetare, etnike e kulturore të këtij regjioni.
- Nxënësit identifikojnë qytete më të vizituar që zhvillojnë pelegrinazhin nga mbarë bota.
- Nxënësit tregojnë për pasurit dhe degët e ekonomisë së Azisë Jugperëndimore.

Disa nga këto shkrime lexohen, diskutohen dhe komentohen në fund.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë *(organizues grafik)***

- Tabela përmban dy pjesë, në të majtë paraqiten argumentet pro, përparësitë, të mirat e dukurive apo specifikave të popullsisë së Azisë Jugperëndimore, ndërsa në të djathtë paraqiten argumentet kundër këtyre specifikave. Njëjtë veprohet edhe me karakteristikat tjera shoqërore, konflikteve që ndodhin në këtë rajon apo zhvillimit ekonomik.

Argumentet pro kulturës, traditës apo diferencave fetare në Azinë Jugperëndimore. Argumentet kundër kulturës, traditës apo diferencave fetare në Azinë Jugperëndimore.

| Argumentet pro kulturës, traditës apo diferencave fetare në Azinë Jugperëndimore. | Argumentet kundër kulturës, traditës apo diferencave fetare në Azinë Jugperëndimore. |
|---|---|
| 1<br>2 | 1<br>2<br>3<br>4<br>5 |

| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Rendit shtetet sipas sipërfaqes dhe dendësisë nga më e madhja deri të më e vogla.<br>• Gjen të përbashkëtat mes Mekës dhe Jerusalemit.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Dallon ngjashmëritë dhe specifikat natyrore, popullatës, kulturore, ekonomike dhe politike të Turqisë, Iranit dhe Arabisë Saudite. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Turqia, Arabia Saudite dhe Irani. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Anadolia, Bosfori, Stambolli, mesdhetare, turqit, arabët, persianët, Meka, Medina, nafta, gazi natyror, gjiri Persik etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Analizon ngjashmëritë dhe dallimet e veçorive gjeografike në mes të këtyre tri shteteve.<br>2. Krahason specifikat popullatave në mes këtyre shteteve.<br>3. Diskuton për zhvillimin e degëve ekonomike të secilit shtet.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Krahason veçoritë natyrore në mes Turqisë, Arabisë Saudite dhe Iranit.<br>2. Vlerëson specifikat etnike, fetare, kulturore dhe ekonomike në mes tri këtyre shteteve.<br>3. Diskuton rreth rolit politik dhe ekonomik të këtyre shteteve në Azinë Jugperëndimore. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**

Teksti 8, harta e politike Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:**

Fillimisht mësimdhënësi/ja prezanton një punim të përgatitur nga vet ai, përmes laptopit dhe projektorit, me anë të programit "Power Point", ku prezantohen edhe foto, skica, video të ndryshme për veçoritë e popullsisë dhe ato ekonomike të Azisë Jugperëndimore, me anë të cilave nxiten nxënësit për një diskutim.

| | | | |
|---|---|---|---|
| A1 | B1 | C1 | D1 |
| A2 | B2 | C2 | D2 |
| A3 | B3 | C3 | D3 |
| A4 | B4 | C4 | D4 |
| A | B1 | C1 | D1 |
| Përfundimtare! | | | |

**Pjesa kryesore - Hapi i dytë:** ***(punë në grupe)***

Nxënësit ndahen në tri grupe, ku secilit grup i ndahen pyetje të përgatitura nga mësimdhënësi/ja për tri shtetet e Azisë Jugperëndimore.

Gr.1 **Turqia**

- Përkufizoni shtetin e Turqisë dhe tregoni rëndësinë e pozitës gjeografike.
- Tregoni format kryesore të relievit në Turqi.
- Cilat janë karakteristikat demografike të popullsisë së Turqisë?
- Çfarë e bën Turqinë një shtet të zhvilluar ekonomik?

Gr.2 **Arabia Saudite**

- Çfarë e karakterizon hapësirën më të madhe të këtij shteti për nga relievi dhe klima?
- Cilat janë të veçantat e popullsisë së Arabisë Saudite?
- Çfarë konsiderohet pasuri kombëtare e këtij shteti?
- Cili është niveli i zhvillimit ekonomik i Arabisë Saudite?

Gr.3 **Irani**

- Tregoni pozitën gjeografike dhe përkufizimin e Iranit.
- Numëroni disa nga karakteristikat e popullsisë së këtij shteti.
- Me cilat pasuri natyrore është i pasur ky shtet dhe çfarë zhvillimi ekonomik ka?

Fillimisht, nxënësit lexojnë tekstin për veçoritë e shtetit i cili u është caktuar, dhe në fletë A4 (flipchart) mundohet t'i përgjigjen pyetjeve dhe detyrave të parashtruara nga mësimdhënësi/ja.

Në fund përfaqësuesi i grupit prezanton punën e grupit, ndërsa nga grupet tjera shtrohen pyetje shtesë apo komente.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Mësimdhënësi/ja orienton nxënësit që të bëhet krahasimi i të tri-ja shteteve Turqisë, Arabisë Saudite dhe Iranit me anë të teknikës "Diagrami i Venit" duke i paraqitur të veçantat dhe të përbashkëtat në mes shteteve.




**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Plotëson tabelën e dhënë duke i krahasuar disa nga karakteristikat kryesore të veçorive natyrore dhe shoqërore të tri shteteve të Azisë Jugperëndimore.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:**

| **Fusha kurrikulare:** | **Lënda:** | **Shkalla e kurrikulës**: | **Klasa:** |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | Gjeografi | 4 | VIII |

| **Tema:** | **Rezultati i të nxënit të temës:** |
|---|---|
| Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore | • Identifikon veçoritë e përgjithshme fiziko-gjeografike të Azisë Jugore; vargmalet, malet e vjetra, ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.<br>• Identifikon elementet kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të Azisë Jugore<br>• Arsyeton tipat e klimës mes pjesëve veriore dhe jugperëndimore e jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Azisë Jugore.<br>• Analizon veçoritë hidrografike të Azisë Jugore, Juglindore dhe Lindore. |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**

I-1, 2; II-1, 8; III-6, 8; IV-3, 4, 8; V-1, 5; VI-1, 2, 6.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinentit.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:**

**Njësia mësimore:** Azia Jugore - veçoritë natyrore.

**Fjalët kyçe:** Pozita jugore, relievi, monsunet, Indi, Gangu, xhunglat, savanet, shkretëtira Tar, Himalajet etj.

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

1. Përshkruan pozitën gjeografike dhe përthyeshmërinë bregdetare të Azisë Jugore.
2. Dallon tri format kryesore të Azisë Jugore (Malet në Veri, Ultësirën e Hindistanit dhe Rrafshnaltën e Dekanit).
3. Analizon veçoritë klimatike, hidrografike dhe biogjeografike të Azisë Jugore.

**Kriteret e suksesit: *(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***

1. Analizon pozitën e mirë gjeografike të Azisë Jugore.
2. Përshkruan tri format kryesore të relievit të Azisë Jugore.
3. Shpjegon karakteristikat e klimës monsunike në Azisë Jugore.
4. Tregon ndikimin e klimës monsunike në hidrografi dhe vegjetacionin e Azisë Jugore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**

Teksti 8, harta fizike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë (mendim i lirë)**

Në pjesën e parë mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit shënon kriteret e suksesit dhe fjalët kyçe për njësinë mësimore: pozita jugore, relievi, monsunet, Indi, Gangu, xhunglat, savanet, shkretëtira Tar, Himalaje etj. më pastaj kërkon mendim të lirë nga nxënësit për fjalët kyçe të cilat janë shënuar në tabelë. Disa nga mendimet e sakta të nxënësve shënohen në tabelë.

| Pozita gjeografike | Përthyerja bregdetare | Relievi | Klima | Ujërat | Bota bimore e shtazore |
|---|---|---|---|---|---|
| Shtrirja:<br>kufiri:<br>madhësia:<br>shtetet | Ishuj<br>Gadishuj<br>Gjiret<br>ngushticat | Malet<br>Ultësirat<br>Rrafshnaltat<br>luginat lumore | Brezi klimatik<br>Tipat<br>Reshje<br>erërat | Lumenjtë<br>Liqenet<br>ujëmbledhësit | Llojet e botës<br>Bimore<br>Tokat<br>llojet e kafshëve |

Në fund bëhet përmbledhje e asaj që u diskutua duke plotësuar tabelën e paraqitur nga ajo që e mësuam gjatë kësaj ore mësimore, fillimisht paraqitja bëhet në mënyrë individuale e më pas edhe në qifte, duke e plotësuar tabelën e paraqitur nxënësit vlerësohen në bazë nivelit të përgjigjeve të dhëna.

**Pjesa përfundimtare Hapi i tretë (punë individuale)**

Në fletoren e punës, nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale pyetjet dhe detyrat që i përkasin kësaj njësie mësimore.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Vendos në hartën e Azisë Jugore format kryesore të relievit.
- Vendos emrat e lumenjve në hartën memece të Azisë Jugore.
- Dallon monsunet verore nga ato dimërore

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | Gjeografi | 4 | VIII |

**Tema:**

Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë

**Rezultati i të nxënit të temës:**

- Analizon tiparet e demografike, ekonomike dhe kulturore të Azisë Jugore.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**

I-3, 5, 8; II-2, 6, 7, 8; III-2, 7; IV-6; V-3, 6; VI-2.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.
3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.
4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.
4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:**

**Njësia mësimore:** Azia Jugore – veçoritë shoqërore-ekonomike.

**Fjalët kyçe:** Vedet, dravët, hindusët, mbipopullim, shtim i lartë, çaji, pambuku, pasuritë natyrore.

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

1. Shpjegon specifikat kryesore të popullsisë në Azinë Jugore.
2. Identifikon karakteristikat e ekonomisë së Azisë Jugore.

**Kriteret e suksesit: *(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***

1. Analizon numrin, shtimin natyrorë dhe dendësinë e popullsisë së Azisë Jugore.
2. Dallon grupacionet kryesore etnike, gjuhësore, fetare të popullsisë së Azisë Jugore.
3. Përshkruan degët kryesore ekonomike të Azisë Jugore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**

Teksti 8, harta politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: piramida e popullsisë, grafikoni i popullsisë, foto, skica, video.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse, kryesore dhe përfundimtare – *(Di, Dua të, Mësoj)***

Në fillim mësimdhënësi/ja paraqet në dërrasë të zezë një tabelë e ndarë në tri pjesë:

- Nxënësit orientohen për njësinë mësimore e cila do të trajtohet.
- Në fazën e parë shtrohet pyetja: Çfarë dini për popullsinë dhe veçoritë ekonomike të Azisë Jugore? Ata mendojnë për disa minuta dhe ato të cilat i di i shënojnë në fletat e tyre.
- Nga përgjigjet e nxënësve plotësohet pjesa "DI".
- Pjesa "DUA TË DI" plotësohet pasi në i kemi pyetur nxënësit se cilat janë ato njohuri që dëshirojnë t'i njohin?
- Pyetjet e nxënësve shënohen te rubrika "DUA TË DI".

| DI | DUA TË DI | MËSOJ |
|---|---|---|
| Përfshin fazën e parë të orës. Shënohen njohuritë të cilat i kanë të njohura nxënësit | Nxënësit bëjnë pyetje për karakteristikat e popullsisë dhe veçoritë ekonomike të Azisë që nuk i di. Pyetjet shënohen në këtë pjesë | Në pjesën përfundimtare të orës plotësohet kjo pjesë pas leximit të tekstit. |

- jepet të lexohet mësimi nga teksti, pas leximit nxënësit pyeten a kanë përgjigje për pyetjet e shënuara në rubrikën DUA TË DI. Nëse ka përgjigje, ato shënohen në pjesën MËSOJ.
Kjo teknikë mund të realizohet në tri fazat e orës.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit, duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë e orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Analizon hartën e dendësisë së popullsisë së Azisë Jugore.
- Tregon llojet e kulturave bujqësore që mbillen në këtë rajon, në bazë të fotove.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Analizon specifikisht tiparet natyrore, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike të shtetit të Indisë dhe Pakistanit, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës** ***(të synuara)*****:**<br>I-1, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-2, 6, 8; IV-4, 8; V-1, 5, 9; VI- 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës** ***(të synuara)*****: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** India dhe Pakistani. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Mahatma Gandi, Oqeani Indian, Grykëderdhjet, aluvione, Indi dhe Gangu, Hindu, Islamizmi, Taxh Mahali, pambuku. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Tregon dallimet dhe ngjashmëritë natyrore në mes të dy këtyre vendeve fqinjë.<br>2. Arsyeton nivelin e ndryshëm ekonomiko- shoqëror në mes Indisë dhe Pakistanit.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Krahason veçoritë e relievit, klimës, ujërave dhe botës së gjallë në mes Indisë dhe Pakistanit.<br>2. Debaton për karakteristikat e popullsisë dhe veçorive ekonomike në mes këtyre shteteve. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**<br>Teksti 8, harta politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: piramida e popullsisë, grafikoni I popullsisë, foto, skica, video. | | | |

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(PASAPORTA)***



Në pjesën hyrëse, mësimdhënësi/ja paraqet përmes projektorit hartën e shteteve të Azisë Jugore. Kërkohet nga nxënësit që në atlaset e tyre t'i identifikojnë dy shtetet të cilat janë për tu trajtuar në këtë njësi mësimore.

Secili grup do të ketë pjesën e vet, nga një flipchart dhe marker për të shkruar. Mësimdhënësi/ja u jep informacionet bazike "Pasaportën" e shteteve, dhe në mënyrë individuale nxënësit japin komentet e tyre.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:** ***(Puna me grupe)***

Më pas, nxënësve u kërkohet që secili grup, duke konsultuar me tekstin, të nxjerrin të dhënat për dy shtetet. Derisa ata të lexojnë dhe nxjerrin shënimet, e të përvetësojnë pjesë të cilat u caktohen dhe pastaj t'i thonë para tjerëve mësimdhënësi/ja i viziton grupet dhe u jep sqarime e njëkohësisht në tabelë shënon tabelën e mëposhtëm. Pas përfundimit prezantohet njësia e parë, pastaj e dyta e krejt në fund nxirën të përbashkëtat:

| Shteti: | India | Pakistani | Të përbashkëtat |
|---|---|---|---|
| Pozita gjeografike | | | |
| Relievi | | | |
| Klima | | | |
| Ujërat | | | |
| Bota e gjallë | | | |
| Veçoritë demografike | | | |
| Zhvillimi ekonomik | | | |

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë - Prezantim dhe krahasim**

Në fund prezantohen të dhënat e nxjerra nga secili grup për shtetin e vet, ku krahasohen veçoritë natyrore dhe shoqërore të tyre, gjendën edhe të përbashkëtat dhe të veçantat e të dyja shteteve. Zhvillohet një rrjet diskutimi rreth ecurive në zhvillimin ekonomik të Indisë dhe Pakistanit.

| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
| --- |
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Gjen dallimet dhe të përbashkëtat në mes Indisë dhe Pakistanit përmes Diagramin e Venit.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Shpjegon rolin e pozitës gjeografike dhe të evidenton veçoritë kryesore të pozitës gjeografike.<br>• Gjen në hartë sistemet malore, ultësirat e mëdha pjellore, lumenjtë dhe luginat lumore më të njohura dhe arsyeton pse nëpër ishujt e Indokinës ndodhin tërmete e vullkane.<br>• Analizon veçoritë klimatike të Azisë Juglindore.<br>• Analizon veçoritë hidrografike të Azisë Jugore, Juglindore dhe Lindore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 5, 8; II-6, 7, 8; III-6, 8; IV-4, 6; V-5, 9; VI-1, 6.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1 Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinentit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Azia Juglindore – veçoritë natyrore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Gadishuj, grup-ishuj, gjiret, ngushtica, vullkane, tërmete, tajfune, pyje të shiut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike dhe të përthyeshmërisë bregdetare të Azisë Juglindore.<br>2. Përshkruan tërësitë relievore dhe aktivitetet sizmike që ndodhin në këtë regjion.<br>3. Krahason veçoritë klimatike, hidrografike dhe të botës së gjallë në mes pjesës kontinentale dhe asaj ishullore të Azisë Juglindore.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Tregon rëndësinë e pozitës gjeografike të Azisë Juglindore.<br>2. Identifikon në hartë gadishujt, ishujt, gjiret, ngushticat kryesore të Azisë Juglindore.<br>3. Shpjegon tërësitë relievore dhe aktivitetin sizmik në Azisë Juglindore.<br>4. Analizon disa nga veçoritë klimatike, hidrografike dhe të botës së gjallë në Azinë Juglindore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore<br>Teksti 8, harta fizike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.</td></tr>
</table>

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: |
|---|

**Pjesa hyrëse dhe kryesore – Hapi i parë dhe i dytë *(Kubimi)***
Nga nxënësit kërkohet që të analizohet fillimisht njësia mësimore në tekst. Më pastaj udhëzohen nxënësit për mënyrën e punës të cilën duhet ta zbatojnë. Zbulohen 6 fazat nëpër të cilat do të punohet (shkruhet në mënyrë individuale, në secilën faze epen udhëzimet se çfarë duhet të shkruhet, dhe në mes të fazave epët hapësirë që nxënësit të shkruajnë)

- Përshkruaje pozitën gjeografike të Azisë Juglindore.
- Krahasoje përthyeshmërinë bregdetare me rajonet tjera të Azisë.
- Shoqëroje kujtoje ndonjë ngjarje e aktiviteteve sizmike që kanë ndodhur në Azinë Juglindore.
- Analizoje karakteristikat klimatike dhe hidrografike të Azisë Juglindore.
- Zbatoje në hartën memece të Azisë Juglindore shëno emrat e shteteve që shtrihen në këtë rajon.
- Arsyetoje zhvillimin e lartë ekonomik të disa shteteve të Azisë Juglindore.

Qëllimi kryesor i kësaj teknike është përdorimi i pyetjeve të niveleve sipas Taksonomisë së Blumit. Nxënësit duke shfrytëzuar pyetjet apo kërkesat e mësimdhënësit kalojnë nga njohja, kuptimi, analiza, sinteza e deri te vlerësimi.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë *(Mini kuiz) pyetje-përgjigje.***

1. Çfarë pozite gjeografike ka Azia Juglindore?
   a) të mirë strategjike; b) relativisht të mirë; c) të pa përshtatshme.
2. Cili nga këta ishuj i takon Azisë Juglindore?
   a) Cejloni b) Hokaido c) Sumatra d) Qipro
3. Në Azinë Juglindore dominojnë klimat:
   a) kontinentale dhe shkretinore b) tropikale dhe ekuatoriale c) polare dhe subpolare.
4. Azia Juglindore njihet me prodhimin e:
   a) orizit b) grurit c) kakaos d) pangjarsheqerit

| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë e orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Në hartën memece të Azisë Juglindore shënon emrat e shteteve dhe kryeqyteteve.
- Në hartën memece të Azisë Juglindore shënon emrat e gadishujve dhe ishujve kryesorë.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

| REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE: |
|---|

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Identifikon veçoritë etnike, fetare dhe ekonomike-turistike së Azisë Juglindore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-2, 6, 8; IV-4, 8; V-1, 5, 9; VI- 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Azia Juglindore – veçoritë shoqërore-ekonomike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Tajët, vietnamez, indonezianët, malajzianët, racë e verdhë, negride, minerale, pyjet, zhvillim ekonomik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Diskuton rreth specifikave etnike, fetare dhe kulturore të Azisë Juglindore.<br>2. Tregon resurset ekonomike të Azisë Juglindore dhe nivelin ekonomik të shteteve ishullore të Azisë Juglindore<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Përshkruan saktë grupet etnike, racore dhe fetare në Azinë Juglindore.<br>2. Tregon rolin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik të shteteve të Azisë Juglindore.<br>3. Dallon shtetet më të zhvilluara të Azisë Juglindore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore<br>Teksti 8, harta politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: hartë e resurseve natyrore, piramida e popullsisë, foto, skica, video.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(diskutim)***

Pasi mësimdhënësi/ja shënon kriteret e suksesit dhe fjalët kyçe, jep sqarimet kryesore për njësinë e cila do të trajtohet. Duke u bazuar në njohuritë paraprake për kontinentin e Azisë parashtrohen disa pyetje:

- Si mendoni, cila race e popullsisë dominon në Azinë Juglindore?
- A mendoni se Azia Juglindore është e pasur me pasuri natyrore?
- Cilat shtete shtrihen në këtë rajon? Etj.

Në këtë mënyrë synohet të arrihet te njohuritë bazike të Azisë Juglindore në aspektin demografik dhe ekonomik.




**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:** ***(Ruaje fjalën e fundit për mua)***

- Nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të njësisë mësimore të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ata janë më interesante. Pjesët e zgjedhura (paragrafi) dhe numri i faqes ku është marrë pjesa shkruhen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citatin (pse e ka zgjedh atë pjesë?)
- Njëri nga nxënësit e tregon faqen ku e ka zgjedhë pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit, të tjerët japin mendimet e tyre rreth citatit.
- Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. E njëjta ecuri e leximit të citateve, dhe komentimit praktikohet edhe te nxënësit tjerë. Në këtë mënyrë realizohet pjesa kryesore e njësisë me komente, diskutime dhe analizë të dukurive demografike dhe ekonomike të Azisë Juglindore.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:** ***(kllasteri)***

Mësimdhënësi/ja në qendër të tabelës shënon njësinë dhe i jep disa ndarje; gjatë kësaj kohe, nxënësit fillimisht në dyshe e pastaj edhe në grupe e plotësojnë, duke i treguar informatat e marra gjatë zhvillimit të orës mësimore.

**Vërejtje**: teknika klasteri është dhënë vetë si shembull.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
| --- |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Duke u bazuar në foto dallon racat dhe degë ekonomike të turizmit në Azinë Juglindore.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Speecifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Analizon specifikat natyrore, demografike, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Azisë Juglindore- Indonezisë, Malajzisë dhe Singaporit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V- 3, 6; VI-3, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Indonezia, Malezia dhe Singapori.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Indonezian, Malezian, tërmete, cuname, klimë ekuatoriale, tropikale, xhungla, zhvillim i lartë ekonomik, pasuritë natyrore, port etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Analizon veçoritë natyrore dhe demografike të Indonezisë, Malëzisë dhe Singaporit.<br>2. Arsyeton zhvillimin e lartë ekonomik të këtyre shteteve të A.JL në raport me pasuritë natyrore të tyre.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Tregon karakteristikat e relievit, aktiviteteve sizmike dhe veçorive tjera natyrore në këto tri shtete.<br>2. Identifikon veçoritë etnike, racore, fetare dhe kulturore të Indonzisë, Malezisë dhe Singaporit.<br>3. Krahason karakteristikat ekonomike në mes këtyre tri shteteve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore<br>Teksti 8, harta fizike dhe politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: hartë e resurseve natyrore, piramida e popullsisë, foto, skica, video.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(Individuale)***




Mësimdhënësi/ja fillimisht i njofton nxënësit për njësinë mësimore që do të zhvillohet. Paraqet hartën politike të Azisë Juglindore në projektor, kërkon nga nxënësit që në atlaset e tyre personale t'i gjejnë Indonezinë, Malajzinë dhe Singaporin. Kërkon përkufizimin e tyre dhe shtetet me të cilat kufizohen, të dallojnë se cila nga këto tri shtete është (kontinental dhe ishullor).
Mësimdhënësi/ja pasi diskuton së bashku më nxënësit ai në tabelë i shënon disa fjalë kyçe: islami, budizmi, pasuritë xeherore, nafta, kauçuku, orizi, arkipelagu i Malakës, tërmetet – cuname, vullkane.
https://www.geoguessr.com/seterra/sq/vgp/3107

**Pjesa e kryesore – Hapi i dytë:** ***(punë në dyshe) Diagram i Venit***

Në këtë fazë, nga nxënësit kërkohet që këto tri shtete të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit. Puna bëhet në dyshe e pastaj edhe në grupe ku ndahen nxënësit.
Gr.1 Njëri grup i nxënësve e trajton pjesën e Indonezisë.

Gr.2 Grupi tjetër i nxënësve – Malajzisë.

Gr.3 Grupi i tretë Singaporin.

Forma e diagramit mund të përzgjidhet sipas dëshirës dhe mjeteve që posedojnë me mundësi më të mira (në formë rrathëve, shtyllave, katrorëve.....). Mësimdhënësi/ja i orienton nxësit (formë më e shkurtër) një nga një, ta plotësojnë diagramin në tabelë (i vizatuar).



INDONEZIA
Shtrirja: Azia Juglindore
Sipërfaqja: 1.919.445 km2
Kryeqytet: Xhakarta
Popullsia: 256 milionë banorë



MALEZIA
Shtrirja: Azia Juglindore
Sipërfaqja: 329.758 km2
Kryeqytet: Kuala Lampur
Popullsia: 30.5 milionë banorë



SINGAPORI
Shtrirja: Azia Juglindore
Sipërfaqja: 648 km2
Kryeqytet: Singapori
Popullsia: 5.6 milionë banorë

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë** ***Prezantimi – përshkrimi i punës grupore.***

Mësimdhënësi/ja formon një tabelë ku i paraqet elementet natyrore dhe shoqërore të tria shteteve duke i plotësuar nga nxënësit në bazë të dhënave të marra gjatë trajtimit të njësisë mësimore të zhvilluar. Nxënësit ndahen sipas përzgjedhjes vullnetare ose edhe nga mësimdhënësi/ja.

| Indonezia | Relievi | Klima | Ujërat | Popullsia | Ekonomia | Pasuritë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| Malajzia | Relievi | Klima | Ujërat | Popullsia | Ekonomia | Pasuritë |
| | | | | | | |
| Singapori | Relievi | Klima | Ujërat | Popullsia | Ekonomia | Pasuritë |
| | | | | | | |

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Në hartën memece të Indonezisë shënon: *Ishujt kryesor, dy ngushticat kryesore dhe kryeqytetin.*
- Plotësoni tabelën me karakteristikat e shteteve të Indonezisë dhe Malajzisë.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Shpjegon rolin e pozitës gjeografike dhe të evidenton veçoritë kryesore të pozitës gjeografike.<br>• Krahason viset perëndimore dhe lindore, kontinentale dhe ishullore nga relievi, klima dhe hidrografia. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-1, 2; II-1, 8; III-6, 8; IV-3, 4, 8; V-1, 5; VI-1, 2, 6. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>2.1 Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinentit. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Azia Lindore (Lindja e Largët) – veçoritë e përgjithshme gjeografike dhe natyrore. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Lindje e largët, Tibeti, Gobi, Manxhuria, ishujt Japonezë, Gadishulli Korean, monsunet, tajfunet, Jang Ce, bambuja, Panda etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Azisë Lindore.<br>2. Krahason viset perëndimore dhe lindore, kontinentale dhe ishullore për nga relievi, klima dhe hidrografia.<br>**Kriteret e suksesit: *(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Përshkruan pozitën gjeografike kontinentale dhe ishullore të Azisë Lindore.<br>2. Numëron disa nga format kryesore të relievit në Azinë Lindore.<br>3. Krahason veçoritë klimatike, hidrografike dhe të botës së gjallë në mes pjesëve lindore dhe perëndimore të këtij regjioni. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**<br>Teksti 8, harta fizike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, foto, skica, video. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media. | | | |

| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** |
|---|

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(braistroming)***

Mësimdhënësi/ja vendos hartën e murit dhe kërkon nga nxënësit që të identifikojnë shtetet e Azisë Lindore, më pastaj në mënyrë individuale edhe në atlas. Pasi identifikohen shtetet, veçohen shtetet që kanë dalje në det-oqean. Në tabelë shënohen fjalët kyçe si: rrafshnalta e Tibetit, Gobi, Manxhuria, Hajnan, shtrirja më skajore e Azisë Lindore, savanat, liqenet, bota shtazore... Duke u bazuar në fjalët kyçe mundësohet njohja e disa prej veçorive natyrore të Azisë Lindore.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:**

**Pyetje dhe komente** ***(punë individuale)***

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë mësimore në tekst në mënyrë individuale. Deri sa nxënësit lexojnë, mësimdhënësi/ja shënon në tabelë disa pyetje ku nxënësit pas leximit i plotësojnë me ato fragmente që mendojnë se e plotësojnë pyetjen e parashtruar.

| Pyetje | Përgjigje: |
|---|---|
| 1. Përshkruaj shtrirjen e pozitës gjeografike të Azisë Lindore. | |
| 2. Në cilat dete/oqeane ka dalje Azia Lindore? | |
| 3. Lumenjtë më të rëndësishëm në Azinë Lindore. | |
| 4. Cilët janë elementet kryesore fiziko-gjeografike të Azisë Lindore? | |
| 5. Cila është maja më e lartë e Azisë që gjendet në këtë regjion? | |
| 6. Identifikoni liqenet më të mëdha në këtë regjion. | |
| 7. Përshkruaj klimën sipas shtrirjes gjeografike. | |

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:** ***Punë në dyshe (KLASTER).***

Pasi që lexohet, në tabelë formohet Klaster në qendër të tabelës se zezë shënohet (AZIA LINDORE) dhe kërkohet nga nxënësit të bashkëpunojnë në dyshe (sipas bankës) që të përmblidhen të dy pjesët (shoqërore dhe natyrore). Nxënësit në formë vullnetare ose aktivizohen nga mësimdhënësi/ja që të plotësojnë klasterin me përgjigjet që kërkohen për regjionin e Azisë Lindore



| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Duke u bazuar në hartën Azisë Lindore, përshkruan shtrirjen e ishujve dhe emërto ata me të mëdhenjtë.<br>• Në bazë të disa karakteristikave dallon shtetin e Japonisë.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë; Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Analizon specifikat popullatës, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të Azisë Lindore dhe shteteve kryesore (Kina, Japonia dhe të dy Koretë). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-3, 5, 8; II-2, 6, 7, 8; III-2, 7; IV-6; V-3, 6; VI-2. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Veçoritë demografike dhe ekonomike të Azisë Lindore. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Kinezët, japonezët, raca e verdhë, teknologji, pasuritë natyrore, zhvillim industrial, budizmi etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Komenton specifikat e popullatës, fetare, historike, kulturore e sociale.<br>2. Argumenton nivelin e zhvillimit ekonomik të shteteve të Azisë Lindore.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Analizon karakteristikat demografike të Azisë Lindore.<br>2. Tregon pasuritë natyrore dhe zhvillimin ekonomik të shteteve të Azisë Lindore. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**<br>Teksti 8, harta politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, grafikoni I popullsisë, foto, skica, video. | | | |

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(stuhi mendimesh)***
Mësimdhënësi/ja pasi i shënon fjalët kyçe në tabelë, ju drejtohet nxënësve me disa pyetje për t'i drejtuar ata drejt njësisë mësimore.:
- Si mendoni, cili nga regjionet e Azisë ka numër më të madh të popullsisë?
- A e dini se cila racë e popullsisë dominon në Azinë Lindore?
- Keni dëgjuar ndonjëherë për civilizimet Kineze?
- A e dini cilat vetura japoneze gjinden edhe në Kosovë?

Mësimdhënësi/ja pret përgjigjet e nxënësve dhe i shënon në tabelë.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:** ***(Truri i Galerisë)***
Në këtë pjesë mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në 4 grupe duke ju ndarë kategori të ndryshme të njësisë mësimore. Ata udhëzohet të punojnë në mënyrë të pavarur dhe njohuritë e tyre t'i shënojnë në flip chart.
Grupi 1 – udhëzohet të punojë rreth karakteristikave të popullsisë së Azisë Lindore. t'i veçojnë racën kryesore, popujt, fetë të cilat dominojnë, hapësirat më të dendura, shtimin natyrorë etj.
Grupi 2 – udhëzohet të punojë rreth pasurive natyrore të cilat i ka ky rajon si: mineralet kryesore, pyjet, kullosat, tokat punuese, pasuria me ujëra etj.
Grupi 3 – udhëzohet të punoj rreth zhvillimeve historike të këtij rajoni. Civilizimet e hershme, zbulimet, monumentet historike etj.
Grupi 4 – udhëzohet të punojë rreth zhvillimit ekonomik të shteteve të këtij rajoni. Shtetet më të zhvilluara dhe ato më pak të zhvilluara, degët kryesore ekonomike, prodhimet bujqësore, industriale, turizmit, komunikacionit etj.
Pasi të përfundohet, punimet vendosen në muret e klasës.
Më shenjë të mësuesit/es, nxënësit lëvizin rreth klasës, shikojnë punimet, diskutojnë për ato, shkruajnë komente etj.
Në fund grupet marrin punimet e veta, rishikojnë, krahasojnë me punimet e të tjerëve, lexojnë komentet e mara nga të tjerët.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë: (3, 2, 1)**
Pas përmbledhjes përfundimtare, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që në mënyrë individuale të shënojnë në fletore:
- 3 karakteristika kryesore të popullsisë së Azisë Lindore.
- 2 degët më të rëndësishme ekonomike të Azisë Lindore.
- 1 aspekt interesant nga Azia Lindore që atyre ju ka lënë përshtypje.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Lidh me shigjetë qytetet për shtetet përkatëse (Kinë dhe Japoni).<br>• Përcakton fenë më të përhapur në Azinë Lindore.<br>• Gjen disa monumente kulturore historike të Kinës.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë; Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Analizon specifikat e popullatës, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të Azisë Lindore dhe shteteve kryesore (Kina, Japonia dhe të dy Koretë). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-3, 5, 8; II-2, 6, 7, 8; III-2, 7; IV-6; V-3, 6; VI-2. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Kina – veçoritë gjeografike-natyrore dhe shoqërore-ekonomike. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Tibeti, Jang Ce, Takla Makan, busulla, papirusi, kinezët, muri Kinez, teknologji, pasuritë natyrore, zhvillim industrial, budizmi etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Krahason veçoritë natyrore të Kinës me shtetet tjera të Azisë Lindore.<br>2. Analizon karakteristikat e popullsisë dhe ekonomisë së shtetit kinez.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Përcakton në hartë pozitën gjeografike të Kinës.<br>2. Vlerëson veçoritë natyrore të shtetit Kinez.<br>3. Analizon aspektin historik dhe demografik të popullsisë së Kinës.<br>4. Shpjegon raportin në mes pasurive natyrore dhe zhvillimit të lartë ekonomik të Kinës. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore**<br>Teksti 8, harta fizike dhe politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, grafikoni I popullsisë, foto, skica, video etj. | | | |

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse - Hapi i parë:**
Në pjesën hyrëse mësimdhënësi/ja shfaq në projektor foto të ndryshme për historikun e civilizimi Kinez, monumenteve kulturore-historike, zbulimeve të hershme të Kinezëve etj., në mënyrë që nxënësit të ambientohen me atë se çfarë do të trajtohet në vazhdim.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:** ***(dora e verbër)***
Fillimisht mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në 5 grupe. Ai kujdeset që secili grup të këtë nxënës sa kategori ka njësia mësimore. Në copëza fletësh, mësimdhënësi/ja ka ndarë veçoritë natyrore dhe shoqërore në kategori si: pozitën gjeografike të Kinës, relievin, klimën-hidrografinë dhe botën e gjallë, popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Kinës. Secilit nxënës i jepet nga një pjesë e njësisë mësimore (kategori). Çdo nxënës lexon pjesën e vet, në mënyrë që të jetë në gjendje t'ju flasë nxënësve tjerë për atë pjesë. Duke parë që veçoritë natyrore dhe shoqërore të Kinës janë të shpërndarë në tërë grupin, nxënësit punojnë në organizimin (renditjen) e materialit, duke analizuar secili pjesën e vet dhe duke bërë pyetje për pjesët tjera. Nxënësit diskutojnë në grup nëse materiali është renditur si duhet apo ka mundësi ndryshimi në radhitje. Pasi që titulli i njësisë mësimore nuk dihet atëherë secili grup në bazë të përmbajtjes së materialit nxjerr një titull për njësinë mësimore sipas dëshirës. Mësimdhënësi/ja në fund zbulon titullin e mësimit, dhe bën përshkrimin e radhitjes mësimore. Grupet kontrollojnë nëse ata kanë bërë radhitje të drejtë të njësisë mësimore:
- pozitë gjeografike
- reliev
- klimë
- hidrografi
- bota bimore dhe shtazore
- veçoritë demografike
- zhvillimi ekonomik

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:** ***(punë në grupe)***
Në pjesën përfundimtare mësimdhënësi/ja ju shpërndan 5 grupeve:
- Gr.1 hartën memece të Kinës për reliev, (shënoni format kryesore të relievit në hartë)
- Gr.2 hartën memece të hidrografisë dhe shtrirjen e vegjetacionit (shënoni lumenjtë kryesorë dhe zonat vegjetative në hartë)
- Gr.3 në fletë A4 të shënohen së paku tri zbulimet e njohura të civilizimit Kinezë
- Gr.4 në fletë A4 të shënohen së paku tri monumente kulturore-historike të Kinës
- Gr.5 në fletë A4 të shënohen së paku 5 lloje të prodhimeve industriale të Kinës

Në fund nxënësit dorëzojnë punën e tyre të mësimdhënësi/ja për vlerësim.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

| |
|---|
| Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Cakton faktorin kryesor të zhvillimit ekonomik të Kinës.<br>• Duke u bazuar në foto tregon ndotjen e ambientit dhe llojet e transportit në Kinë.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Specifikat popullatave, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Azisë; Azia Jugore, Juglindore dhe Lindore, veçoritë natyrore. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Analizon specifikat e popullatës, kulturore, fetare, ekonomike dhe politike të Azisë Lindore dhe shteteve kryesore (Kina, Japonia dhe të dy Koretë). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës** ***(të synuara)*****:**<br>I-1, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-2, 6, 8; IV-4, 8; V-1, 5, 9; VI-5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës** ***(të synuara)*****: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Japonia, Koreja Jugore dhe Veriore. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Gadishulli, ishujt Japonez, tërmetet, cunamet, erërat, rrymat detare, teknologji, pasuritë natyrore, zhvillim industrial, konfuçianizmi, komunizmi etj. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Tregon dallimet natyrore dhe demografike në mes Japonisë, Koresë Jugore dhe asaj Veriore.<br>2. Analizon karakteristikat ekonomike të këtyre tri shteteve.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Përcakton në hartë pozitën gjeografike të Japonisë dhe dy Koreve.<br>2. Vlerëson veçoritë natyrore dhe demografike të Japonisë, Koresë Jugore dhe Veriore.<br>3. Shpjegon dallimet ekonomike në mes Japonisë, Koresë Jugore me atë të Koresë Veriore. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br>Teksti 8, harta fizike dhe politike e Azisë, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, grafikoni i popullsisë, foto, skica, video etj. | | | |

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:** ***(PASAPORTA)***

Në projektor, mësimdhënësi/ja shfaq të dhënat bazike të shteteve (Japonisë, Karosë së Jugut dhe Koresë së Veriut).

| Të dhënat bazë | Japonia | Koreja e Jugut | Koreja e Veriut |
|---|---|---|---|
| Sipërfaqja e përgjithshme | 377, 915 km² | 99, 720 km² | 120, 538km² |
| Numri i popullsisë | 125 milion banorë | ........... | ................ |
| Dendësia mesatare | 344 b/km² | ........... | ................ |
| Kryeqyteti | Tokio | ........... | ............ |






Mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në 3 grupe.
Secili grup do të ketë shtetin e vet, nga një flipchart dhe markera për të shkruar. Në fillim, mësimdhënësi/ja u jep informacionet bazike " Pasaportën" e shteteve, si më lart.

**Pjesa kryesore:** ***(Truri i Galerisë)***

Në këtë pjesë, mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në 3 grupe duke ju ndarë kategori të ndryshme të njësisë mësimore. Ata udhëzohet të punojnë në mënyrë të pavarur dhe njohuritë e tyre t'i shënojnë në flipchart.
Grupi 1 – udhëzohet të punojë rreth karakteristikave natyrore dhe shoqërore ekonomike të Japonisë. t'i veçojnë pozitën e mirë gjeografike, ishujt kryesor, klimën, ujërat, karakteristikat demografike dhe zhvillimin e lartë ekonomik të këtij shteti etj.
Grupi 2 – udhëzohet të punojë rreth karakteristikave natyrore dhe shoqërore ekonomike të Koresë së Jugut. t'i veçojnë pozitën e mirë gjeografike, pjesën e gadishullit Korean ku shtrihet ky shtet, klimën, ujërat, karakteristikat demografike dhe zhvillimin e lartë ekonomik të këtij shteti etj
Grupi 3 – udhëzohet të punojë rreth karakteristikave natyrore dhe shoqërore ekonomike të Koresë së Veriut; t'i veçojnë pozitën e gjeografike, pjesën veriore të gadishullit Korean ku shtrihet ky shtet, klimën, ujërat, karakteristikat demografike dhe zhvillimin ekonomik të këtij shteti, problemet me Korenë e Jugut etj.
Pasi të përfundohet, punimet vendosen në muret e klasës.
Më shenjë të mësuesi/ja t nxënësit lëvizin rreth klasës, shikojnë punimet, diskutojnë për ato, shkruajnë komente etj.
Në fund grupet marrin punimet e veta, rishikojnë, krahasojnë me punimet e të tjerëve, lexojnë komentet e mara nga të tjerët.

**Pjesa përfundimtare: Prezantim dhe krahasim**

Në fund prezantohen të dhënat e nxjerra nga secili grup për shtetin e vet, ku më pas krahasohen veçoritë e tyre dhe vlerësohet se cili është me pozitë gjeografike, cili me reliev, klimë, hidrografi më të mirë, e cili prej tyre më i pasur, më i zhvilluar ekonomikisht, cili ka popullsi e kulturë më interesante, me të madhe, më të ngritur, kush ka turizëm më të zhvilluar etj.

| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Në hartën memece të Japonisë shënon katër ishujt kryesorë të saj.<br>• Kërkon informacione në internet për tërmetet, vullkanet në Japoni, si dhe ndarjen e gadishullit Korean.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Pozita, kufijtë dhe madhësia e Afrikës.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Përcakton kufijtë e Afrikës dhe tregon përparësitë e pozitës së saj ndaj Europës, Azisë, Amerikës dhe Australisë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 2, 5; II-1, 7, 8; III-2, 6, 7; IV-4,6; V-5; VI-3.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.<br>1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Afrika – emri, pozita, kufijtë dhe madhësia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Deti Mesdhe, Oqeani Atlantik dhe Indian, kepi Gjelbër, briri Afrikan, Aphrike, vend me diell, bota e vjetër.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Përcakton në hartë kufijtë e kontinentit të Afrikës.<br>2. Krahason pozitën gjeografike të Afrikës në raport me kontinentet tjera.<br>3. Tregon madhësinë e kontinentit dhe shtrirjen e saj.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Përkufizon saktë në hartë kufijtë e dhe pikat ekstreme të kontinentit të Afrikës.<br>2. Analizon rëndësinë e pozitës gjeografike të Afrikës me kontinentet e tjera.<br>3. Shpjegon saktë madhësinë e kontinentit të Afrikës dhe shtrirjen e saj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Afrikës, fletore pune, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:<br>Histori, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.</td></tr>
<tr><td colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Pjesa hyrëse – Hapi i parë (stuhi mendimesh)<br>Mësimdhënësi/ja paraqet disa fjalë kyçe në tabelë përmes të cilave nxënësit fillojnë të mendojnë në dyshe dhe të</td></tr>
</table>

gjejnë njësinë (kontinentin) mësimore për të cilën do të diskutohet, përmes fjalëve.
“Sahara, Atllase, Kongo, Cadi, Madagaskar, Mesdhe, Negrid”

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë *(DLTA)***

Nxënësit udhëzohen të lexojnë në paragrafë dhe pas çdo paragrafi nxënësit mbyllin librat dhe përgjigjen në pyetjet e parashtruara:

- Sa është sipërfaqja e Afrikës?
- Në cilën hemisferë shtrihet kontinenti i Afrikës?
- Trego kufirin e detet dhe oqeanet që e lagin kontinentin e Afrikës?
- Cila ngushticë e ndanë nga Europa?

Nxënësit veprojnë në këtë mënyrë deri në paragrafin e fundit.

Nxënësit gjatë përgjigjeve të pyetjeve arrijnë që të përshkruajnë kufirin e kontinentit të Afrikës, të analizojnë pozitën gjeografike, shtrirjen e kontinentit në dy hemisferat, lidhshmërinë e mirë të kontinentit të Afrikës me Europën dhe Azinë dhe përmes oqeaneve me kontinentet tjera.

Përmes njohurive të marruara për sipërfaqen e kontinentit të Afrikës, ata krahasojnë madhësinë me Europën dhe Azinë.

**Pjesa përfundimtare - Hapi i tretë**

Në pjesën përfundimtare duke u bazuar në njohurit e marruara nxënësit përmes atllasit dhe hartës bëjnë lidhjen përmes oqeaneve me kontinentet tjera, cepat -ekstreme veriore, jugore të Afrikës, pozitën e ”Njëbrirëshit”, të gjitha këto duke i identifikuar në hartën fizike të Afrikës dhe atlaset e tyre.




**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Duke u mbështetur në hartën e Afrikës, tregon cilat janë tri kalimet strategjike detare për kontinentin e Afrikës.
- Duke ju referua hartës së Afrikës dhe tregon shtrirjen e kontinentit të Afrikës, duke pasur parasysh paralelin fillestar dhe meridianin fillestar.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Pozita, kufijtë dhe madhësia e Afrikës. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Identifikon ngushticat detare, gjiret detare, ishujt dhe gadishujt dhe gjen në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, ultësirat, fushat, luginat lumore më të njohura, shkretëtirat, gjysmëshkretëtirat, stepet, savanet dhe pyjet ekuatoriale. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-1, 2, 3, 5; II-7, 8; III-2, 6, 7, 8; IV-3, 4, 6, 8; V-6 VI-5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.<br>1.3 Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Përthyeshmëria bregdetare dhe relievi i Afrikës. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Gjibraltari, kanali i Suezit, Madagaskar, gadishulli I Somalisë Atlas, Kilimangjaro, Sahara, baseni i Kongos, lugina e Nilit, rrafshnalta liqenore, Sahel. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Identifikon format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të Afrikës.<br>2. Shpjegon veçoritë kryesore të relievit të Afrikës.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Gjen në hartë ngushticat, ishujt, gadishujt, kepet kryesorë të përthyeshmërisë bregdetare të Afrikës.<br>2. Dallon format kryesore të relievit të Afrikës së lartë dhe Afrikës së ulët.<br>3. Analizon rolin e relievit në jetën dhe veprimtarinë e popullsisë së Afrikës. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Afrikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj. | | | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**<br>Histori, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media. | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(DRTA)***

Mësimdhënësi/ja e prezanton njësinë mësimore të cilën do ta zhvillojnë në këtë orë mësimore, fillimisht jep udhëzimet se si do të veprohet gjatë zhvillimit të orës mësimore.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:**

Aktivitet: Nxënësit përmes atllasit dhe udhëzimeve të mësimdhënësit/ es gjejnë format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare si: ngushticat, ishujt, gadishujt, kepet kryesorë të Afrikës.



Mësimdhënësi/ja jep sqarime rreth formave kryesore të relievit të kontinentit të Afrikës më pastaj udhëzon nxënësi të dallojnë format kryesore të relievit të kontinenti të Afrikës në atllas dhe i shpjegon ato duke i ndarë regjionin e Afrikës së lartë dhe Afrikës së ulët.

Mësimdhënësi/ja parashtron pyetje lidhur me përmbajtjen e njësisë mësimore:

- cilat dete e lagin bregdetin e kontinentit të Afrikës?
- cilat ngushtica e ndajnë nga Europa dhe Azia kontinentin e Afrikës?
- cili është ishulli më i madh i Afrikës?
- cilat pjesë të kontinentit të Afrikës i takojnë Afrikës së lartë?
- cilat pjesë të kontinentit të Afrikës i takojnë Afrikës së ulët?
- gjeni pikat më të larta të kontinenti të Afrikës, pellgun e Kongos, malet atllas, dhe shkretëtirat.

Mësimdhënësi/ja hap diskutimin rreth ndikimit të relievit në jetën dhe veprimtarin e njeriut p.sh pse shkretëtirat kanë dendësi të vogël të popullsisë? Çfarë ka ndikuar që në rrafshnaltat e Afrikës dendësia më e madhe e popullsisë të jetë mbi 1500 m lartësi?

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Mësimdhënësi/ja në tabelën e murit udhëzon nxënësit që të paraqesin një tabelar me elementet e përthyerjes dhe relievit të kontinenti të Afrikës, nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë atë duke u bazuar në përmbajtjen e njësisë mësimore.

| Oqeanet - Detet | Ngushticat | Ishujt | Malet | Rrafshnaltat | Ultësirat |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Duke ju referua numrave në hartën fizike të Afrikës, shënon oqeanet, detet, gjiret, ishujt dhe gadishujt kryesor.<br>• Gjen piken më të lartë të relievit në Afrikë.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Afrika-veçoritë natyrore.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Identifikon ngushticat detare, gjiret detare, ishujt dhe gadishujt dhe gjen në hartë sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, ultësirat, fushat, luginat lumore më të njohura, shkretëtirat, gjysmëshkretëtirat, stepet, savanet dhe pyjet ekuatoriale.<br>• Dallon tipat e klimës dhe përshkruan dallimet themelore të tyre.<br>• Analizon veçoritë hidrografike të Afrikës (Lumenjtë më të njohur, burimet e tyre dhe ujëmbledhësit, liqenet dhe prejardhjen e tyre)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1; II-6, 7; III-1, 2, 7; IV-3, 4, 6; V-3, 5, 6; VI-1.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Faktorët klimatikë, hidrografia dhe bota bimore e shtazore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Vend me diell, klimë ekuatoriale, tropike, subtropike, lumi Nil, Kongo, Viktoria, pyjet e pashkelura, savane, kaktuset, gorilla, papagajtë, xhirafa.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Analizon llojet e tipave klimatikë dhe veçoritë dalluese të tyre në kontinentin e Afrikës.<br>2. Identifikon në hartë lumenjtë, liqenet dhe ujëmbledhësit kryesorë të Afrikës.<br>3. Shpjegon rolin, rëndësinë dhe karakteristikat tjera të ujërave në kontinentin e Afrikës.<br>4. Diskuton përhapjen dhe llojllojshmërinë e botës bimore dhe shtazore në kontinentin e Afrikës.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Vlerëson karakteristikat e secilit tip klimatik në kontinentin Afrikan.<br>2. Skicon një hartë me lumenjtë, liqenet dhe ujëmbledhësit e Afrikës.<br>3. Tregon gjatësinë, madhësinë dhe rëndësinë e lumenjve dhe liqeneve të Afrikës.<br>4. Veçon zonat kryesore të botës bimore dhe shtazore si dhe llojllojshmërinë e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Afrikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: hartë hidrografike, hartë vegjetative, foto, skica, video etj.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:**

Mësimdhënësi/ja fillimisht bën ndërlidhjen me njësinë paraprake, në vazhdim së bashku me nxënësit përcaktojnë faktorët klimatik që ndikojnë në llojllojshmërinë e klimës së Afrikës. Këta faktorë shënohen në tabelë si: gjerësia gjeografike, relievi, lartësia mbidetare, afërsia dhe largësia nga detet dhe oqeanet, rrymat detare.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i dytë:**

Mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në grupe dhe secilit grup i ndahet nga një pjesë e njësisë mësimore dhe për 10 min. kohë nxënësit do ta bëjnë një përmbledhje nga ajo që u është kërkuar, grupet mbajnë shënime në fletoret e tyre dhe më pas e prezantojnë pjesën e dhënë para grupeve tjera.

Nxënësit në grupe duhet që të:

Gr.1 Veçoritë klimatike të Afrikës,

- analizojnë faktorët që ndikojnë në klimën e Afrikës
- caktojnë tipat klimatik në Afrikë
- veçojnë karakteristikat e secilës klimë

Gr.2 Veçoritë hidrografike,

- identifikoni lumenjtë dhe liqenet më të mëdha
- shpjegoni rolin dhe rendësin e tyre për zhvillimin e jetës përgjatë lumenjve
- identifikoni ujëmbledhësit e ujërave të kontinentit të Afrikës




Gr.3 Bota bimore

- përshkruani ndërtimin horizontal dhe vertikal të bimësisë në katet
- diskutoni për llojllojshmërinë e botës bimore në Kontinentin e Afrikës

Gr.4 Bota shtazore

- identifikoni llojet e botës shtazore në kontinentin e Afrikës
- analizoni për kafshët më specifike të kontinentit Afrikan, parqet nacionale, termin Safari

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Kërkohet nga nxënësit - grupet që secili grup të përzgjedh një anëtar i cili do ta plotësojë hapësirën e kërkuar në tabelë nga pjesa që ata prezantuan gjatë orës mësimore. Plotësojnë detyrat e përcaktuara në fund të njësisë mësimore

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyrë të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
| --- |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Analizon fotot e dhëna dhe poshtë tyre shënoni llojet e klimës që u përshtaten këtij vegjetacioni.<br>• Vendos në hartën e Afrikës shkronjat që korrespondojnë me lumenjtë dhe liqenet.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Veçoritë shoqëroro ekonomike të Afrikës.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Analizon veçoritë demografike dhe ekonomike të Afrikës.<br>• Identifikon shtrirjen e besimeve fetare dhe analizon mënyrën e përhapjes së besimeve në territorin e Afrikës.<br>• Analizon mënyrën e organizimit politik të shteteve të Afrikës..<br>• Dallon grupimet politike dhe ekonomike dhe problemet me të cilat ballafaqohet popullsia e Afrikës.<br>• Identifikon popujt që banojnë këtë kontinent dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.<br>• Dallon shtrirjen hapësinore të religjioneve me zonat më gravituese.<br>• Analizon lidhjen mes pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.<br>• Dallon rajonet e turistike të Afrikës dhe llojin e motive dominuese turistike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 5; II-6, 8; III-2, 6, 7; IV-4, 6; V-3, 9; VI-1, 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Karakteristikat demografike, zhvillimi ekonomik dhe ndarja politike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Negrid, të bardhë, semitë, bantuidë, berberë, nivel i ulët ekonomik, pasuritë natyrore, regjionet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Dallon veçoritë demografike të popullsisë së Afrikës.<br>2. Përshkruan niveli e jetesës së popullsisë në kontinentin Afrikan.<br>3. Klasifikon organizimet politike, grupimet politike dhe ekonomike të shteteve Afrikane.<br>4. Diskuton nivelin e ulë ekonomik në raport me pasuritë natyrore të shteteve Afrikane.<br>5. Përkufizon ndarjen regjionale të kontinentit të Afrikës.</td></tr>
</table>

**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***

1. Shpjegon numrin, racat, dendësinë besimet dhe traditën e popullsisë së Afrikës.
2. Vlerëson mënyrën e jetesës, shkaqet e vdekshmërisë e lartë së popullsisë së Afrikës.
3. Argumenton zhvillimin ekonomik, organizatat ekonomike e grupimet politike të shteteve Afrikane.
4. Definon në hartë memece regjionet e kontinentit të Afrikës.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**
Teksti Gjeografia 8, harta politike e Afrikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: harta e dendësisë së popullsisë, piramida e popullsisë, foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë** ***(shkrim i lirë)***

Mësimdhënësi/ja fillimisht kërkon nga nxënësit që të shkruajnë disa informata që kanë lidhje me popullsinë dhe ekonomin e Afrikës nga shembuj të ndryshëm, dokumentar, materiale nga jeta e përditshme etj. Për 2 deri 3 min. diskutohet me nxënës rreth temës që u parashtrua nga mësimdhënësi/ja.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë** ***(ditari dy pjesësh)***

Mësimdhënësi/ja e formon një tabalar në tabelën e murit dhe e ndan në dy pjesë ku në pjesën e parë vendos citatin (pyetjet) dhe në pjesën e dytë komenti (përgjigjen).

Nxënësit udhëzohen që të lexojnë në heshtje njësinë mësimore dhe t'i përgjigjen citateve apo pyetjeve të paraqitura në tabelë.

Nxënësit bëjnë dallimin në aspektin racor dhe fetar të popullsisë dhe e shpjegojnë atë, përshkruajnë mënyrën e jetesës dhe dallimet në aspektin racor, dallojnë disa nga grupet; fiset të Afrikës, diskutojnë pasurit e shumta natyrore dhe nivelin e ulët ekonomik, tregojnë ndarjet regjionale dhe shtetet brenda regjioneve.

| Citat | Koment | |
|---|---|---|
| Negrid | Zezakët e Sudanit dhe Bantuidët |   |
| Semit | | |
| Berberë | | |
| P. natyrore | | |
| Degët ekonomike | | |
| Regjionet | | |

Pas përfundimit të leximit dhe diskutimit nxënësit e plotësojnë tabelarin e krijuar nga mësimdhënësi/ja.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:**

Nxënësit prezantojnë punën e tyre, diskutojnë rreth prezantimeve, (vërejtje, komente, plotësim) etj. Plotësojnë detyrat dhe aktivitetet të cilat janë të paraqitura në tekst.

| **VLERËSIMI I NXËNËSVE:** |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Lidhë me shigjetë: grupet etnike të popullsisë së Afrikës sipas racave.<br>• Analizon fotot e dhëna dhe komenton ato.<br>• Në hartën e dhënë shënon pesë rajonet e kontinentit të Afrikës.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Afrika-Veçoritë natyrore.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Përkufizon regjionin e Afrikës Veriore dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion<br>• Përshkruan relievin malor (vargmalet), rrafshlartat malore, shkretëtirat dhe masivet malore midis shkretëtirës, veçoritë klimatike, hidrografike dhe të botës  bimore e shtazore të Mesdheut Afrikan.<br>• Analizon shpërndarjen hapësinore të pasurive natyrore (naftës dhe pasurive të tjera) të Afrikës Veriore.<br>• Përkufizon regjionin dhe identifikon shtetet që e përbëjnë këtë regjion si dhe analizon veçoritë kryesore natyrore (relievin, klimën, ujërat).<br>• Identifikon veçoritë e popullatës, kulturore e ekonomike të Afrikës Veriore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-2, 8; II-1, 2, 7, 8; III-1, 2, 6, 7, 8; IV-3, 8; V-1, 6; VI- 3, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
| --- |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Në hartën memece të Afrikës Jugore shënon emrat e pesë shteteve dhe kryeqyteteve të tyre.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Afrika-Veçoritë natyrore<br>-Veçoritë shoqëroro - ekonomike të Afrikës. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Bën ndërlidhjen mes kushteve klimatike, veçorive të ujit të detit dhe të tregon rolin e tyre në ekonomi e turizëm.<br>• Analizon gjendjen (strukturën) e popullsisë në të kaluarën dhe lidhjet me të tashmen në Afrikën Jugore. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës** ***(të synuara)*****:**<br>I-1, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-2, 6, 8; IV-4, 8; V-1, 5, 9; VI-5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës** ***(të synuara)*****: RNF:**<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Republika Jugafrikane. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Negrit, të bardhët, kolonizimi anglez, racizmi, strukturat e popullsisë, Nelson Mandela, pasuritë minerale, zhvillimi ekonomik. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Diskuton zhvillimet historike të racizmit gjatë kolonizimit anglez në Republikën Jugafrikane.<br>2. Dallon strukturat e popullsisë në Republikën Jugafrikane.<br>3. Identifikon pasuritë natyrore dhe nivelin e zhvillimit ekonomik në Republikën Jugafrikane.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Përshkruan periudhën e kolonizimit anglez dhe luftën për liri dhe pavarësi të Republikës Jugafrikane.<br>2. Analizon karakteristikat e popullsisë negrite dhe asaj të bardhë në Republikën Jugafrikane.<br>3. Krahason zhvillimin më të lartë ekonomik të Republikës Jugafrikane me shtetet tjera të Afrikës Jugore. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta politike e Afrikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë: (shkrim i lirë)**

Mësimdhënësi/ja fillimisht kërkon nga nxënësit që të shkruajnë disa informata që kanë lidhje me Republikën Jugafrikane nga njësitë mësimore të trajtuara më herët, njëkohësisht duke e analizuar edhe në atllaset personale të tyre për 2 deri 3 min. Më pas, lexohen komentet nxënësve të cilat i kanë shënuar dhe diskutohet rreth asaj që nxënësit paraqesin.




**Pjesa kryesore – Hapi i dytë: (ditari dy pjesësh)**

Mësimdhënësi/ja e formon një tabular në tabelën e murit dhe e ndan në dy pjesë ku në pjesën e parë vendos citatet e marruara nga libri dhe në pjesën e dytë komentet. Nxënësit evidentojnë citatet të cilat ju kanë lënë përshtypje dhe në pjesën tjetër të fletës shënojnë komentet për citatin që kanë përzgjedh. Në këtë mënyrë plotësohet ditari dypjesësh.

Komentet e shënuara prezantohen para nxënësve të tjerë dhe hapet diskutimi rreth historikut të kolonizimit anglez në R.J.A, dallimit në strukturën e popullsisë së zezë vendase dhe asaj të bardhë, identifikojnë pasurit natyrore (me të cilat zë vendin të rëndësishëm në botë) dhe krahasojnë zhvillimin ekonomik të R.J.A me shtetet tjera të Afrikës Jugore.

| Citati | Komenti |
|---|---|
| | |

**Pjesa e përfundimtare – Hapi i tretë:**

Duke u bazuar te ditari dypjesësh që nxënësit kanë punuar, krejt në fund plotësohet edhe një tabelë e koncepteve kryesore për këtë njësi mësimore

| Pozita gjeografike | Relievi | Klima | ujërat | popullsia | Pasurit natyrore | ekonomia |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve,

portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Kërkoni në internet, dhe përshkruan jetën dhe veprimtarinë e Nelson Mandeles.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Regjionet amerikane - Pozita gjeografike.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Analizon pozitën gjeografike, shtrirjen, madhësinë dhe identifikon gadishujt, ishujt, gjiret, ngushticat dhe kanalet kryesore të Amerikës si dhe vlerëson rëndësinë e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 2, 5 II-1, 7, 8 III-2, 6, 7 IV-4, 6 V-5 VI-3.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.<br>1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Kontinenti i Amerikës – veçoritë e përgjithshme gjeografike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Bota e Re, oqeanet, ekuatori, pozita gjeografike, përthyeshmëria bregdetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Përcakton kufijtë, madhësinë dhe pozitën gjeografike të kontinentit të Amerikës.<br>2. Dallon format bregdetare të kontinentit të Amerikës në Oqeanin e Ngrirë të Veriut, Atlantik dhe Paqësor.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Identifikon në hartë kufijtë dhe pozitën gjeografike të kontinentit të Amerikës ndaj kontinenteve tjera.<br>2. Skicon një hartë me gadishujt, ishujt, gjiret dhe ngushticat kryesore të përthyeshmërisë bregdetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Botës dhe Amerikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:<br>Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.</td></tr>
</table>

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

**Pjesa hyrëse:**

Mësimdhënësi/ja zhvillon një bashkëbisedim me gjithë klasën. Kërkon që nxënësit të bëjnë analizë të. Për kontinentin e ri që do të trajtohet në vazhdim, të japin ndonjë ide apo mendim se çfarë njohurish kanë për Amerikën. Pas diskutimeve në kuadër të grupeve, idetë e tyre prezantohen, ndërsa mësuesi/ja /ja shënon në tabelë konceptet më interesante që ndërlidhen me njësinë që do të shtjellohet. Përgjigjet, idetë dhe mendimet e nxënësve ndihmojnë në thellimin e të menduarit lidhur me njohuritë të cilat do të shtjellohen.

**Pjesa kryesore:** ***(realizmi i kuptimit)***

Mësimdhënësi/ja ndan nxënësit në grupe. Ai/ajo paraqet njësinë e re mësimore dhe njofton nxënësit me rezultatet e të nxënit që duhet arrihen gjatë orës mësimore. Më pas, shënon në tabelë (ose i prezanton me projektor) kërkesa që nxënësit duhet të përgjigjen. Mësimdhënësi/ja kërkon që nxënësit të lexojnë me kujdes njësinë mësimore "Kontinenti i Amerikës – veçoritë e përgjithshme gjeografike " dhe të shënojnë informacionet e fituara për secilën nga kërkesat.

Nxënësit do t'i shkëmbejnë informacionet e shënuara në mes veti me një partner në kuadër të grupit.

Partneri i parë komenton gjashtë kërkesat e para, ndërsa partneri i dytë gjashtë kërkesat e dyta. Në fund, informacionet diskutohen brenda grupit.

**Përshkruaj:**

- Përcakto pozitën gjeografike të kontinentit të Amerikës?
- Përshkruaj kufijtë e kontinentit të Amerikës?

**Krahaso**:

- Krahaso sipërfaqen e kontinentit të Amerikës me atë të Europës dhe Azisë?
- Në bazë të veçorive gjeografike krahaso tri regjionet e Amerikës?

**Shoqëro:**

- Skico në hartë ishujt dhe gadishujt e Amerikës.
- Skico në hartë gjiret dhe ngushticat e Amerikës.

**Analizo:**

- Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e pozitës gjeografike të Amerikës?
- Cili nga bregdetet e oqeaneve që e rrethojnë Amerikën ka përthyeshmëri më të madhe e cili rendësi me të madhe?

**Argumento:**

- Dallimet e pozitës gjeografike të Amerikës Veriore me atë të Amerikës Jugore.

**Pjesa përfundimtare:** ***(reflektimi)***

Pas përfundimit të leximit dhe diskutimit në çifte dhe në grupe, nxënësit paraqesin punimet e tyre. Në rast se ka mbetur ndonjë informacion i paqartë, atëherë mësimdhënësi/ja ndërhyn për të bërë sqarimet e nevojshme. Njëkohësisht mund të jepen edhe informacione të reja, varësisht prej rrethanave që paraqiten. Në fund nxënësit do të punojnë në tabelën e koncepteve dhe do të shkruajnë nga një fjali në secilën kolonë për të ofruar argumentet e duhura.

## VLERËSIMI I NXËNËSVE:

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit

komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Në hartën memece të botës bën përkufizimin e kontinentit të Amerikës.
- Në hartën memece të kontinentit të Amerikës, përmes ngjyrave identifikon tri regjionet kryesore.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Veçoritë natyrore të regjioneve amerikane.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Dallon elementet kryesore natyrore (malet, vargmalet, fushat, pllajat dhe luginat lumore më të njohura, etj).<br>• Analizon veçoritë e klimës dhe vlerëson ndikimin e klimës në ndërlidhje me tipat vegjetativë.<br>• Identifikon nëpërmes hartës gjeografike lumenjtë dhe liqenet e njohura, detet dhe oqeanet, ujët e të cilave i lagin brigjet e Amerikës.<br>• Identifikon sistemet malore (vargmalet), malet e vjetra, rrafshnalta e madhe, pllaja e prerive, fushat dhe luginat lumore më të njohura</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 2, 3, 5; II-7, 8; III-2, 6, 7, 8; IV-3, 4, 6, 8; V-6; VI-5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Veçoritë natyrore të kontinentit të Amerikës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Kordileret, ultësirat, Patagonia, Misisipi, Amazoni, brezat klimatik, liqenet e Mëdha, selvaset, kamposet, preritë, pampaset.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Identifikon format kryesore të relievit në kontinentin e Amerikës.<br>2. Numëron faktorët klimatik dhe tipat klimatik në kontinentin e Amerikës.<br>3. Dallon lumenjtë, liqenet dhe pellgjet detare të kontinentit të Amerikës.<br>4. Shpjegon shtrirjen hapësinore vegjetative në kontinentin e Amerikës.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Gjen në hartë, malet, rrafshnaltat, ultësirat dhe luginat lumore kryesore të kontinentit të Amerikës.<br>2. Vlerëson ndikimin e faktorëve klimatik në llojet e tipave klimatik në kontinentin e Amerikës.<br>3. Shënon emrat e lumenjve, liqeneve kryesorë dhe pellgjeve detare në hartën memece të Amerikës.<br>4. Klasifikon shtrirjen pyjeve ekuatoriale, savaneve dhe stapeve sipas gjerësisë gjeografike në kontinentin e Amerikës.</td></tr>
</table>

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**
Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Botës dhe Amerikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: harta memece e ujerave të Amerikës foto, skica, video etj

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**
Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse: Hapi i parë:**
Mësimdhënësi/ja zhvillon një aktivitet me gjithë klasën. Kërkon që nxënësit të bazohen në termat e shënuar në etiketa. Më pas, udhëzohen t'u japin kuptim mesazheve, të ideojnë përmbajtje të kuptueshme. Nxënësit i japin idetë e tyre për mesazhet, i diskutojnë në dyshe e grupe dhe i prezantojnë para grupeve të tjera.

relievi
- malet, ultësirat
- rrafshnaltat, luginat lumore

klima
- faktorët klimatik
- ekuatoriale, tropike, kontinetale etj.

hidro-grafia
- lumenjët
- liqenet
- pellgjet detare

**Pjesa kryesore:** ***(realizmi i kuptimit)***
Mësimdhënësi/ja i njofton nxënësit me formën e punës. Më pas, shënon në tabelë 4 kërkesa të përgatitura së bashku me nxënësit, të cilat do t'u shërbejnë grupeve, përkatësisht secilit grup nga një prej tyre, në gjetjen e informacioneve të përcaktuara lidhur me temën:

- Shpjegoni format kryesore të relievit të kontinentit të Amerikës dhe gjeni në atlaset tuaja.
- Përshkruani faktorët klimatik dhe tipat klimatik në kontinentin e Amerikës.
- Gjeni në atlaset tuaja lumenjtë, liqenet kryesore dhe tregoni pellgjet detare ku derdhen.
- Vlerësoni rëndësinë e klimës në përcaktimin e zonave të botës bimore dhe shtazore.



Gjatë marrjes së informacioneve, nxënësit do të ndihmohen me prezantime me projektor. Prezantimet nga mësimdhënësi/ja u ndihmon atyre të analizojnë fotografi dhe skicime të ndryshme për zgjerimin e njohurive lidhur me kërkesat kryesore veçoritë natyrore të kontinentit të Amerikës. Të dhënat e mësipërme mësimdhënësi/ja i paraqet vizualisht ose i shënon në tabelë, ndërsa në fund përfaqësuesit e grupeve bëjnë prezantimet.

**Pjesa përfundimtare:**
Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të punojnë në fletore pune dhe të plotësojnë hartën fizike të kontinentit të Amerikës me emrat e maleve, ultësirave, rrafshnaltave, lumenjve, liqeneve detrave dhe oqeaneve.

| VLERËSIMI I NXËNËSVE: |
|---|
| Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Duke u bazuar në hartën fizike të dhënë për kontinentin e Amerikës shënon emrat e maleve, rrafshnaltave dhe ultësirave sipas numrave.<br>• Duke dhënë disa karakteristika natyrore identifikon Ultësirat Qendrore.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Analizon shkaqet që nxitën zbulimin e Amerikës dhe popullimin e saj.<br>• Dallon popujt dhe grupet e shumta që ndryshojnë nga raca, gjuha, kultura dhe prejardhja e tyre në Amerikë.<br>• Komenton grafikonin e rritjes së popullsisë dhe hartën e dendësisë së popullsisë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 5; II-6, 8; III-2, 6, 7; IV-4, 6; V-3, 9; VI-1, 2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Kolonizimi i Amerikës, popullsia dhe zhvillimi ekonomik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Amerikoindianët, europianët, negritët, melezet, strukturat e popullsisë, resurset natyrore, degët ekonomike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Shpjegon historikun e zbulimit të kontinentit të Amerikës nga europianët.<br>2. Analizon llojet e grupeve etnike, prejardhjes dhe strukturat e popullsisë në kontinentin e Amerikës.<br>3. Identifikon pasuritë natyrore dhe dallimin e zhvillimit ekonomik në mes Amerikës Veriore dhe asaj Jugore.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Ilustron me shembuj mënyrën e zbulimit të kontinentit të Amerikës nga Kristofor Kolombo dhe të tjerët.<br>2. Përshkruan llojet e grupeve etnike, racore, gjuhësore, prejardhjes dhe kulturës në kontinentin e Amerikës.<br>3. Analizon faktorët që kanë ndikuar në dallimet e zhvillimit ekonomik në mes Amerikës Veriore dhe Jugore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Botës dhe Amerikës, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: harta memece e ujerave të Amerikës foto, skica, video etj.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:**

Mësimdhënësi/ja zhvillon një bashkëbisedim me gjithë klasën. Kërkon që nxënësit të analizojnë termat dhe fotot e paraqitura me projektor ose të printuara në fletë A4 për Zbulimin e Amerikës dhe për të ndërtuar nga një përmbajtje të shkurtër lidhur me të. Pas diskutimeve në kuadër të grupeve, idetë e tyre prezantohen, ndërsa mësuesi/ja /ja shënon në tabelë konceptet më interesante që ndërlidhen me njësinë që do të shtjellohet. Idetë, mendimet dhe sqarimet fillestare do të ndihmojnë në thellimin e të menduarit lidhur me Zbulimin e Amerikës.








**Pjesa kryesore:** ***(realizim kuptimi)***

Mësimdhënësi/ja fton nxënësit t'i hapin librat dhe të lexojnë njësinë mësimore "**Kolonizimi i Amerikës, popullsia dhe zhvillimi ekonomik**". Do të kërkohet nga ta që fleta e fletores të ndahet në dy shtylla, me një vijë vertikale në mes; në shtyllën e majtë të shkruajnë pjesë apo një imazh që u pëlqen më shumë, ndërsa në të djathtën të komentojnë po atë pjesë apo imazh që u ka pëlqyer më shumë. Nxënësit udhëzohen që ta lexojnë tekstin të tërë dhe të ndalojnë katër pesë herë gjatë leximit, për të mbajtur shënime. Gjithsesi, në fund do të duhej t'i kthehen edhe një herë mësimit si të tërë për të mbajtur shënime tjera. Gjatë kësaj periudhe kohore do të vizitohen grupet dhe do të ndihmohen nëse ata kërkojnë ndihmën e mësimdhënësit/es. Kur nxënësit e kanë përfunduar punën fillojnë komentimet. Disa nga pyetjet më të përshtatshme gjatë komentimeve të citateve mund të jenë:

- Pse e përzgjodhët këtë paragraf?
- Cili ju nxiti më tepër, ky apo ai paragraf?
- Cilat ishin shkaqet të cilat quan në zbulimin e Amerikës nga Kristofor Kolombo?
- Pse kemi përzierje aq të madhe të racave, grupeve etnike, gjuhëve feve, traditave etj., të popullsisë së Amerikës?
- Analizoni shkaqet e dallimeve ekonomike në mes Amerikës Veriore dhe Jugore

Së fundi edhe mësimdhënësi/ja mund të bëjë një ose dy komente lidhur me njësinë mësimore, të cilat do të ishin në funksion të nxitjes së nxënësve për mësim analitik.

Pas përfundimit të leximit dhe diskutimit në çifte dhe në grupe, nxënësit paraqesin punimet e tyre. Në rast se ka mbetur ndonjë informacion i paqartë, atëherë mësimdhënësi/ja ndërhyn për të bërë sqarimet e nevojshme. Njëkohësisht mund të jepen edhe informacione të reja, varësisht prej rrethanave dhe interesimit të nxënësve.

**Pjesa përfundimtare:**

Në pjesën përfundimtare mësimdhënësi/ja shfaq një dokumentar të shkurtër (3-4 min) për zbulimet e kontinentit të Amerikës dhe orienton nxënësit të shkruajnë një ese për zbulimet e mëdha gjeografike, përzierjen e madhe të strukturave të popullsisë dhe dallimeve ekonomike në këtë kontinent.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Duke u bazuar në hartën fizike të dhënë për kontinentin e Amerikës shënon emrat e maleve, rrafshnaltave dhe ultësirave sipas numrave.
- Tregon përzierjen e popullsisë Mëstike, Mulate dhe Zamboze.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Veçoritë natyrore të regjioneve amerikane. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Vlerëson pozitën gjeografike, përthyerjen e vijës bregdetare dhe daljen në Oqeane të regjionit të Amerikës Veriore.<br>• Analizon dhe i komenton klimogramet dhe zonat bimore e shtazore për vendet e Amerikës Veriore dhe arsyeton ndryshimet e theksuara midis rajoneve, roli i rrymave oqeanike në brigjet juglindore dhe jugperëndimorë të regjionit.<br>• Identifikon lumenjtë kryesorë, praninë e madhe të liqeneve natyrore, ujëvarave, kanionëve dhe arsyeton rolin e tyre në zhvillimin ekonomik të Amerikës Veriore. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-2, 8; II- 1, 2, 7, 8; III-1, 2, 6, 7, 8; IV-3, 8; V-1, 6; VI- 3, 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Amerika Veriore – pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Hemisfera veriore, oqeanet, gjiri i Meksikës, malet Shkëmbore, Ultësirat e Mëdha Qendrore, Golfstrimi, tornado, Misisipi, liqenet e Mëdha, zonat vegjetative. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Vlerëson pozitën e mirë gjeografike të Amerikës Veriore.<br>2. Dallon format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare në Amerikën Veriore.<br>3. Identifikon veçoritë kryesore të relievit në Amerikën Veriore.<br>4. Analizon kontrastet klimatike, hidrografike dhe përhapjen e botës bimore dhe shtazore në Amerikën Veriore.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Tregon së paku tre nga faktorët e pozitës së mirë gjeografike të Amerikës Veriore.<br>2. Gjen në hartë gadishujt, ishujt, gjiret dhe ngushticat kryesore të Oqeanit të ngrirë të Veriut, Atlantik dhe Paqësor në Amerikën Veriore.<br>3. Shpjegon karakteristikat e maleve, ultësirave dhe luginave lumore në Amerikën Veriore.<br>4. Analizon faktorët klimatik dhe tipat klimatik, lumenjtë, liqenet dhe zonat vegjetative në Amerikën Veriore. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Amerikës Veriore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:** ***(Parashikim me hartë)***

Në fazën e parë të orës nxënësve u kërkohet që të shikojnë për pak minuta në atlaset e tyre, te

Rajoni i Amerikës Veriore dhe të tregojnë ato që mund të konkludojnë për këtë regjion, duke u bazuar edhe në mësimin paraprake për kontinentin e Amerikës. Mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit për atë se çka ata duhet të analizojnë me disa komente.:

- Amerika Veriore gjendet në hemisferën veriore.
- Rrethohet nga tri oqeanet: Atlantik, Paqësor dhe Oqeani i Ngrirë i Veriut.
- Përthyeshmëria bregdetare është e madhe posaçërisht në veri.
- Relievi i Amerikës veriore përbëhet nga tri tersi gjeografike.
- Faktorët klimatik kanë ndikuar në tipa të ndryshëm klimatikë.
- Lumenjtë derdhen në tri pellgje detare.
- Bota bimore dhe shtazore është mjaftë e llojllojshme.

**Pjesa kryesore:** ***(Grupet e ekspertëve)***

Mësuesi/ja /ja i ndan grupet me nga 4 nxënës dhe u ndan pjesët, për të cilat nxënësit do ta përgatisin

nga një prezantim të vogël si ekspert të atyre pjesëve.

GR.1 Pozita gjeografike

GR. 2 Përthyeshmëria bregdetare

GR. 3 Relievi

GR. 4 Klima

GR. 5 Ujërat

GR. 6 Bota bimore e shtazore

Pas 7-8 minutash grupet eksperte prezantojnë para të tjerëve pjesën e tyre dhe duhet të jenë të

gatshëm për pyetjet që mund t`u bëjnë nxënësit. Kështu fillon grupi i parë deri tek i fundit.

**Pjesa përfundimtare:** ***(punë praktike në grupe)***

Mësimdhënësi/ja shpërndan grupeve harta memece të relievit, hidrografisë, tipave klimatikë dhe zonave vegjetative, të përgatitura më parë dhe kërkon nga ta të plotësohen me veçoritë e secilës kategori që ata janë të përcaktuar.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit

komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| --- |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Duke u bazuar në hartën fizike të dhënë për kontinentin e Amerikës shënon emrat e maleve, rrafshnaltave dhe ultësirave sipas numrave.<br>• Tregon përzierjen e popullsisë Mëstike, Mulate dhe Zamboze.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Dallon popujt dhe grupet e shumta që ndryshojnë nga raca, gjuha, kultura dhe prejardhja e tyre në Amerikë Veriore.<br>• Komenton grafikonin e rritjes së popullsisë dhe hartën e dendësisë së popullsisë.<br>• Paraqet me shenja hartografike në hartën e punës vendburimet më të njohura të naftës, gazit, nikelit, arit, uraniumit, plumbit, hekurit, qymyrit si dhe qendrat kryesore të industrisë.<br>• Analizon rëndësinë e rajoneve bujqësore dhe varësinë e tyre nga zonat klimatike dhe relievore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-3, 5, 8; II- 2, 6, 7, 8; III- 2, 7; IV- 6; V- 3, 6; VI-2.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Amerika Veriore – Veçoritë shoqërore dhe ekonomike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Amerikoindianët, eskimezët, ardhacakët, ferma, resurset natyrore, megapoliset, zhvillim i lartë ekonomik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Analizon karakteristikat demografike të popullsisë së Amerikës Veriore.<br>2. Klasifikon resurset e mëdha natyrore të Amerikës Veriore.<br>3. Shpjegon zhvillimin e degëve të ndryshme ekonomike në Amerikën Veriore.<br>4. Evidenton qendrat e njohura industriale në Amerikën Veriore.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Diskuton për popullsinë autoktone dhe ardhacakë si dhe strukturat e popullsisë racore, gjuhësore, fetare dhe kulturore të Amerikës Veriore.</td></tr>
</table>

2. Radhitë pasuritë e mineraleve, tokave, pyjeve, ujërave dhe pasurive tjera natyrore në Amerikën Veriore.
3. Analizon ndikimin e faktorëve natyror në zhvillimin e lartë të degëve ekonomike në Amerikën Veriore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës Veriore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:** ***(Ndërlidhja e njohurive më njësitë paraprake)***

Mësimdhënësi/ja hap diskutimin më nxënës rreth njohurive për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të cilat janë trajtuar në përgjithësi të kontinenti i Amerikës, duke rikujtuar:

- racat e popullsisë dhe grupet etnike;
- gjuhët dhe fetë kryesore;
- pasuritë natyrore;
- shtetet më të zhvilluara ekonomikisht etj.

Në këtë mënyrë bëhet ndërlidhja më njësinë mësimore e cila do të trajtohet në vazhdim.

**Pjesa kryesore:** ***(Shqyrtim kategorizues)***

Në fletë A4, mësimdhënësi/ja jep një tabelë të përgatitur me herët, ku do të bëhet shqyrtimi kategorik, si më poshtë:

| Përzierja racore e popullsisë | Grupet etnike, fetë kryesore dhe gjuhët | Pasuritë natyrore të Amerikës Veriore | Degët kryesore ekonomike dhe prodhimet e ndryshme | Qendrat kryesore industriale |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

Mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit që plotësimi i njohurive të bëhet përmes leximit të njësisë mësimore dhe të plotësohet tabela.

**Pjesa përfundimtare:** ***(prezantim dhe reflektim)***

Nxënësit prezantojnë punën e tyre, japin komente, parashtrojnë pyetje dhe diskutojnë. Në fund të plotësohen detyrat dhe aktivitetet që kërkohen në tekst në mënyrë që të bëhet reflektim i njësisë mësimore.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
| --- |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Poshtë fotove vendos emrat e grupacioneve etnike të popullsisë në Amerikën Veriore.<br>• Duke u bazuar në hartën e dendësisë së popullsisë së Amerikës Veriore, tregon cilat hapësira janë më të dendura?<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Dallon popujt më të njohur që e përbëjnë popullsinë e SHBA-së dhe të Kanadasë sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.<br>• Krahason shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, popullatës, nivelit të arsimit, urbanizimit, strukturës ekonomike dhe bën dallimin e organizimit politiko-administrativ mes SHBA-së dhe Kanadasë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 3, 5, 8; II- 6, 7, 8; III- 6, 8; IV- 4, 6; V- 5, 9; VI- 1, 6.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: SHBA-ja, veçoritë natyrore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Alaska, Havajet, Gjiri i Meksikës, malet Shkëmbore, ultësira e Misisipit, Niagara, preritë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Përcakton pozitën gjeografike, kufijtë dhe madhësinë e SHBA-së.<br>2. Analizon veçoritë natyrore të SHBA-së.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Tregon në hartë pozitën gjeografike, kufijtë dhe madhësinë e SHBA-së.<br>2. Diskuton rreth karakteristikave të relievit, klimës, ujërave dhe botës së gjalle në SHBA.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Amerikës Veriore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:<br>Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.</td></tr>
</table>

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:** ***(Shkrim i lirë)***

Në fillim, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të shkruajnë disa karakteristika natyrore rreth gjërave që mendojnë se i njohin për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më pas, lexohen disa prej tyre dhe diskutohen se cilat qëndrojnë dhe cilat jo. Ato më të saktat shënohen në tabelë

**Pjesa kryesore:** ***(DLTA)***

Kjo njësi mësimore do të trajtohet duke e lexuar tekstin me zë, pjesë-pjesë, të cilat mësuesja i përcakton paraprakisht. Pas çdo paragrafi mësimdhënësi/ja ndërprenë nxënësit dhe hap diskutimin me anë të pyetjeve për atë se çfarë u lexua, p.sh:

Pyetjet e pjesës së parë:

1. Cilin vend e zënë SHBA-ja sipas sipërfaqes?
2. Tregoni në hartë përkufizimin e saj.
3. Çfarë e bën të përshtatshme pozitën gjeografike të SHBA-së?
4. Cilat ishin format kryesore të relievit? Etj.

Kështu vazhdohet pas çdo paragrafi që lexohet, deri sa të trajtohet e tërë njësia mësimore.

**Pjesa përfundimtare:**

Në pjesën përfundimtare nxënësit reflektojnë duke diskutuar dhe duke praktikuar në hartë gjetjen e formave kryesore të relievit të SHBA-së, lumenjtë dhe liqenet kryesore, analizojnë faktorët klimatik etj. Në fund të plotësohen detyrat dhe aktivitetet që kërkohen në tekst në mënyrë që të bëhet reflektim i njësisë mësimore.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Kërkon në internet dhe shënon disa karakteristika për ujëvarën e Niagarës.
- Kërkon në internet dhe shënon disa karakteristika për bizonët.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës**:<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekono-mike. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Dallon popujt më të njohur që e përbëjnë popullsinë e SHBA-së dhe të Kanadasë sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.<br>• Krahason shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, të popullatës, nivelit të arsimit, urbanizimit, strukturës ekonomike dhe bën dallimin e organizimit politiko-administrativ mes SHBA-së dhe Kanadasë. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës** ***(të synuara)*****:**<br>I-3, 5, 8; II-2, 6, 7, 8; III-2, 7; IV-6; V-3, 6; VI-2. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës** ***(të synuara)*****: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** SHBA-ja popullsia dhe specifikat ekonomike. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Kombi amerikan, shtet federal, organizimi administrativo-politik, resurset natyrore dhe ekono-mike, degët ekonomike. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Shpjegon mënyrën e krijimit të kombit dhe shtetit amerikan.<br>2. Analizon rregullimin administrativo politik të SHBA-së.<br>3. Argumenton zhvillimin e shpejtë ekonomik pas luftës së dytë botërore të SHBA-së.<br>4. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet në mes SHBA-së dhe Kanadasë në aspektin e zhvillimit ekonomik.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Diskuton historikun e krijimit të shtetit Amerikan dhe rregullimin e pushteteve në SHBA.<br>2. Numëron faktorët historik, natyror dhe shoqëror në zhvillimin e lartë ekonomik të SHBA-së.<br>3. Specifikon karakteristikat e degëve ekonomike të SHBA-së. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës Veriore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse:** ***(prezantim dhe diskutim)***

Fillimisht mësimdhënësi/ja shfaq në Power Point një material të përgatitur nga ai (5-7 min.), më të dhëna, foto, skica dhe video për mënyrën e krijimit të kombit Amerikan, rregullimit shtetëror, e posaçërisht për karakteristikat zhvillimit të lartë ekonomik.

**Pjesa kryesore:** ***(realizmi i kuptimit)***

Në këtë faze të orës, nxënësit ndahen në grupe, duke formuar grupet familjare. Çdo nxënës numëron 1-4.

Mësimdhënësi/ja ndan klasën, duke i ulur së bashku (në një grup) nxënësit me nr. 1, sikundër edhe ata me nr. 2, 3 dhe 4. Kështu mësimdhënësi/ja krijon (formon) grupet e ekspertëve. Pas formimit të grupeve të ekspertëve, mësimdhënësi/ja i fton nxënësit t'i hapin tekstin dhe ta analizojnë njësinë mësimore SHBA-ja popullsia dhe specifikat ekonomike dhe u tregon rezultatet që duhen të realizohen në fund të orës mësimore. Shpërndahen edhe fletët e ekspertëve, në të cilat gjenden pyetjet. Nxënësi merr edhe fletën e ekspertëve po me atë numër që ka. Pra nxënësve me nr.1 u jepen fletët e ekspertëve me nr. 1, e kështu me radhë. Detyra e të gjitha grupeve është që ta lexojnë në mënyrë individuale. Njësia duhet lexuar në atë mënyrë që secili nxënës të gjejë përgjigjet në pyetjet e fletës së ekspertit të cilat i ka dhënë mësimdhënësi. Përgjigjet e gjetura diskutohen brenda grupit të ekspertëve. Secili ekspert mban përgjegjësi për pyetjet nga fleta e ekspertit. Kur të përfundojë koha e caktuar, “ekspertët kthehen në grupet familjare dhe secili prej tyre raporton për pjesën e vetë, duke mirëpritur pyetjet e të tjerëve dhe duke dhënë edhe ai mendimet e tij.

Pyetjet për grupet e ekspertëve:

**Fleta e ekspertit nr. 1**

- Si është krijuar kombi Amerikan?
- Cilët faktorë kanë ndikuar në asimilimin e grupeve etnike tjera në SHBA?
- Cilat raca të popullsisë dallojmë, cila është gjuha zyrtare qe flitet dhe si është shpërndarja e popullsisë?

**Fleta e ekspertit nr. 2**

- Si është i rregulluar sistemi shtetëror dhe ai administrativ i SHBA-së?
- Cilat janë tri pushtetet (ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor) në SHBA?

**Fleta e eksperti nr. 3**

- Cilët faktorë kanë ndikuar në zhvillimin e shpejtë ekonomik të SHBA-së pas luftës së dytë botërore?
- Cilat janë pasuritë natyrore që ndihmojnë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të SHBA-së?
- Tregoni degët kryesore ekonomike të SHBA-së.

**Fleta e ekspertit nr. 4**

- Me cilat prodhime bujqësore është e njohur SHBA-ja?
- Me cilat prodhime industriale është e njohur SHBA-ja?
- Analizoni niveli e zhvillimit të komunikacionit në SHBA?

Në përfundim, nxënësit ballafaqohen dhe krahasojnë idetë dhe vlerësimet e tyre për çështjet kryesore. Prezantojnë punën e grupeve dhe diskutohet rreth tyre.

**Pjesa përfundimtare:**

Në fund bëhet reflektim I gjithë asaj për të cilën u diskutua. Kërkohet nga nxënësit që të hulumtojnë në internet rreth karakteristikave të SHBA-së dhe të përgatisin një prezantim.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Analizon flamurin e SHBA-së dhe tregon pse gjinden 50 yje në të?

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Dallon popujt më të njohur që e përbëjnë popullsinë e SHBA-së dhe të Kanadasë sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.<br>• Krahason shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, të popullatës, nivelit të arsimit, urbanizimit, strukturës ekonomike dhe bën dallimin e organizimit politiko-administrativ mes SHBA-së dhe Kanadasë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Kanadaja – veçoritë natyrore, popullsia dhe zhvillimi ekonomik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Resurse të mëdha natyrore, shtet federal, sipërfaqe të madhe, racat, zhvillim i lartë ekonomik.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Përshkruan pozitën gjeografike dhe veçoritë natyrore të Kanadasë.<br>2. Analizon veçoritë demografike dhe numrin e vogël të popullsisë në raport me sipërfaqen e Kanadasë.<br>3. Arsyeton zhvillimin e degëve ekonomike në raport me resurset natyrore të Kanadasë.<br>4. Krahason ngjashmëritë dhe dallimet në mes SHBA-së dhe Kanadasë në aspektin e zhvillimit ekonomik.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Përcakton në hartë kufijtë, madhësinë dhe pozitën gjeografike të Kanadasë.<br>2. Analizon numrin e popullsisë, grupet etnike, racat, gjuhët dhe dendësinë e popullsisë në Kanada.<br>3. Shpreh rolin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik të Kanadasë.<br>4. Specifikon karakteristikat e degëve ekonomike të Kanadasë.</td></tr>
</table>

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës Veriore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i pare**

Fillimisht mësimdhënësi/ja jep sqarime të shkurtra rreth pozitës gjeografike të Kanadasë, veçorive natyrore dhe karakteristikave shoqërore-ekonomike të këtij shteti.

**Pjesa zhvillimore – Hapi i parë (I N S E R T)**

Mësimdhënësi/ja fillimisht udhëzon nxënësit që të lexojnë tekstin dhe gjatë leximit ata vendosin shenjat:

,, √ “ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur.

,, - “ vendoset në fund të informacionit i cili është ndryshe me atë që e dini ju.

,, + “ informacioni që për ju është i ri (keni mësuar diç të re.

,,? “ informacion që është i pa qartë (ose doni të dini më shumë).

| ,, √ “ | ,, - “ | ,, + “ | ,,? “ |
|---|---|---|---|
| - | | | |
| - | | | |

Nxënësit i shënojnë karakteristikat të cilat i kanë identifikuar gjatë leximit, varësisht prej shenjave të rubrikës përkatëse. Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që t'i prezantojnë të gjeturat e tyre duke i renditur karakteristikat e veçorive natyrore dhe shoqërore të Kanadasë. Në bazë të kësaj vihet në përfundim gjetja e përparësive dhe mangësive të pozitës gjeografike, formave të relievit, veçorive klimatike, rrjetit hidrografik, kateve të bimësisë. Po ashtu duke u bazuar në këto të dhëna hap diskutimin rreth karakteristikave të popullsisë dhe zhvillimit ekonomik.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë**

Në përfundim, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit që të plotësohet tabela e koncepteve.

| Pozita gjeografike | Relievi | Klima | Ujërat | Popullsia | Ekonomia |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me

| |
|---|
| komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Në hartën e dhënë të Kanadasë shënon krahinën ku gjuhë zyrtare është frëngjishtja.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Veçoritë natyrore të regjioneve amerikane.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Përcakton shtrirjen hapësinore të Amerikës së Mesme dhe dallon përparësitë e pozitës së saj, regjion në mes Amerikës Veriore dhe Amerikës Jugore.<br>• Identifikon në hartë gadishujt, ishujt dhe detet që i lagin brigjet e Amerikës së Mesme.<br>• Dallon dhe të arsyeton shtrirjen e zonave klimatike-vegjetative mes pjesëve veriore dhe jugore, viseve të larta dhe të ulëta të Amerikës së Mesme.<br>• Analizon përthyeshmërinë e madhe bregdetare si dhe vlerëson rëndësinë e Kanalit të Panamasë dhe përshkruan rëndësinë e tij ekonomike.<br>• Analizon veçoritë klimatike dhe hidrografike të Amerikës së Mesme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Amerika e Mesme (Qendrore) – pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Urë lidhëse, gjiri i Meksikës, kanali i Panamasë, gadishulli Jukatan, Antilet e Mëdha, rrafshnalta e Meksikës, tropikale, savanet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Vlerëson rolin e pozitës gjeografike të Amerikës së Mesme, si urë lidhëse në mes Amerikës Veriore dhe asaj Jugore.<br>2. Identifikon format kryesore të përthyeshmërisë bregdetare të Amerikës së Mesme.<br>3. Përshkruan tiparet kryesore të relievit, klimës, hidrografisë dhe botës së gjallë në Amerikën e Mesme.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Përcakton kufijtë, madhësinë dhe rolin e pozitës gjeografike të Amerikës së Mesme.</td></tr>
</table>

2. Gjen në hartë gadishujt, ishujt, gjiret, kanalin e Panamasë, detet dhe oqeanet që e rrethojnë Amerikën e Mesme.
3. Shpjegon karakteristikat kryesore të relievit të Amerikës së Mesme.
4. Analizon faktorët klimatik, veçoritë hidrografike dhe vegjetative të Amerikës së Mesme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës së Mesme, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse, kryesore dhe përfundimtare – *(Di, Dua të, Mësoj)***

Në fillim mësimdhënësi/ja paraqet në dërrasë të zezë një tabelë e ndarë në tri pjesë:

- Nxënësit orientohen për njësinë mësimore e cila do të trajtohet.
- Në fazën e pare, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit t'i rikujtojnë njohuritë e më hershme për kontinentin e Amerikës me theks të veçantë ato për Amerikën e Mesme duke i orientuar me anë të pyetjeve.
- Cilat ishin tri rajonet e kontinentit të Amerikës?
- Çfarë mendoni për pozitën gjeografike të këtij rajoni?
- A mund të dalloni disa nga format e përthyeshmërisë bregdetare?
- A ju kujtohet ndonjë grup etnik i popullsisë në Amerikën e Mesme? Etj.
- Nga përgjigjet e nxënësve plotësohet pjesa "DI".
- Pjesa "DUA TË DI" plotësohet pasi në i kemi pyetur nxënësit se cilat janë ato njohuri që dëshirojnë t'i njohin?
- Pyetjet e nxënësve shënohen te rubrika "DUA TË DI".

| DI | DUA TË DI | MËSOJ |
|---|---|---|
| Përfshin fazën e parë të orës. Shënohen njohuritë të cilat i kanë të njohura nxënësit | Nxënësit bëjnë pyetje për karakteristikat e veçorive natyrore të Amerikës së Mesme që nuk i din. Pyetjet shënohen në këtë pjesë | Në pjesën përfundimtare të orës plotësohet kjo pjesë pas leximit të tekstit. |

- Jepet të lexohet njësia mësimore nga teksti, pas leximit nxënësit pyeten a kanë përgjigje për pyetjet e shënuara në rubrikën DUA TË DI. Nëse ka përgjigje, ato shënohen në pjesën MËSOJ.

Kjo teknikë mund të realizohet në tri fazat e orës. Në fund prezantohen punimet e nxënësve dhe plotësohen detyrat dhe aktivitetet që kërkohen në tekst në mënyrë që të bëhet reflektim i njësisë mësimore.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me

komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Duke u bazuar në numrat e vendosur në hartën e dhënë të Amerikës së Mesme, shënon emrat e tri grupeve të ishujve që gjinden në këtë rajon.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| Shoqëria dhe mjedisi | Gjeografi | 4 | VIII |

**Tema:**
Amerika – Veçoritë shoqërore-ekonomike.

**Rezultati i të nxënit të temës:**
- Dallon popujt më të njohur në Amerikën e Mesme sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**
I-3, 5, 8; II-2, 6, 7, 8; III-2, 7; IV-6; V-3, 6; VI-2.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**
3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.
3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.
4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.
4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:

**Njësia mësimore:** Amerika e Mesme, veçoritë shoqërore-ekonomike

**Fjalët kyçe:** Actekët, majët, përzierje racore, bujqësi ekstensive, plantacione, hekur, boksite, turizëm.

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**
1. Arsyeton përzierjen e madhe racore në mes popullsisë autoktone dhe asaj të ardhur në Amerikën e Mesme.
2. Dallon grupet etnike, fetare dhe gjuhësore në Amerikën e Mesme.
3. Përcakton shkallën e zhvillimit ekonomik të shteteve të Amerikës së Mesme.

**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***
1. Argumenton prezencën e fiseve të vjetra indiane dhe ndikimin e kolonizimit Europian në Amerikën e Mesme.
2. Shpjegon grupet etnike kryesore të popullsisë dhe prejardhjen e Mestikëve, Mulatëve dhe Zambozëve në Amerikën e Mesme.
3. Argumenton rolin e faktorëve natyrorë e shoqërorë në zhvillimin e bujqësisë dhe degëve tjera ekonomike në Amerikën e Mesme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**
Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës së Mesme, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**
Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse dhe kryesore – Hapi i parë dhe i dytë *(Kubimi)***

Nga nxënësit kërkohet që të analizohet fillimisht njësia mësimore në tekst. Më pas, nxënësit udhëzohen për mënyrën e punës, të cilën duhet ta zbatojnë. Zbulohen 6 fazat nëpër të cilat do të punohet (shkruhet në mënyrë individuale, në secilën fazë jepen udhëzimet se çfarë duhet të shkruhet, dhe në mes të fazave jepet hapësirë që nxënësit të shkruajnë:

- **Përshkruaje** – përshkruan grupet etnike kryesore të popullsisë dhe prejardhjen e Mestikëve, Mulatëve dhe Zambozëve në Amerikën e Mesme.
- **Krahasoje** – krahason zhvillimin ekonomik të Amerikës së Mesme me Amerikën Veriore.
- **Shoqëroje** – kujton fiset e njohura indiane që kanë jetuar në këtë rajon.
- **Analizoje** – karakteristikat e bujqësisë dhe degëve tjera ekonomike në Amerikën e Mesme.
- **Zbatoje** – gjen në hartë dhe atlas qendrat kryesore të Amerikës së Mesme.
- **Arsyetoje** – argumenton ndikimin e kolonizimit Europian në Amerikën e Mesme.

Qëllimi kryesor i kësaj teknike është përdorimi i pyetjeve të niveleve sipas Taksonomisë së Blumit. Nxënësit duke shfrytëzuar pyetjet apo kërkesat e mësimdhënësit/es kalojnë nga njohja, kuptimi, analiza, sinteza e deri të vlerësimi.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë *(Mini kuiz) pyetje – përgjigje.***

1. Çfarë pozite gjeografike ka Amerika e Mesme?
   a) të mirë strategjike b) relativisht të mirë c) të pa përshtatshme
2. Cili nga këto fise të vjetra indiane ka jetuar në rrafshnaltën e Meksikës?
   a) Inkët b) Actekët c) Majët
3. Amerika e Mesme eshtë e njohur me pasuritë:
   a) naftës b) hekurit c) diamanteve

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.
Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Duke e analizuar tabelën në tekst për të dhënat e shteteve të Amerikës së Mesme, renditin për nga sipërfaqja 5 shtetet më të mëdha.
- Vendoset në kolonën e saktë qyteti i duhur i Amerikës së Mesme.

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Dallon popujt më të njohur në Amerikën e Mesme sipas përkatësisë etnike, racore e fetare.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Meksika.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Rio Grande, Akapulko, mestikët, golfstrimi, nafta, Meksiko City.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Analizon pozitën e mirë gjeografike të Meksikës.<br>2. Dallon karakteristikat kryesore të veçorive natyrore të Meksikës.<br>3. Diskuton karakteristikat demografike të popullsisë së Meksikës.<br>4. Argumenton zhvillimin më të lartë ekonomik të Meksikës në krahasim me shtetet tjera të Amerikës së Mesme.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Vlerëson pozitë e mirë gjeografike të Meksikës në mes SHBA-së dhe shteteve tjera të Amerikës së Mesme.<br>2. Identifikon format kryesore të relievit, tipat klimatik, lumenjtë dhe brezat vegjetativ në Meksikë.<br>3. Numëron disa tipare dalluese të popullsisë së Meksikës.<br>4. Tregon zhvillimin e bujqësisë, industrisë, turizmit dhe degëve tjera ekonomike në Meksikë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës së Mesme, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: foto, skica, video etj.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse - Hapi i parë:** ***(diskutim)***

Pasi mësimdhënësi/ja shënon kriteret e suksesit dhe fjalët kyçe, jep sqarimet kryesore për njësinë e cila do të trajtohet. Duke u bazuar në njohuritë paraprake për Amerikën e Mesme parashtrohen disa pyetje:

- Çfarë mendoni cili është shteti më i madh i Amerikës së Mesme?
- Çka e favorizon pozitën gjeografike të Meksikës?
- A mendoni se Meksika është e pasur me pasuri natyrore?
- Me cilat shtete kufizohet Meksika dhe ku ka dalje?

Në këtë mënyrë synohet të arrihet të njohuritë bazike për Meksikën në aspektin e përgjithshëm të veçorive gjeografike.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:** ***(Ruaje fjalën e fundit për mua)***

- Nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të njësisë mësimore të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ata janë më interesante. Pjesët e zgjedhura (paragrafi) dhe numri i faqes ku është marrë pjesa shkruhen në një fletëze, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citatin (pse e ka zgjedh atë pjesë?)
- Njëri nga nxënësit e tregon faqen ku e ka zgjedhë pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit tjerët japin mendimet e tyre rreth citatit.
- Në fund të diskutimit nxënësi I cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentin e tij për atë citat. E njëjta ecuri e leximit të citateve dhe komentimit praktikohet edhe te nxënësit tjerë. Në këtë mënyrë realizohet pjesa kryesore e njësisë me komente, diskutime dhe analizë të dukurive gjeografike për Meksikën

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë:** ***(kllasteri)***

Mësimdhënësi/ja në qendër të tabelës shënon njësinë dhe i jep disa ndarje, nxënësit gjatë kësaj kohe fillimisht në dyshe e pastaj edhe në grupe e plotësojnë, duke i treguar informatat e marra gjatë zhvillimit të orës mësimore.. Në fund prezantohen punimet e nxënësve dhe plotësohen detyrat dhe aktivitetet që kërkohen në tekst në mënyrë që të bëhet reflektim i njësisë mësimore.




**Vërejtje**: teknika klasteri është dhënë vetë si shembull

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Gjen pohimin e saktë për fjalitë e shënuara.<br>• Tregon cila rrymë detare ndikon në klimën e Meksikës?<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Veçoritë natyrore të regjioneve amerikane.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Analizon pozitën gjeografike, madhësinë e territorit dhe shtetet që e përbëjnë Amerikën Jugore si një regjion i veçantë.<br>• Dallon tërësitë e mëdha relievore: Ultësirën e Amazonit, të Orinokos, rrafshnaltën e Guajanës, pllajën e Brazilit.<br>• Analizon veçoritë klimatike dhe hidrografike të Amerikës Jugore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.<br>2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Oqeani Atlantik dhe Paqësor, Andet, ultësira e Amazonit, brezi i nxehtësisë, selvaset, pampaset.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Rio Grande, Akapulko, mestikët, golfstrimi, nafta, Meksiko City.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Përcakton pozitën gjeografike, kufijtë dhe madhësinë e Amerikës Jugore.<br>2. Identifikon format kryesore të relievit të Amerikës Jugore.<br>3. Vlerëson rolin e faktorëve klimatik në ndikimin e llojeve të klimës, hidrografisë dhe përhapjes së zonave vegjetative.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Përkufizon në hartë kufijtë, madhësinë dhe pozitën gjeografike të Amerikës Jugore ndaj regjioneve tjera.<br>2. Shpjegon veçoritë kryesore të maleve, ultësirave qendrore dhe rrafshnaltave në Amerikën Jugore.<br>3. Dallon faktorët dhe tipat klimatik, lumenjtë dhe liqenet si dhe zonat vegjetative të Amerikës Jugore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike e Amerikës Jugore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet: harta hidrografike dhe vegjetative, foto, skica, video etj.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë: (Asociacion)**

Fillimisht mësimdhënësi/ja realizon një asociacion të shkurtër me disa fjalë kyçe për të arritur deri të njësia e re mësimore.

| latine | Brazili | ekuatoriale | Andet |
|---|---|---|---|
| Amerika Jugore | | | |

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:** ***(ditari trepjesësh)***

Nxënësit orientohen për të lexuar njësinë mësimore dhe gjatë leximit do të merren shënime. Gjatë shënimeve udhëzohen nxënësit që fletën ta ndajnë në tri pjesë me vijë vertikale. Në pjesën e parë shkruajnë ndonjë citat nga teksti (pjesë që u bën përshtypje), në mes shkruhen komentet: Pse jemi përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri të mendoni? (komenti pse ju bëri përshtypje?)etj. Te shtylla e tretë bëhet arsyetimi apo argumentimi i mendimit apo komentit.

Njësia lexohet duke u ndalur, për të shkruar së paku katër herë deri në fund. Koha e leximit 20 min. Pas leximit kërkohet vullnetar (2,3 veta)që të japin komentet e tyre. Më pastaj nxënësit vullnetarë pyeten: Pse u tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çfarë ju bëri të mendoni?

Pyetet nëse ka ndonjë tjetër që e ka zgjedh të njëjtën pjesë?

Në fund mësimdhënësi/ja jep komentet e veta të nxjerra për pjesët të cilat nuk janë trajtuar nga nxënësit.

| Citati | Komenti | Argumenti/arsyetimi |
|---|---|---|
| Përthyerja bregdetare, Amerika Jugore ka bregdetin më të pa përthyer në botë.<br>……<br>……<br>…..<br>…. | Ky konstatim vije si rezultat i formave të pakta bregdetare në Amerikën Jugore.<br>…..<br>….<br>….<br>…. | Numër i vogël i ishujve, gadishujve dhe gjireve detare.<br>….. |

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR: |
|---|
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Vendosin në hartë shkronjat që i korrespondojnë elementeve gjeografikë të dhëna.<br>• Në hartën e hidrografisë së Amerikës Jugore vendosin emrat e lumenjve.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Arsyeton strukturën e popullsisë së Amerikës Jugore sipas përkatësisë kombëtare, racore dhe fetare.<br>• Analizon shtrirjen gjeografike të mineraleve më të njohura në këtë regjion, si: hekuri, mangani, boksiti, ari, nafta, diamanti etj.<br>• Dallon pasuritë natyrore më të njohura (metaleve, naftës, qymyrit, gazit e pasurive të tjera) dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Amerika Jugore, veçoritë shoqërore-ekonomike. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Kolonizimi europian, latine, inkët, përzierje racore, resurset natyrore, degët ekonomike. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Diskuton përbërjen etnike, racore, gjuhësore dhe fetare të popullsisë së Amerikës Jugore.<br>2. Identifikon pasuritë minerale dhe resurset tjera natyrore të Amerikës Jugore.<br>3. Vlerëson rolin e resurseve natyrore në zhvillimin ekonomik të shteteve të Amerikës Jugore.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Analizon ndikimin e kolonizimit Europian në përbërjen strukturave të popullsisë së Amerikës Jugore.<br>2. Tregon në hartë shtrirjen e rajoneve gjeografike të pasura me resurse ekonomike.<br>3. Nxjerr  përfundime për zhvillimin e degëve të ndryshme ekonomike në Amerikën Jugore. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës Jugore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, foto, skica, video etj.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**

Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i parë:** ***(stuhi mendimesh)***

Mësimdhënësi/ja pasi i shënon fjalët kyçe në tabelë, ju drejtohet nxënësve me disa pyetje për t'i drejtuar ata drejt njësisë mësimore.:

- Çfarë mendoni pse Amerika Jugore quhet ndryshe Amerika Latine?
- A e dini se cilat grupacione etnike të popullsisë dominojnë në Amerikën Jugore?
- Keni dëgjuar ndonjëherë për civilizimin e Inkëve?
- A e dini se nga e ka prejardhjen kultura e misrit?

Mësimdhënësi/ja pret përgjigjet e nxënësve dhe i shënon në tabelë.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë:** ***(Truri i Galerisë)***

Në këtë pjesë mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në 4 grupe duke ju ndarë kategori të ndryshme të njësisë mësimore. Ata udhëzohet të punojnë në mënyrë të pavarur dhe njohuritë e tyre t'i shënojnë në flip chart.

Grupi 1 – udhëzohet të punojë rreth karakteristikave të popullsisë së Amerikës Jugore. T'i veçojnë racat kryesore, popujt, fetë të cilat dominojnë, hapësirat më të dendura, shtimin natyrorë etj.

Grupi 2 – udhëzohet të punojë rreth pasurive natyrore të cilat i ka ky rajon si: mineralet kryesore, pyjet, kullosat, tokat punuese, pasuria me ujëra etj.

Grupi 3 – udhëzohet të punoj rreth zhvillimeve historike të këtij rajoni. Civilizimet e hershme, zbulimet, monumentet historike etj.

Grupi 4 – udhëzohet të punojë rreth zhvillimit ekonomik të shteteve të këtij rajoni. Shtetet më të zhvilluara dhe ato më pak të zhvilluara, degët kryesore ekonomike, prodhimet bujqësore, industriale, turizmit, komunikacionit etj.

Pasi të përfundohet, punimet vendosen në muret e klasës.

Më shenjë të mësuesi/ja t nxënësit lëvizin rreth klasës, shikojnë punimet, diskutojnë për ato, shkruajnë komente etj.

Në fund grupet marrin punimet e veta, rishikojnë, krahasojnë me punimet e të tjerëve, lexojnë komentet e mara nga të tjerët.

**Pjesa përfundimtare – Hapi i tretë: (3, 2, 1)**

Pas përmbledhjes përfundimtare, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që në mënyrë individuale të shënojnë në fletore:

- 3 karakteristika kryesore të popullsisë së Amerikës Jugore.
- 2 degët më të rëndësishme ekonomike të Amerikës Jugore.
- 1 aspekt interesant nga Amerika Jugore që atyre ju ka lënë përshtypje.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve,

portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:**

Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.

- Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.

Punë e pavarur:

- Poshtë fotove vendos emrat e grupacioneve etnike të popullsisë në Amerikën Jugore.
- Tregon dy shtetet e vetme në Amerikën Jugore të cilat nuk kanë dalje në oqeane apo det.
- Në bazë të fotos tregon civilizimin e popullsisë indigjene (vendase).

Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës

**REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE: | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shoqëria dhe mjedisi | **Lënda:**<br>Gjeografi | **Shkalla e kurrikulës:**<br>4 | **Klasa:**<br>VIII |
| **Tema:**<br>Amerika–veçoritë shoqërore-ekonomike. | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>• Arsyeton strukturën e popullsisë së Amerikës Jugore sipas përkatësisë kombëtare, racore dhe fetare.<br>• Dallon pasuritë natyrore më të njohura (metaleve, naftës, qymyrit, gazit e pasurive të tjera) dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës *(të synuara)*:**<br>I-2, 3, 8; II-1, 2, 6, 8; III-1, 2, 7; IV-3, 6; V-3, 6; VI-3, 5. | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës *(të synuara)*: RNF:**<br>3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe pe0072iudha të ndryshme.<br>3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.<br>4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:** | | | |
| **Njësia mësimore:** Brazili dhe Argjentina. | | | |
| **Fjalët kyçe:** Rrafshnalta e Brazilit, pampaset, mestikët, vend i kafes, Rio de Zhaniero, Buenos Ajres, Gauçosët. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Përcakton pozitën gjeografike, kufijtë dhe madhësinë e Brazilit dhe Argjentinës.<br>2. Analizon përbërjen e strukturave të popullsisë së Brazilit dhe Argjentinës.<br>3. Shpjegon specifikat e zhvillimit ekonomik të Brazilit dhe Argjentinës.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Përshkruan në hartë pozitën gjeografike, kufizimin dhe madhësinë e Brazilit dhe Argjentinës.<br>2. Analizon karakteristikat e përbërjes etnike, racore, gjuhësore dhe fetare të dy këtyre shteteve.<br>3. Krahason zhvillimin e degëve ekonomike në mes Brazilit dhe Argjentinës. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br>Teksti Gjeografia 8, harta fizike dhe politike e Amerikës Jugore, fletore pune, atlasi, fletë A4, markera, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, foto, skica, video etj. | | | |

**Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**<br>1. Bën diferencimi e rajoneve të ndryshme ekonomike sipas shkallës së zhvillimit të tyre.<br>2. Analizon faktorët e globalizimit të ekonomisë botërore në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik.<br>3. Shpreh pabarazinë e zhvillimit ekonomik në mes shteteve dhe rajoneve të ndryshme të botës.<br>**Kriteret e suksesit:** ***(formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)***<br>1. Përshkruan karakteristikat e zhvillimit ekonomik të rajoneve të ndryshme të botës.<br>2. Diskuton për faktorët që kanë ndikuar në globalizimin e ekonomisë botërore në ditët e sotme.<br>3. Krahason zhvillimin ekonomik në mes shteteve të zhvilluara, me pak të zhvilluara dhe atyre të pazhvilluara. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**<br>Teksti Gjeografia 8, harta politike e botës, fletore pune, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, foto, skica, video etj | | | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:**<br>Histori, Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media. | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

**Pjesa hyrëse – Hapi i pare:** ***(diskutim i përbashkët)***

Fillimisht mësimdhënësi/ja pasi bën një prezantim të shkurtër për njësinë mësimore, hap diskutimin më nxënës duke pasur parasysh se gjatë tërë vitit është diskutuar diferencat e zhvillimit ekonomik të rajoneve të ndryshme të botës. Mësimdhënësi/ja për të ngjallur kureshtjen e nxënësve dhe rikujtuar ato të cilat janë mësuar deri më tani parashtron disa pyetje për diskutim:

- - Çfarë mendoni, cilat ishin rajonet e botës më të zhvilluara dhe cilat ato më pak të zhvilluara ekonomikisht?
- - Cilat ishin arsyet apo faktorët që kanë ndikuar në këto diferencime ekonomike?

Mësimdhënësi/ja pret përgjigjet e nxënësve dhe disa që ishin më interesante i shënon në tabelë.

**Pjesa kryesore – Hapi i dytë** ***(tryeza e rrumbullakët)***

Mësimdhënësi/ja paraprakisht, para se të zhvillohet aktiviteti i udhëzon nxënësit ta lexojnë njësinë mësimore, që ata të kenë informacione shtesë për temën që do të diskutohet.
Ky aktivitet ka për qëllim frymën bashkëpunuese në mes nxënësve, me të cilën merren ide nga anëtaret e grupeve për çështjen e caktuar. Formohet tryeza e rrumbullakët me nxënës dhe jepet një fletë, ku në fund të saj shënohet tema e cila do të diskutohet, e që në rastin konkret shënohet “Dallimet e zhvillimit ekonomik në mes rajoneve të ndryshme të botës”.
Letra përcillet me radhë, nga e majta tek anëtaret e tjerë të grupit të cilët shtojnë idetë e tyre për çështjen. Secili anëtar pasi shkruan idetë e tij për temën e palon pjesën ku ka shkruar (që të tjerët mos e shohin), dhe e përcjell te partneri në të majtë. Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të mos shënojnë me një ngjyrë lapsi, por secili anëtar i grupit ta ketë lapsin me ngjyrë që dallon.
Në fund hapet letra dhe diskutohen idetë të cilat janë shënuar nga secili anëtar i grupit. Jepen komentet shtesë nga nxënësit, si dhe nga mësimdhënësi/ja.

**Pjesa përfundimtare:**

Në pjesën përfundimtare, nxënësit formojnë tabelë e koncepteve në të cilën shënojnë për dallimet në ekonomi në mes rajoneve të ndryshme të botës.

| | *Rajonet më të zhvilluara ekonomike të botës* | *Rajonet më pak të zhvilluara ekonomikisht* |
|---|---|---|
| Identifikon rajonet sipas diferencave ekonomike. | | |
| Tregon shkaqet e zhvillimit ose jo ekonomik. | | |
| Përshkruan trendët e zhvillimit ekonomik në këto rajone. | | |

**VLERËSIMI I NXËNËSVE:**

Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

| |
|---|
| Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Punë e pavarur e detyrave të kërkuara në tekst.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda:<br>Gjeografi</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>4</td><td>Klasa:<br>VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema:<br>Procese dhe tipare globale shoqëro-ro-ekonomike dhe mjedisore.</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>• Identifikon përpjekjet bashkëkohore për ruajtjen e baraspeshës në kushtet e rritjes së konsumit dhe popullsisë në botë, duke respektuar normat mjedisore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):<br>I-1, 2, 3, 5, 8; II-1, 2, 7, 8; III-1, 2, 6, 7; IV-3, 4, 6, 8; V-1, 3, 5, 6, 9; VI-1, 2, 3.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): RNF:<br>5.1. Prezanton shembuj se si, si një individ dhe si një anëtar i një grupi, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Shfrytëzimi i pasurive natyrore dhe rritja e konsumit të popullsisë në raport me ruajtjen e normave mjedisore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Ndotja e ambientit, shfrytëzimi i pasurive, zhvillim i qëndrueshëm, riciklimi i materialeve, normat mjedisore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:<br>1. Analizon mënyrën e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ndikimin e këtij shfrytëzimi në mjedisin jetësor.<br>2. Jep shembuj rreth mënyrës së ruajtjes së baraspeshës në mes shfrytëzimit të pasurive natyrore dhe ruajtjes së normave mjedisore.<br>3. Shfaq problematikat e rritjes globale të popullsisë dhe nevojës për konsum më të gjerë.<br>Kriteret e suksesit: (formohen në klasë nga mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit)<br>1. Argumenton ndikimin e njeriut në shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës.<br>2. Vlerëson rolin e shfrytëzimit të pasurive natyrore brenda normave dhe rregullave mjedisore.<br>3. Tregon shembuj rreth përpjekjeve të shteteve dhe organizatave të ndryshme botërore për ruajtjen e ambientit jetësor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br>Teksti Gjeografia 8, harta politike e botës, fletore pune, laptopi dhe projektori, material shtesë nga internet:, foto, skica, video etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët tjera mësimore apo çështjet ndër kurrikulare:<br>Histori, Edukatë Edukatë Qytetare, Biologji, Gjuhë dhe Komunikim, Artet, TIK; Edukimi për qytetari demokratike, Edukimi për paqe, Globalizimi dhe ndërvarësia, Edukimi për media.</td></tr>
</table>

| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARIVE TË PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:** |
|---|
| **Pjesa hyrëse: Hapi i parë *(stuhi mendimesh)*** |
| Problemet ambientale janë mjaft aktuale dhe të diskutueshme, prandaj mësimdhënësi/ja hap diskutimin me nxënës përmes disa pyetjeve për këtë temë problemore:<br>• Çfarë mendoni se janë problemet e ambientit sot në botë?<br>• Si ndikon rritja e numrit të popullsisë në shfrytëzimin e hapësirave të ndryshme të ambientit?<br>Pas një diskutimi të shkurtër rreth këtyre çështjeve, mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në grupe dhe delegon detyrat të cilat duhet të fokusohen ata. |
| **Pjesa kryesore: Hapi i dytë *(teknika RAFT)*** |
| Nxënësve u caktohet tema për diskutim “shfrytëzimi i resurseve natyrore, dhe ndikimi I tyre në hapësirat ambientale”, për të cilën do të shkruajnë dhe e cila është mjaft aktuale.<br>Nga nxënësit kërkohet që të mendojnë për rolet e mundshme nga të cilat mund të shkruhet (rolin: e gazetarit, nxënësit, qytetarit, mjekut etj.).<br>Rolet e mundshme shkruhen në tabelën e murit, të cilat mund t’i përgatitë vet mësimdhënësi/ja dhe t’i prezantojë para nxënësve.<br>Formohen grupe me 4-5 nxënës dhe u caktohen rolet apo pozitat nga do të shkruajnë për temën e caktuar. Në këtë mënyrë nxënësit fillojnë të mendojnë për formën që duhet të shkrimi i tij. Në një kohë të caktuar prej 10-15 minutash shkruhet në mënyrë individuale.<br>Grupet shkëmbejnë idetë dhe formojnë një shkrim të përbashkët. Në fund lexohet nga një shkrim nga grupet me role të ndryshme dhe shihet këndvështrimi i secilit rol. |
| **Pjesa përfundimtare: *(Ese)*** |
| Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që duke u bazuar në problemet aktuale në aspektin lokal, ta shkruajnë një ese për ambientin duke menduar në aspektin global.<br>Disa nga esetë lexohen për fund, dhe jepen mendime, diskutime apo komente nga nxënësit tjerë. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE:** |
| Vlerësimi realizohet në mënyre të vazhdueshme (vlerësim formativ), në fund të çdo njësie mësimore duke pasur parasysh angazhimin e nxënësve në klasë, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente kthyese konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.<br>Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në listën e kontrollit apo në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive qe motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR:** |
| Detyrat realizohen në bashkëveprim me aktivitetet e planifikuara gjatë orës mësimore apo edhe pas saj si punë e pavarur.<br>• Pyetjet dhe detyrat në tekst, në fund të njësisë mësimore.<br>Punë e pavarur:<br>• Punë e pavarur e detyrave të kërkuara në tekst.<br>Plotësimi i aktiviteteve në fletoren e punës |
| **REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE:** |
| Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi/ja bën një vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve. |

# METODOLOGJIA DHE INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

**“Vlerësimi është proces i kërkimit dhe i interpretimit të dëshmive nga nxënësit dhe mësimdhënësit e tyre për të konstatuar nivelin ku janë, ku duhet të arrijnë dhe si të përmirësohen arritjet e tyre.” (Grupi për Reformimin e Vlerësimit, 2002).**

Korniza Kurrikulare e Kosovës për vlerësim bazohet në këto parime:

- *Vlefshmëria.*
- *Transparenca.*
- *Besueshmëria.*
- *Paanshmëria.*

**Llojet e vlerësimeve**

Korniza Kurrikulare përcakton dy lloje të vlerësimit:

- Vlerësimi i brendshëm
- Vlerësimi i jashtëm

**Llojet e vlerësimit të brendshëm**

*Korniza Kurrikulare përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm:*

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë

*(për më shumë informacione konsulto Kornizën Kurrikulare* të Kosovës)

UA nr. 6/2022 nga MASHTI është udhëzim administrativ, i cili rregullon vlerësimin e brendshëm të nxënësve. Në vazhdim po japim disa nga nenet e Udhëzimit të ri Administrativ, i cili ju udhëzon dhe ndihmon në mënyrën e vlerësimit të brendshëm për arritjen e rezultateve e të nxënit nga nxënësit:

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4, të Ligjit nr.04/L-32 për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 17/16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30. 03. 2021, Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ, nr. 03/2013, dt. 16.05.2013) nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Neni 1 Qëllimi**

Ky udhëzim administrativ, përcakton dhe rregullon vlerësimin e brendshëm të nxënësve, procedurat për realizimin e tij, dokumentacionin shkollor që përdoret për vendosjen e rezultateve të vlerësimit, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e shkollës për realizimin e këtij vlerësimi.

**Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ zbatohen nga të gjitha institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese parauniversitare, publike dhe private, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

**Neni 3 Vlerësimi i nxënësit**

1. Vlerësimi ka për qëllim mbledhjen e informacioneve për përkrahjen e nxënësit në zotërimin e rezultateve të të nxënit, përcaktimin e nivelit të performancës, raportimin e rregullt të progresit, certifikimin dhe orientimin në shkollim të mëtejshëm.
2. Vlerësimi i nxënësit bazohet në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, e cila i përcakton edhe parimet e të vlerësuarit: vlefshmëria, transparenca, besueshmëria dhe paanshmëria.

**Neni 4 Vlerësimi i brendshëm**

1. Vlerësimi i brendshëm i nxënësve bëhet në nivel shkolle/klase nga mësimdhënësit e shkollës me qëllim të lehtësimit dhe përkrahjes së të nxënit të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave bazuar në rezultatet e të nxënit.
2. Vlerësimi i brendshëm i nxënësve realizohet nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm, vlerësimit përfundimtar dhe vlerësimit për shkallë.

**Neni 5 Vlerësimi i vazhdueshëm**

1. Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve realizohet nëpërmjet vlerësimit formativ (për të nxënë) dhe vlerësimit përmbledhës (i të nxënit).
2. Vlerësimi formativ është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënit. Realizohet nga mësimdhënësi/ja gjatë tërë vitit mësimor, duke u bazuar në rezultatet e të nxënit.
3. Vlerësimi përmbledhës:

3.1. Është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënit dhe realizohet nga mësimdhënësi/ja gjatë gjithë vitit shkollor, bazuar në rezultatet e të nxënit dhe bëhet me notë numerike (neni 7) ose me vlerësim përshkrues sipas paragrafit 5 të këtij neni;

3.2. Realizohet në dy gjysmëvjetorë;

3.3. Për një gjysmëvjetorë vendosen dy (2) nota në librin e klasës, ku koha e planifikimit të vendosjes së tyre është e ndarë proporcionalisht me kohëzgjatjen e gjysmëvjetorit;

3.4. Notat e një gjysmëvjetori janë vlerësime përmbledhëse që pasqyrojnë nivelet e arritjes së rezultateve të të nxënit bazuar në matje me instrumente të ndryshme të hartuara nga mësimdhënësit dhe me kritere të vlerësimit, të cilat bazohen në parimet e vlerësimit të përcaktuara me dokumentet kurrikulare;

3.5. Llojin e instrumenteve për vlerësimin përmbledhës e përcakton Aktivi (Departamenti) Profesional, ku numri i tyre nuk duhet të jetë më pak se tri (3) (p.sh evidencat e angazhimit në klasë, detyrat e shtëpisë, kuize, debate, prezantime me gojë, ese, teste, portofolio, projekt, punë praktike apo ndonjë instrument tjetër që shihet si i përshtatshëm nga Aktivi (Departamenti) Profesional);

3.6. Rezultatet e vlerësimit përmbledhës evidentohen në ditarin personal të mësimdhënësit me komente dhe nota për nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënit;

3.7. Për realizimin e vlerësimit përmbledhës, Aktivi (Departamenti) Profesional harton planin e vlerësimit në fillim të vitit shkollor i cili duhet të harmonizohet në nivel shkolle për klasat e njëjta me Aktivet (Departamentet) tjera Profesionale;

3.8. Aktivet (Departamentet) Profesionale, për të mos ngarkuar nxënësit në një klasë, nuk duhet të planifikojnë me më shumë se një test ose detyrë përmbledhëse në ditë për qëllime të vlerësimit me notë;

3.9. Plani i vlerësimit përcakton dhe rregullon aspektet kryesore të vlerësimit përmbledhës që ka për qëllimvlerësimin e nxënësve me notë;

3.10. Formati dhe kërkesat/elementet e planit të vlerësimit shtjellohen me një udhëzues të veçantë të përgatitur nga MASHTI.

4. Nota e vlerësimit që tregon nivelin e arritjes së rezultateve të nxënit për një gjysmëvjetor nxirret si mesatare aritmetike e dy notave të vlerësimit përmbledhës brenda atij gjysmëvjetori dhe përshkruhet sipas nenit 6 të këtij Udhëzimi administrativ.

5. Nxënësit e shkallës I (klasa parafillore dhe klasat 1-2) nuk vlerësohen me notë numerike, por vlerësohen me komente profesionale të standardizuara kundrejt rezultateve të të nxënit.

6. Përveç mesatares aritmetike, për vendosjen e notës së vlerësimit në fund të gjysmëvjetorit, mësimdhënësi/ja mund të merr për bazë edhe dëshmitë për punën konstruktive, angazhimin në frymën ekipore, dhe përparimin e nxënësit nga çdo evidencë e vlerësimit gjatë gjysmëvjetorit përkatës.

7. Pas çdo vlerësimi, në përfundim të gjysmëvjetorit, mësimdhënësit informojnë prindërit/kujdestarët për arritjet e nxënësve.

8. Mësimdhënësit duhet të mbajnë shënime të vazhdueshme në ditarin personal për përcjelljen e progresit të secilit nxënës. Me shënime në ditarin personal dëshmohet puna dhe progresi i secilit nxënës dhe mbështetja shtesë e ofruar për nxënësit që nuk arrijnë minimumin e rezultateve të të nxënit.

9. Evidencat nga vlerësimi i vazhdueshëm dhe raportet e vlerësimit të nxënësit ruhen nga mësimdhënësit së paku për një shkallë kurrikulare dhe janë objekt monitorimi nga drejtori i shkollës, si dhe institucionet përgjegjëse që merren me monitorimin e punës së mësimdhënësit dhe punës së shkollës.

**Neni 6 Vlerësimi përfundimtar**

1. Bëhet për çdo lëndë mësimore në fund të vitit mësimor/vitit shkollor.

2. Nota e vlerësimit përfundimtar në një lëndë mësimore për një vit shkollor arrihet/vendoset me mesataren aritmetike të notave nga dy gjysmëvjetorët e vitit shkollor.

3. Nota numerike për gjysmëvjetor dhe vit shkollor shënohet me notë numerike (1, 2, 3, 4 dhe 5), si vijon:

3.1. Nota 1 (pamjaftueshëm) – mesatarja e notave (1.00-1.49);

3.2. Nota 2 (mjaftueshëm) – mesatarja e notave (1.50-2.49);

3.3. Nota 3 (mirë) – mesatarja e notave (2.50-3.49);

3.4. Nota 4 (shumë mirë) – mesatarja e notave (3.50-4.49);

3.5. Nota 5 (shkëlqyeshëm) – mesatarja e notave (4.50-5.00).

4. Për vendosjen e notës përfundimtare në fund të vitit shkollor, mund të merren për bazë edhe dëshmitë për angazhimin konstruktiv, punën në frymën ekipore dhe përparimin e nxënësit nga një gjysmëvjetor në tjetrin krahas notave përfundimtare të gjysmëvjetorëve, nëse mësimdhënësi/ja e konstaton se rezultatet e arritura nga nxënësit meritojnë notë më të lartë se nota që fitohet nga mesatarja aritmetike.

5. Dëshmitë e këtilla duhet të mblidhen në kohë reale gjatë tërë gjysmëvjetorit/vitit shkollor, dhe ndryshimi eventual i notës duhet të vërtetohet në një raport që i përmban këto dëshmi.

*(për më shumë informacione konsulto UA nr.6/2022, MASHT).*

# VLERËSIMI I VAZHDUESHËM

Vlerësimi i vazhdueshëm realizohet përmes **Vlerësimit Formativ** dhe **Vlerësimit Përmbledhës.**

**Vlerësimi Formativ:** Ky lloj vlerësimi realizohet gjate gjithë vitit mësimor nëpërmjet angazhimit të nxënësve në klase, nëpërmjet detyrave të shtëpisë, kuizeve, debateve, prezantimeve, eseve, testeve, portofoliove, projekteve, punës në kabinet; si dhe realizohet duke u bazuar në rezultatet e të nxënit dhe duke i dhënë nxënësit komente konstruktive për arritjen e atyre rezultateve.

Rezultatet e vlerësimit formativ evidentohen në ditarin personal të mësimdhënësit me komente për nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit. Rezultatet raportohen të nxënësit dhe prindërit me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e nxënësit.

Vlerësimi formativ asnjëherë nuk duhet të shoqërohet me notë numerike, por vetëm me komente konstruktive, në të kundërtën nuk është vlerësim formativ apo për të nxënë, por vlerësim përmbledhës.

**Vlerësimit Përmbledhës:** apo vlerësimi i të nxënit (sumativ) bazohet në rezultatet e të nxënit dhe ka për qëllim të mat se çfarë dhe sa kanë mësuar nxënësit për një njësi, për një semestër (tremujor) apo për një periudhe të caktuar kohore, të përcaktuar sipas planit të vlerësimit, me qëllim që ai vlerësim t'u raportohet prindërve, mësimdhënësve dhe personave të tjerë relevante. Sipas Kurrikulës së Kosovës, vlerësimi i tillë shoqërohet me notë numerike, ndërsa nota formohet për arritjet e nxënësit në përmbushjen e rezultateve te të nxënit dhe zotërimin e kompetencave.

**Vler**ësimi Përfundimtar: Vlerësimi përfundimtar në një lëndë mësimore realizohet në nivel klase si vlerësim i përfundimit të vitit mësimor nxjerrë nga mesatarja aritmetike e dy periudhave te caktuara mësimore.

# PËRZGJEDHJA E METODËS SË VLERËSIMIT

Metoda e vlerësimit duhet te jetë e përshtatshme për vlerësimin e rezultateve te të nxënit. Metodat e ndryshme të vlerësimit janë më të përshtatshme për testimin e grupeve të ndryshme te shkathtësive. Për shembull, një test me alternativa vlen për të testuar të kuptuarit e informatave faktike nga ana e nxënësve, mirëpo nuk na ndihmon shumë për të zbuluar shkathtësitë e tyre të mendimit kritik. Nëse rezultatet tuaja të të nxënit kanë të bëjnë me shkathtësitë e mendimit kritik të nxënësve, atëherë një mënyre me e mirë e vlerësimit mund të jetë që t'u kërkohet nxënësve të shkruajnë një ese argumentuese. Ngjashëm, nëse rezultatet tuaja të të nxënit lidhen me shkathtësitë e komunikimit, atëherë mënyra me e mirë mund të jetë që të caktoni një prezantim me gojë ose të organizoni një debat. Nëse rezultatet e të nxënit lidhen me aftësinë e kërkimit të informacionit të nxënësit/es, atëherë mënyra më e mirë e vlerësimit mund të jetë zbatimi i një projekti nga ana e nxënësve, në vend të hartimit të një eseje, në të cilën nxënësit do të shkruanin për procesin e kërkimit të informacionit.

Në mesin e metodave të vlerësimit, krahas testeve me përgjigje të shkurtra dhe eseve, përfshihen edhe detyrat e shtëpisë, angazhimi në klasë, projektet individuale, prezantimet me gojë, testet e të dëgjuarit, testet me libra të hapur, portofoliot, puna praktike etj.

Kohëzgjatja e testeve gjithmonë caktohet paraprakisht dhe nxënësit duhet të jenë të informuar me kohë. Mësimdhënësit e lëndëve të ndryshme duhet të kenë parasysh që të koordinojnë kohën e administrimit të testeve, në mënyrë që nxënësit të mos ngarkohen në të njëjtën kohë me shumë testime.

**Ne një test mund të përfshihen këto lloje kërkesash:**

- Pyetje me Po/Jo
- Pyetje me E vërtetë/E pavërtetë
- Pyetje me zgjedhje të shumëfishta
- Bashko fjalët nga kolona A me fjalët nga kolona B
- Pyetje me përgjigje të shkurtër
- Pyetje të hapura
- Vendos fjalët në vendin e duhur në tekst. Etj.

**Vlerësimi përmbledhës përfshin këto instrumente vlerësuese:**

- Angazhimi në klase;
- Detyrat e shtëpisë;
- Kuize;
- Debate;
- Prezantime me goje;
- Ese;
- Teste (teste për periudha të shkurtra kohore);
- Portofolio;
- Projekte (individuale apo grupore);
- Puna në kabinet, etj.

# INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

## *Model i ditarit personal të mësimdhënësit*

<table>
<tr><th colspan="21">Ditar personal i Mësimdhënësit</th></tr>
<tr><th colspan="11" rowspan="2">Komuna:</th><th colspan="10">Mësimdhënësi:</th></tr>
<tr><th colspan="10">Lënda:</th></tr>
<tr><th colspan="11">SHFMU “(emri i shkollës) ” – (vendndodhja)</th><th colspan="10">Klasa: ___________</th></tr>
<tr><th rowspan="3">Nr.</th><th rowspan="3">Emri dhe mbiemri</th><th rowspan="3">Gjysmëvjetori</th><th colspan="8">Nota e parë (50%)</th><th colspan="8">Nota e dytë (50%)</th><th rowspan="3">Nota përmbledhëse e gjymsëvjetorit të I dhe II</th><th rowspan="3">Nota përfundimtare në mbarim të vitit</th></tr>
<tr><th>Detyrat e shtëpisë</th><th>Kuize/ Debate</th><th>Angazhimi në klasë</th><th>Teste</th><th>Dosje/ Portofolio</th><th>Prezantim</th><th>Punë praktike</th><th>Nota e parë</th><th>Detyrat e shtëpisë</th><th>Kuize/ Debate</th><th>Angazhimi në klasë</th><th>Teste</th><th>Dosje/ Portfolio</th><th>Prezantim</th><th>Punë praktike</th><th>Nota e dytë</th></tr>
<tr><th>10 %</th><th>10 %</th><th>20 %</th><th>20 %</th><th>5 %</th><th>5 %</th><th>30 %</th><th>100 %</th><th>10 %</th><th>10 %</th><th>20 %</th><th>20 %</th><th>5 %</th><th>5 %</th><th>30 %</th><th>100 %</th></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="2"></td><td rowspan="2"></td><td>I</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td rowspan="2"></td></tr>
<tr><td>II</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

**Sqarim:** Tabelari është hartuar sipas Udhëzimit të ri Administrativ nr.6/2022, i cili parasheh vlerësim me dy nota brenda një gjysmëvjetori të ndara proporcionalisht për atë gjysmëvjetor (d.m.th. gjysmëvjetori i parë i ka 4 muaj atëherë nota e parë vendoset në fund të tetorit, ndërsa nota e dytë në fund të dhjetorit, ndërsa gjysmë vjetori i dytë i ka 6 muaj atëherë nota e parë vendoset në fund të marsit kurse nota e dytë në fund të dhjetorit).

Instrumentet dhe përqindjet mund t'i ndryshoni varësisht sipas specifikave të lëndëve dhe kërkesave të mësimdhënësit.

**Vërejtje:** Në ditarin personal duhet të përfshihen së paku 3 instrumente të vlerësimit.

Shembull:

Disa instrumente të parapara në udhëzimin administrativ:

- Evidencat e angazhimit në klasë
- Detyrat e shtëpisë
- Kuize
- Debate
- Prezantime me gojë
- Ese
- Teste
- Portfolio
- Projekt
- Punë praktike
- Etj. Ndonjë instrument i cili shihet i nevojshëm nga aktivi profesional.

***Model i listës së kontrollit dhe vlerësimit***

Listë kontrolli dhe vlerësimi për nxënës

Lënda: Gjeografi Kl.______ Emri dhe mbiemri i nx.:________________________

| **Shprehitë dhe aktivitetet të cilat dëshirojmë t'i vlerësojmë:** | Perioda | Aspak i interesuar | Rrallë i interesuar | Mesatarisht i interesuar | Në pjesën më të madhe të rasteve i interesuar | Në nivel të lartë i interesuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dëgjon, ka koncentrim, pranon dhe i kupton informatat e mesazhet. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Përshkruan, krahason, dallon, analizon faktet dhe opinionet. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Pret të flasë, di të fillojë bisedën, kërkon sqarime. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Përgjigjet për pyetjet që i bëhen dhe ka fjalor të pasur për tema të caktuara. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përdorur argumente dhe plotëson të tjerët gjatë shpjegimeve. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Angazhohet në punën në grupe dhe aktivitete tjera në klasë. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Përdorë mjete të konkretizimit (si harta, atlase dhe mjete të tjera). | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Përgatit prezantime me shkrim në forma elektronike dhe punime dore. | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| Shkruan saktë dhe qartë (ide, detyra, ese etj.). | **I** | | | | | |
| | **II** | | | | | |
| ***Vendos shenjen*** √ për vlerësim | | | ***Vlerësimi:***_______________ | | | |

| ***Mënyra e vlerësimit*** | |
|---|---|
| Nivel i ulët | (1) |
| Nivel i mjaftueshëm | (2) |
| Nivel mesatar | (3) |
| Nivel i lartë | (4) |
| Nivel shumë i lartë | (5) |

***Sqarim**: Vlerësimi të bëhet në bazë të mesatares së √ të vendosur në tabelë.

**Shembull i vlerësimit përmbledhës:**

Do të përdoren këto instrumente vlerësuese:

1. Angazhimi në klasë, ku pesha e vlerësimit do të jetë 20% e notës përmbledhëse 1;
2. Detyrat e shtëpisë, ku pesha e vlerësimit do të jetë 10% e notës përmbledhëse 1;
3. Prezantime me gojë, ku pesha e vlerësimit do të jetë 20% e notës përmbledhëse 1;
4. Projekt individual brenda shkolle, ku pesha e vlerësimit do të jetë 50% e notës përmbledhëse 1.

| | **Angazhimi në klasë** | **Detyrat e shtëpisë** | **Prezantime me gojë** | **Projekt individual** | **Nota sipas standardeve të UA-së.** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Arritje e pamjaftueshme (1)** | 4 pikë | 2 pikë | 4 pikë | 10 pikë | 0% - 39% |
| **Arritje e mjaftueshme (2)** | 8 pikë | 4 pikë | 8 pikë | 20 pikë | 40% - 54% |
| **Arritje e mirë (3)** | 12 pikë | 6 pikë | 12 pikë | 30 pikë | 55% - 69% |
| **Arritje shumë e mirë (4)** | 16 pikë | 8 pikë | 16 pikë | 40 pikë | 70% - 84% |
| **Arritje e shkëlqyeshme (5)** | 20 pikë | 10 pikë | 20 pikë | 50 pikë | 85% - 100% |
| **Nxënësi mospjesëmarrës në vlerësim** | 0 pikë | | | | I panotuar |

**Modele të testeve me shkrim:**

| **Test nga lënda e Gjeografis**ë | Grupi A | Klasa VIII Paralelja___<br>Emri dhe mbiemri_________________ | Numri në ditar:___ |
|---|---|---|---|
| Rezultati: Vlerësohet shkalla e arritjes së njohurive të të nxënit në zotërimin e përmbajtjeve mësimore. | **KUJDES**: **1)** Mos kopjo. **2)** Rrumbullakos vetëm përgjigjet e sakta. **3**) Mos shkarravit. **4)** Mos përmirëso nëse ke gabuar. | | |

| Nr. | Sqarime plotësimi | Detyrat dhe përgjigjet | Pikët | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Plotëso fjalinë | Në zbrazëtirën para fjalisë shëno **e saktë** ose **e pa saktë.**<br>1.__________ Afrika ka sipërfaqe prej mbi 30 milion km$^2$.<br>2.__________ Afrika e ulët përfshin pjesën lindore dhe jugore të kontinentit.<br>3.__________ Kanali i Suezit lidh detin e Kuq me oqeanin Indian.<br>4.__________ Në popullsinë negroide bëjnë pjesë **Sudanidët dhe Bantuidët.** | 4 | |
| 2 | Në hartën e dhënë shëno emrat e shteteve të Afrikës Veriore. | <br> | 6 | |
| 3 | Në hartën e dhënë shëno emrat e 4 lumenjve të Afrikës Perëndimore. |  | 4 | |
| 4 | Lidh me shigjetë: Lumenjtë dhe Liqenet për rajonet përkatëse | ***Liqeni Çad*** ***Rrafshnalta Jugafrikane***<br>***Lumi Oranje***<br>***Liqeni Viktoria*** ***Sahara***<br>***Liqeni Tanganjika***<br>***Lumi Zambesi*** ***Rrafshnalta Liqenore***<br>***Liqeni Naserit*** | 6 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Shkruaj: | Cilat janë dy insektet e viseve tropikale që përhapin sëmundjet e malaries dhe të gjumit?<br>*a)*______________________ *b)*______________________ | 2 | |
| 6 | Qarko përgjigjet e sakta | Qarko qytetet të cilat gjinden në Afrikën Perëndimore.<br>***Aleksandria*** ***Abixhani*** ***Johanesburgu***<br>***Lagosi*** ***Najrobi***<br>***Dakari*** ***Kartumi*** ***Konakri*** | 4 | |
| 7 | Rrumbullakos | Rretho:<br>Shteti i cili shtrihet në Bririn e Afrikës është:<br>***a) RD.e Zaires*** ***b) Somalia*** ***c) Kameruni*** | 1 | |
| 8 | Vendos **po** ose **jo** në vendin e duhur. | Shkruaj: me **po** ose **jo**<br>***Kepi i Blertë ----- ishuj____*** ***Kongo ---- liqen____***<br>***Bab el Mandeb ----- gadishull____*** ***Tibesti ----- male____***<br>***Sahara ------ shkretëtire____*** ***Limpompo ------ kanal____***<br>***Senegali ------ lum____*** ***Pigmejet ------ arabë____***<br>***Ruvenzori ----- ultësirë____*** ***Port Said ------- port____*** | 5 | |
| 9 | Pyetje-përgjigje | Cili grup i popullsisë dominon në Afrikën Jugore dhe çfarë prejardhje kanë popullsia e racës së bardhë? | 3 | |
| 10 | Vendos **a, b, c** në vendin e duhur. | Shënoni **a, b ose c** në zbrazëtirën para fjalisë:<br>______ Egjipti a) Shteti që bën pjesë në Afrikën Veriore.<br>______ Sudani Jugor b) Shteti ku dominon feja islame.<br>______ Etiopia c) Shteti që u pavarësua në korrik të vitit 2011. | 3 | |
| 11 | Komento | Përshkruaj figurën e Nelson Mandelës.  | 4 | |
| 12 | Përgjigju pyetjes | Numëroni disa nga mineralet e çmuara të Afrikës Jugore. | 3 | |

| Pikët | 0 - 17 | 18 - 24 | 25 - 31 | 32 - 38 | 39 - 45 | Numri i pik të saktë gjithsej ( ) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |

| | |
|---|---|
| Shenjat korrigjuese: √ - e saktë, **X** - e pasaktë,<br>~ - e pa plotësuar, **.......** pjesërisht e plotësuar | Mësimdhënësi: |

| **Test nga lënda e Gjeografisë** | Grupi B | Klasa VIII Paralelja___<br>Emri dhe mbiemri__________________ | Numri në ditar:___ |
|---|---|---|---|
| Rezultati: Vlerësohet shkalla e arritjes së njohurive të të nxënit në zotërimin e përmbajtjeve mësimore. | | **KUJDES**: **1)** Mos kopjo. **2)** Rrumbullakos vetëm përgjigjet e sakta **3**) Mos shkarravit. **4)** Mos përmirëso nëse ke gabuar. | |

| Nr. | Sqarime plotësimi | Detyrat dhe përgjigjet | Pikët | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Vendos në zbrazëtirë **e saktë** ose **e pa saktë**. | Në zbrazëtirën para fjalisë shëno **e saktë** ose **e pa saktë**<br>1.__________ Pjesa më e madhe e Afrikës shtrihet në brezin e nxehtësisë.<br>2.__________ Afrika e lartë përfshin pjesët perëndimore dhe veriore të kontinentit.<br>3.__________ Ngushtica Bab el Mandeb lidh Detin e Kuq me detin Mesdhe.<br>4.__________ Në popullsinë jonegroide bëjnë pjesë **Hamitet dhe Semitet.** | 4 | |
| 2 | Në hartën e dhënë shëno emrat e kryeqyteteve të shteteve të Afrikës Veriore. |  | 6 | |
| 3 | Në hartën e dhënë shëno emrat e 4 liqeneve të Afrikës Lindore. |  | 4 | |
| 4 | Lidh me shigjetë format e relievit për rajonet përkatëse. | ***Mali Kilimanxharo***    ***Rrafshnalta Jugafrikane***<br>***Mali Tibest***<br>***Malet Drakene***    ***Sahara***<br>***Mali Ahagar***<br>***Mali Ruvenzori***    ***Rrafshnalta Liqenore***<br>***Shkr. Kalahari*** | 6 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Shkruaj: | Shtetin më të madh për nga sipërfaqja dhe shtetin që nuk ka dalje në Oqeanin Atlantik të Afrikës Qendrore Ekuatoriale:<br>*a)*______________________ *b)*______________________ | 2 | |
| 6 | Qarko përgjigjet e sakta | Qarko katër grupacionet e popullsisë në Afrikën Veriore.<br>***Berberët*** ***Burët*** ***Pigmejët***<br>***Tauregët*** ***Hotentotët***<br>***Bantuidet*** ***Marokienët*** ***Egjiptianet*** | 4 | |
| 7 | Rrumbu-llakos | Rretho:<br>Cili nga këto shtete shtrihet në Afrikën Perëndimore?<br>***a) Sudani*** ***b) Guineja*** ***c) Algjeria*** | 1 | |
| 8 | Vendos **po** ose **jo** në vendin e duhur. | Shkruaj: me **po** ose **jo**<br>***Zanzibari ------- ishull____*** ***Namibia ------- ultësirë____***<br>***Gjiblartari ------ gadishull____*** ***Viktoria ------ ujëvarë____***<br>***Atllaset ---- Male____*** ***Nili ------------ lumë____***<br>***Suezi ----- kanal____*** ***Tanganjika -------rrafshnaltë____***<br>***Limpompo ------ qytet____*** ***Najrobi ------- port____*** | 5 | |
| 9 | Pyetje-përgjigje | Cilat grupe të popullsisë dominojnë në Afrikën Lindore dhe cilat fe janë të përhapura? | 3 | |
| 10 | Vendos **a, b, c** në vendin e duhur. | Shënoni **a, b ose c** në zbrazëtirën para fjalisë:<br>______ Maroko a) Shteti i njohur me monumentet e piramidave.<br>______ Egjipti b) Shteti ku ka ndodhur Aparteidi.<br>______ Rep. Jugafrikane c) Shteti i cili shtrihet në malet Atllase. | 3 | |
| 11 | Komento. | Përshkruaj çfarë është Safari në Afrikë.  | 4 | |
| 12 | Përgjigju pyetjes | Numëroni disa nga prodhimet bujqësore në Afrikën Perëndimore? | 3 | |

| Pikët | 0 - 17 | 18 - 24 | 25 - 31 | 32 - 38 | 39 - 45 | Numri i pikëve të sakta gjithsej ( ) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | Nota ( ) |

| | |
|---|---|
| Shenjat korrigjuese: √ - e saktë, **X**- e pasaktë,<br>~ - e pa plotësuar, **.......** pjesërisht e plotësuar | Mësimdhënësi/ja: |

| **Test nga lënda e Gjeografisë** | Grupi A | Klasa VIII Paralelja___<br>Emri dhe mbiemri_________________ | Numri në ditar:___ |
|---|---|---|---|
| **REZULTATI**: Vlerësohet shkalla e arritjes së njohurive të nxënësve në zotërimin e rezultateve të të nxënit. | | KUJDES: **1)** Mos kopjo. **2)** Rrumbullakos vetëm përgjigjet e sakta. **3**) Mos shkarravit. **4)** Mos shkruaj në faqen e prapme të testit. **5)** Mos përmirëso nëse ke gabuar. | |

| Nr. | Sqarime plotësimi | Detyrat dhe përgjigjet | Pikët | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Në bazë të hartës së dhënë shëno përgjigjen e saktë. | Përkufizo Amerikën Veriore.<br><br> | 5 | |
| 2 | Rrumbullakos | Kontinenti i Amerikës Veriore ka një sipërfaqe prej:<br>***a) 11.5 mil.km²*** ***b) 21.5 mil.km²*** ***c) 31.5 mil.km²*** | 1 | |
| 3 | *Në hartën e dhënë shëno tri format kryesore të relievit të Amerikës Veriore.* | <br> | 3 | |
| 4 | Rrumbullakos përgjigjen e saktë | Cila nga këto pohime është e saktë:<br>a. Rryma e Golfit është rrymë e krijuar në gjirin e Hadsonit.<br>b. Tornadot janë Ciklone që krijohen në oqeanin Atlantik.<br>c. Në arkipelagun e ishujve të Oqeanit të Ngrirë të Veriut mbizotëron klima Polare e Subpolare.<br>d. Në zonën rreth gjirit të Meksikës mbizotëron klima kontinentale dhe e mesme kontinentale. | 1 | |
| 5 | Plotëso zbrazëtirat | Shkruaj tre nga lumenjtë më të njohur të Amerikës Veriore që derdhen në Oqean Atlantik:<br>***a)***________________ ***b)***_________________<br>***c)***________________ | 3 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | Qarko përgjigjet e sakta | Qarko tri grupacionet e popullsisë se përzier në mes popullsisë vendase dhe ardhacakë, në Amerikën e Mesme janë:<br>***Astekët*** ***Zambozët*** ***Eskimezë***<br>***Mulatët*** ***Majët***<br>***Inkasit*** ***Zezakët*** ***Mestikët*** | 3 | |
| 7 | Rrumbullakos | Numri i përgjithshëm i popullsisë në kontinentin e Amerikës Veriore është rreth:<br>***a) 360 mil. banorë b) 460 mil. banorë c) 560 mil. banorë*** | 1 | |
| 8 | Shëno përgjigjet e sakta me PO ose JO të pasakta | Shkruaj: me **po** ose **jo**<br>***Jellustoni >>> Park____*** ***Jukatani >>> Gadishull____***<br>***Niagara >>> Qytet____*** ***Rio Grande >>> Kanion____***<br>***Shën Lorenci >>> Liqen____*** ***Alaska >>> Ishull____***<br>***Amazoni >>> Lum____*** ***Titakaka >>> Liqen____***<br>***Gran Çoko >>> Rrafshnaltë____*** ***Tajga >>> Pyje halore ____*** | 5 | |
| 9 | Lidh me shigjetë qytetet për shtetet përkatëse | Lidh me shigjetë:<br>***Akapulko*** ***Kanada***<br>***Otranto***<br>***Rio de Zhaniero*** ***ShBA-të***<br>***Çikago***<br>***Vankuver*** ***Meksika***<br>***MeksikoSiti***<br>***Hjuston*** ***Brazili***<br>***Sao Paulo*** | 8 | |
| 10 | **Maçu Pikçu** paraqet një nga peizazhet kulturore të fiseve Indigjene Inkase në Amerikën Jugore. | Ky peizazh kulturore historik gjendet:<br>***a. Peru***<br>***b. Brazil***<br>***c. Argjentinë***<br>***d. Kili***<br> | 1 | |
| 11 | Në zbrazëtirën para fjalisë shëno e "**saktë ose e pa saktë"** | 1. _________ Brazili njihet si prodhuesi më i madh i kafes në botë.<br>2. _________ SHBA-të janë ndër importuesit më të mëdhenj të misrit.<br>3. _________ Kanada është e varfër me xehe hekuri, nikeli, plumbi, ari argjendi etj.<br>4. _________ Argjentina për nga numri i bagëtisë dhe prodhimi i mishit zë vendin e parë në botë.<br>5. _________ Meksika njihet si prodhuese e njohur e naftës dhe gazit natyror. | 5 | |

| Pikët | 0 - 14 | 15 - 19 | 20 - 25 | 26 - 30 | 31 - 36 | Numri i pikëve të saktë gjithsej ( ) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | Nota ( ) |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shenjat korrigjuese: | √ - e saktë,<br>~ - e pa plotësuar, | **X** - e pasaktë,<br>**.......** pjesërisht e plotësuar | Mësimdhënësi/ja: |

# Referenca:


- Korniza e Kurrikulës së Kosovës (e rishikuar), MASHT, Prishtinë, 2016.
- Kurrikula Bërthamë (e rishikuar) VI - IX, MASHT, uar) VI - IX, Prishtinë, 2016 nderhyj te tabela, te lutemPrishtinë, 2016.
- Programi Lëndor: Fusha Kurrikulare "Shoqëria dhe Mjedisi", MASHT, Prishtinë, 2019.
- Vlerësimi sipas Kurrikulës së bazuar në Kompetenca: Udhëzues për Mësimdhënës, BEP, MASHT, Prishtinë, 2016.
- Udhëzimi Administrativ nr.6/2022, MASHT, 2022.
- Udhëzues për zbatimin e Kurrikulës: Fusha Kurrikulare "Shoqëria dhe Mjedisi", Prishtinë, 2018.